

Tiranë më 13.08.2025

K Ë R K E S Ë

OBJEKTI: Konstatimi i shkeljeve procedurale të Prokurorisë së Posaçme gjatë fazës së hetimeve paraprake të procedimit penal nr. 27 të vitit 2024 dhe pavlefshmërinë e veprimeve hetimore.

**DREJTUAR: GJYKATËS SË POSAÇME TË SHKALLËS SË PARË
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR**

GJYQTARIT – Z. ERION BANI

Gjyqtar i Hetimeve Paraprake
të procedimit penal me nr. 27 të vitit 2024

NGA: Z. ERION VELIAJ

E nderuar Gjykatë!

Së fundmi, pasi kemi shqyrtuar një pjesë të akteve të vëna në dispozicion nga ana e Prokurorisë në lidhje me procedimin penal nr. 27 të vitit 2024 (për shkak të kohës së shkurtër në dispozicion), kemi konstatuar një sërë shkelje të rënda procedurale me pasojë pavlefshmërinë e veprimeve hetimore dhe provave të marra si pasojë e këtyre veprimeve.

Duke qenë se ndodhemi ende në fazën e hetimeve paraprake ku kërkesat e palëve në proces shqyrtohen nga ana Juaj si Gjyqtar i hetimeve paraprake, në lidhje me këtë procedim penal, paraqesim para Jush kërkesën tonë për konstatimin nga Gjykata të këtyre shkeljeve

procedurale dhe rivendosjen në vend të të drejtave dhe garancive procedurale të z. Veliaj duke disponuar sipas kërkrimeve të kësaj kërkesë.

1. **Mosrespektim i ligjit procedural penal dhe parimeve bazë procedurale në procedimin penal nr.27/2024, me pasojë pavlefshmërinë absolute të akteve dhe papërdorshmërinë e provave**
 1. Legjislacioni procedural penal, në vetvete, përfaqëson jo thjesht një grup rregullash teknike mbi mënyrën e zhvillimit të një procesi penal, por një strukturë themelore mbrojtëse në funksion të shtetit të së drejtës. Ai përbën skeletin përmes të cilit drejtësia penale realizohet, duke vendosur kufij të qartë midis ushtrimit legjitim të autoritetit shtetëror dhe cenimit arbitrar të lirive themelore të individit. Roli i tij është të sigurojë që ndjekja penale të mos jetë një instrument shtypës në duart e pushtetit, por një proces i mbikëqyrur, transparent dhe i drejtë, i zhvilluar në përputhje me parimet kushtetuese dhe konventore.
 2. Në këtë kontekst, parashikimi procedural penal se ky legjislacion ka për qëllim mbrojtjen e lirive personale dhe të drejtave të ligjshme të shtetasve nuk është një deklaratë formale, por një pohim themelor mbi natyrën e procesit penal në një rend demokratik. Rregullat procedurale nuk janë të ndara nga substanca e drejtësisë; ato janë vetë substanca kur bëhet fjalë për mënyrën se si shteti përballet me një individ të dyshuar ose të akuzuar për vepra penale. Çdo fazë e procedimit, që nga fillimi i hetimeve, tek ndërhyrjet me masa sigurie personale, e deri në dhënien e vendimit gjyqësor, duhet të zhvillohet brenda një kornize të qartë dhe të panegociueshme rregullash që synojnë të ruajnë ekuilibrin midis forcës publike dhe mbrojtjes së të drejtave individuale.
 3. Pikërisht për këtë arsye, detyrueshmëria e këtyre dispozitave për të gjitha subjektet e përfshira në procedimin penal, gjykatën, prokurorinë, policinë gjyqësore dhe mbrojtjen, është më shumë se një domosdoshmëri teknike: është një kusht thelbësor për legjitimitetin e gjithë procesit penal. Një procedurë që zhvillohet përmes shmangieve, përjashtimeve arbitrare apo devijimeve nga rregulli procedural, nuk mund të prodhojë drejtësi në kuptimin e saj material. Ajo rrënon besimin tek institucionet dhe prodhon

efektin e kundërt të asaj që ligjvënësi ka synuar: në vend që të forcojë rendin juridik dhe të afirmojë forcën e ligjit, ajo e minon atë.

4. Për më tepër, fakti që ky legjislacion ka për qëllim të ndihmojë në zbatimin e Kushtetutës dhe të ligjeve të shtetit i jep atij një karakter të dyfishtë, jo vetëm si një mjet për të ndjekur penalisht shkelësit e ligjit, por edhe si një mekanizëm kontrolli ndaj vetë pushtetit shtetëror. Është përmes procedurës penale që kontrollohet mënyra se si shteti reagon ndaj sjelljeve të ndaluara, dhe është po përmes saj që vendoset nëse ky reagim është proporcional, i ligjshëm dhe i nevojshëm në një shoqëri demokratike. Një shkelje procedurale, për pasojë, nuk mund të anashkalohet në emër të efikasitetit të ndjekjes penale; ajo është një kërcënim real ndaj lirisë personale, dhe nëse tolerohet, është vetë shteti i së drejtës që rrënohet. Në këtë kuptim, procedura nuk është pengesë për drejtësinë, por garancia më e fortë që ajo të mos shndërrohet në padrejtësi të institucionalizuar.
5. Siç do të evidentojmë në vijim, duke qenë se procedimi penal është regjistruar mbi bazën e akteve procedurale të papërdorshme, kjo ka sjellë si pasojë që edhe vetë akti i regjistrimit të procedimit penal të konsiderohet një akt procedural i pavlefshëm. Po kështu i pavlefshëm bëhet edhe çdo akt procedural i mëpasshëm përfshirë edhe aktet mbi të cilat është komunikuar akuza, për shkak të mbështetjes së tyre mbi një bazë të paligjshme, duke sjellë efekte domino pavlefshmërie mbi të gjithë aktet procedurale në vazhdim. Teoria e “fruitit të pemës së ndaluar” përfaqëson një parim themelor të së drejtës procedurale penale, sipas të cilit çdo rezultat juridik që rrjedh nga një veprim fillestar i paligjshëm është i kontaminuar në thelb dhe, për pasojë, i pavlefshëm. Ky parim ndërlidhet ngushtësisht me konceptin e ligjshmërisë materiale dhe formale të procedurës: nëse një akt i parë është ndërmarrë në shkelje të parimeve që garantojnë ndershmërinë dhe kontrollin institucional të procesit, çdo akt i mëvonshëm që mbështetet mbi të humbet autonominë e vet procedurale dhe nuk mund të prodhojë pasoja juridikisht të vlefshme. Në thelb, kjo teori nuk shqyrton vetëm vlefshmërinë e një prove apo veprimi, por legjitimitetin e gjithë strukturës procedurale që ndërtohet mbi një themel të paligjshëm, duke sanksionuar çdo tentativë për të justifikuar një rrjedhë procedurale mbi një devijim fillestar.

6. Ky parim shkon përtej logjikës formale të pavlefshmërisë teknike dhe vendos një ndalim substancial: ajo ndalon transformimin e një shkeljeje në një bazë legjitime për ushtrimin e pushtetit penal. Përmes saj, rendi juridik mbrohet nga relativizimi i ligjshmërisë, sepse nuk lejohet që një procedurë që ka filluar në mënyrë të jashtëligjshme të ripastrohet përmes veprimeve të mëvonshme, sado të përpikta apo të formalizuara ato të jenë. Në këtë kuptim, teoria e “frutit të pemës së ndaluar” është një formë mbrojtjeje sistemike ndaj përthithjes së paligjshmërisë në procesin penal, duke siguruar që drejtësia të mos jetë vetëm një qëllim i procesit, por një kusht i domosdoshëm i vetë mënyrës së zhvillimit të tij.
7. Megjithëse GJEDNJ nuk e ka përmendur shprehimisht parimin “frutit të pemës së helmuar”, në disa vendime të saj ajo ka mbajtur qëndrim në përputhje me këtë doktrinë. Konkretisht vendimi “Bykov kundër Rusisë” (2009), GJEDNJ në këtë çështje theksoi se nëse një hetim penal rezulton të ketë nisur mbi baza të paligjshme, edhe provat e mëvonshme të mbledhura ligjërisht nuk mund ta bëjnë atë hetim të vlefshëm. Vendimi “Gäfgen kundër Gjermanisë” (nr. 22978/05, 2010), GJEDNJ në këtë çështje shqyrtoi përdorimin e deklarimeve të marra nën kërcënimin e torturës. Gjykata vlerësoi se edhe pse këto deklarime nuk i bënin provat e mëvonshme të deklaroheshin automatikisht si të pavlefshme, nuk përjashtoi këtë mundësi duke ia lënë gjykatave të juridiksionit të brendshëm vlerësimin e drejtësisë së përgjithshme të procedurës. Vendimi “Jalloh kundër Gjermanisë” (nr. 54810/00, 2006). Në këtë rast, GJEDNJ konstatoi se përdorimi i provave të marra përmes ndërhyrjes mjekësore të detyruar përbënte shkelje të nenit 6, pasi provat ishin marrë në mënyrë që cenonte dinjitetin dhe integritetin fizik të të pandehurit. Sipas GJEDNJ marrja e provave në shkelje të nenit 6 të KEDNJ, sjell si pasojë cënim të parimit të procesit të rregullt ligjor nëse nga përdorimi i provës së marrë në mënyrë të paligjshme ka shkaktuar më pas shkelje të rënda. Vendimi “Teixeira de Castro kundër Portugalisë” (nr. 25829/94, 1998). Në këtë çështje, GJEDNJ konstatoi se përdorimi i provave të marra përmes nxitjes së paligjshme nga ana e policisë për të kryer një vepër penale përbënte një shkelje të nenit 6 të Konventës. Gjykata theksoi se një proces i drejtë nuk mund të bazohet në prova të marra përmes shkeljeve të tilla të të drejtave të të pandehurit.

8. Pra megjithëse GJEDNJ nuk e ka përmendur shprehimisht termin "fruti i pemës së helmuar", jurisprudenca e saj mbështet parimin që provat e marra në mënyrë të paligjshme, ose ato që rrjedhin nga shkelje të rënda të të drejtave të njeriut, mund të çojnë në një proces të padrejtë dhe, për rrjedhojë, të jenë të papranueshme, në përputhje me doktrinën e "frutit të pemës së helmuar". Pra ajo që vihet re në këtë praktikë të GJEDNJ është pranimi i kësaj doktrine për rastet kur pavlefshmëria e një akti procedural shkakton shkelje të rënda procedurale.
9. Në këtë prizëm, duhet theksuar se teoria e “frutit të pemës së ndaluar” nuk përkon thjesht me parimin tashmë të sanksionuar në Kushtetutë për mospërdorimin e provave të marra në mënyrë të paligjshme. Ndërsa ky i fundit synon të ndalojë përdorimin e vetë provës së paligjshme, doktrina e frutit të pemës së ndaluar ka një shtrirje më të gjerë dhe më thelbësore: ajo përfshin edhe ndalimin e përdorimit të çdo prove tjetër që rrjedh, drejtpërdrejt ose tërthorazi, nga një veprim fillestar i paligjshëm. Kësisoj, jo vetëm prova origjinale, por e gjithë “zinxhiri” i provave të mbledhura mbi një bazë të kontaminuar procedurale konsiderohet i pavlefshëm. Ky mekanizëm juridik mbron jo vetëm nga përdorimi i një elementi të paligjshëm, por nga legjitimimi i të gjithë procesit hetimor të ndërtuar mbi shkelje fillestare, duke garantuar që paligjshmëria të mos riprodhohet dhe të mos përthithet në mënyrë të heshtur brenda strukturës së procedimit penal. Në këtë kuptim, teoria nuk kufizohet te prova e vetme, por shërben si një filtër sistematik për të ruajtur integritetin e të gjithë procesit.
10. Siç do e kuptoni edhe nga aktet e procedimit penal, Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar njoftoi përfundimin e hetimeve dhe komunikimin e akuzës ndaj z. Erion Veliaj, duke vendosur një afat 10-ditor, në përputhje me nenin 327 të Kodit të Procedurës Penale, për të paraqitur një kërkesë të motivuar për pushimin e çështjes ose për kërkime hetimore shtesë. Gjithashtu mbrojtjes iu vu në dispozicion për njohje materiali hetimor me një volum prej 160 fashikujsh, përfshirë një numër të konsiderueshëm aktesh të ndërlikuara, si akt-ekspertime tekniko-kompjuterike, analiza financiare, deklarime personash, korrespondenca institucionale dhe materiale të tjerë.

11. Në këto kushte, pamundësia reale dhe objektive për të ushtruar të drejtën e mbrojtjes në mënyrë efektive brenda një afati kaq të shkurtër është evidente. Pavarësisht kërkesës së paraqitur nga ana jonë pranë Prokurorisë së Posaçme për **shtyrjen e afatit 10-ditor**, me qëllim njohjen e plotë me materialet dhe përgatitjen e një memorie të motivuar sipas nenit 327/4 të K.Pr.Penale, kjo kërkesë na u refuzua.
12. Edhe pse jemi akoma në studim të dosjes, pasi ka një volum të jashtëzakonshëm materialesh, po paraqesim në vijim një seri shkeljesh të rënda proceduriale, të cilat e vënë seriozisht në diskutim vlefshmërinë e hetimeve dhe ligjshmërinë e aktit të akuzës.
13. Këto shkelje nuk pretendojnë të jenë të vetmet, pasi **procesi i njohjes me dosjen është ende në vijim** dhe vlerësimet e mëtejshme do të formalizohen në përputhje me përmbajtjen e plotë të fashikujve hetimorë. Ato që paraqiten më poshtë janë një pjesë e parë, por thelbësore, e elementëve që komprometojnë standardet minimale të një procesi të rregullt dhe kushtetues ndaj z. Veliaj.

2. Mosplotësimi i kushteve ligjore për regjistrimin e kallëzimit të falsifikuar

14. Z. Erion Veliaj nga viti 2015 e në vijim ushtron funksionin e Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, i zgjedhur për tre mandate radhazi. Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, duke marrë shkas nga një kallëzim të falsifikuar, pasi është firmosur nga një person, në emër të një personi që nuk ekziston, në datën 08.02.2024 ka regjistruar procedimin penal Nr.27/2024, aktet e të cilit bëjnë fjalë për veprën penale të "Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë", parashikuar nga neni 260 i Kodit Penal, pa autor. Në Korrik 2023 pranë Prokurorisë së Posaçme është protokolluar një kallëzim penal i falsifikuar nga një shtetas i vetëquajtur Nesti Angoni, për të cilin nuk ka asnjë gjurmë në regjistrin e gjendjes civile. Kallëzimi i falsifikuar përmban sa më poshtë: *"Të nderuar jam një qytetar i Tiranës që dua tu vej në dijeni të disa fakteve që i shoh si kompromentuese për kryetarin e bashkisë Tiranë, zotin Erion Veliaj dhe marrëdhëniet e tij me pronarin e shoqërisë Agikons, Genti Sula. Kur Erion Veliaj u bë ministër morri një banesë në bllokun Kodra e Diellit në pronësi të Genti Sula dhe gruaja e tij u bë zëvendësministre tek Ministria Punës (kjo banesë më vonë është shtuar me një kat dhe me ashensor të vecantë). Që nga ajo kohë*

marrëdhënia e të dyve është e pandarë.... Shoqëria Agikons, me pornar Gent Sula ka “fituar” një pafundësi ndërtimesh në Tiranë, si shkollën tek ish sheshi Shqiponja, parkun Rinia, Operan, Maternitetin, spitalin e ri, godina te Universiteti Bujqësisë dhe tani flitet edhe për Teatrin Kombëtar. Nuk mund të them se si është fituar kontrata për këto ndërtime... Sot Erion Veliaj ka në pronësi 3 vila në fshatin rezidencial në Qerret Kavajë të ndërtuar nga shoqëria Agikons e Genti Sula. Nga këto një vilë e posedon i vëllai Erion Veliaj, tjetrën Erion Veliaj të dyja të rikonstruktura dhe të tretën e ka rrafshuar. Këto vila kanë një vlerë tregu plus rikonstruksionin që shkon rreth 500 mijë euro. Vila e tretë tashmë e rrafshuar për të krijuar më shumë hapësirë, pra hedh në plehra 500 mijë euro për hic. Për prishjen e saj kanë punuar makineritë e Ujësjiellësi Kavajë. A ka një leje për prishjen apo ndonjë faturë të punimeve? Të gjitha këto ngrenë pyetjen ku i gjeti paratë Erioni? dhe a ka dokumenta të blerjeve, pagesave bankare, apo pronësia e tyre ka mbetur formalisht të ndërtuesi. Këto janë pak probleme që mendoj se tregojnë shumë. Uroj që të kem dhënë një informacion të vlefshëm në luftën kundër korrupsionit”.

15. Me vendimin nr. 00-2024-1222 i Vendimit (69), datë 12.03.2024, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në seancë gjyqësore, ka vlerësuar se jo çdo akt që paraqitet pranë organeve të ndjekjes penale në cilësinë e “kallëzimit”, përmbush elementët për t’u konsideruar i tillë dhe regjistruar në regjistrin e veprave penale. Sipas këtij vendimi të fundit të Gjykatës së Lartë konsiderohet në cilësinë e njoftimit (objektiv) për veprën penale, pra kallëzim:

1. **Përshkrimi i fakte të “ndodhura”, “të rëndësishme” dhe “konkrete”, të cilat i korrespondojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë një normë inkriminuese.** Në terma të tjerë, informacioni i “transportuar” nëpërmjet njoftimit/lajmit për t’u kualifikuar në cilësinë e njoftimit për veprën penale – të *notitia criminis* – duhet domosdoshmërisht të përmbajë **tiparet dalluese të faktit penal, të identifikueshme në elementin objektiv të figurës së veprës penale (veprimin kriminal), pasojën dhe lidhjen shkakësore.** Termi “ njoftimi për veprën penale” i përdorur rëndom nga legjislatori në KPP mbështetet përreth dy “shtyllave”: njoftimi/lajmi dhe vepra penale. I pari, sipas gjuhës së përditshme është një informacion që bën të njohur një fakt, nga

deduktohet se thelbin e përmbajtjes së këtij njoftimi/lajmi e përbën informacioni i sipërcituar. Kur mungon përmbajtja e këtij informacioni - në kushtet kur - fakti i referuar nëpërmjet tij rezulton jashtë çdo lloj konteksti hapësire apo kohe, është në kushtet e pamundësisë për t'u realizuar apo është prodhim i fantazisë – nuk mund të bëhet fjalë për njoftim në aspektin teknik. I dyti (vepra penale) përcakton objektin të cilit i referohet njoftimi, përfaqëson një njoftim/lajm për një vepër penale” duke qenë i aftë për të “influencuar” aktivimin (regjistrimin) e procedimit penal.

2. Për t'u konsideruar i tillë, kallëzimi do të duhet të ketë si elementë:

A. HIPOTETICITETIN, pra të ketë një hipoteze krimi (vepre penale) që prezanton një profil të dyfishtë - I pari që i referohet objektit d.m.th. ekzistencës së një fakti dhe kualifikimit të tij si krim (vepër penale), i dyti – tregimit të përgjegjësit eventual (autorit) të realizimit të këtij fakti si dhe të dënueshmërisë së tij, dhe

B. SPECIFICITETI - që shërben për t'i dhënë **një sens konkret** njoftimit (për veprën penale) dhe **për ta dalluar atë nga dyshimi i thjeshtë apo hamendja** - të dhëna njohëse këto – të cilat për nga natyra e tyre – konsiderohen të vakëta dhe të papërcaktuara. Pra përveçse do të duhet të ketë fakte të përshkruara, këto fakte duhet të kenë elementë specifike të karakterit indiciar, duke pasur kështu një standard provues. Konsiderohen të pamjaftueshme për t'u konsideruar “kallëzim”, aktet në të cilat vetëm hidhen dyshime të thjeshta.

16. Në rast se akti i paraqitur si “kallëzim” nuk përmbush elementët e mësipërm, atëherë ai nuk përmbush kushtet për t'u regjistruar nga prokurori në regjistrin e veprave penale, e nëse fillimisht është bërë një regjistrim i tillë do të duhet të vendoset “mosfillim i procedimit”, në të kundërt do të shkeleshin parashikimet procedurale penale lidhur me regjistrimin e kallëzimeve dhe fillimin e procedimeve penale, si dhe do të nxitej depozitimi i kallëzimeve të rremeve ose lënies nga çdo subjekt, përmes këtyre akteve të quajtura prej tij “kallëzim”, i detyrave për prokurorët, që të hetojnë për të (“kallëzuesin”) se mos gjejnë ndonjë element kriminal në aktet e pretenduara prej

“kallëzuesit”, në mënyrë hipotetike, si të paligjshme, pa asnjë, fakt, provë a minimumi shpjegim lidhur me këtë paligjshmëri. Nëse do të pranohej regjistrimi ose hetohej në bazë të kallëzimeve të tilla të cilat thjesht ngrenë “në bllok” pretendimin për paligjshmëri të një numri të konsiderueshëm procedurash, atëherë do të legjitimohej çdo qytetar i zakonshëm ose i veshur me një pushtet të caktuar për shkak të detyrës, që ti drejtohej organeve të ndjekjes penale “në ajër” dhe në mënyrë hipotetike dhe të hamendësuar për hetimin nga këto organeve të 50 procedurave në X ministri, 40 procedurave në Y institucion, etj, me argumentin sipërfaqësor, se këto janë zhvilluar në konsumim të korrupsionit, shpërdorimit të detyrës, etj, pa paraqitur situatën faktike të pretenduar prej tij se ku konstatojnë konkretisht këto paligjshmëri me karakter penal, si dhe pa bazë provuese për këto pretendime të tij. Në këtë mënyrë prokurorët do të “bllokoheshin” vetëm në kryerjen e këtyre hetimeve të bazuara në hamendje dhe supozime dhe nuk do të kishin mundësinë për të hetuar çështje të cilat lidhen me pretendime konkrete, madje koha edhe vetëm për hetimin e të parave do të ishte e pamjaftueshme.

17. Pra në rastin e kallëzimeve të cilat thjesht hamendësojnë dhe ngrenë “në bllok” pretendime për paligjshmëri, pa përshkruar minimumi se ku qëndron paligjshmëria, e le më të kenë të paraqitura prova për pretendimet e tyre, është në kundërshtim me vendimin e sipërcituar të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë dhe nuk do të duhet të konsiderohet “kallëzim”, e si rrjedhojë nuk do të duhet të regjistrohet në regjistrin e veprave penale, e nëse është bërë një regjistrim i tillë do të duhet të vendoset “mosfillimi i procedimit”. Prokurorët kanë detyrim të kryejnë veprimet hetimore përkatëse në bazë të kallëzimeve, por janë të pavarur dhe nuk mund të detyrohen përmes akteve të (keq)quajtura “kallëzim”, që të hetojnë për të parë se mos del ndonjë element i ndonjë figure të veprës penale.

18. Sa më sipër, prg. 31 - 43 të vendimit nr. 00-2024-1222 (69), datë 12.03.2024, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë parashikojnë se:

31. Në këtë stad të ecurisë/dinamikës së itenerarit logjik të arsyetimit të këtij vendimi Kolegji gjen me vend të ndalet në problematikën e siperevidentuar - të parashikuar prej përmbajtjes së dispozitave të KPP –

konkretisht të neneve 280 - 287 të KPP - që parashikojnë “marrjen dijeni për veprën penale” (prej organit të procedimit penal - prokurori dhe policia gjyqësore) në të gjitha format e shfaqjes së saj (llojet e kallëzimeve), dokumentimin e kësaj dijenie nëpërmjet “regjistrimit të njoftimit të veprave penale”(neni 287 i KPP) për të kaluar tek - kontrolli juridiksional - i ushtruar prej gjyqtarit për hetimet paraprake - nën stimulimin e palëve (kallëzuesi, viktima) - lidhur me disponimin e prokurorit - inercinë e tij - për të regjistruar procedimin penal (sikurse në rastin konkret) mbi bazën e njoftimit të marrë nëpërmjet kallëzimit të paraqitur prej viktimës (trashëgimtarëve të afërm të saj) – përsa kohë që disiplina e mirëfilltë e mosfillimit apo mosvazhdimet të procedimit të regjistruar (për shkak të mungesës apo rënies - përgjatë ecurisë së procedimit penal – të kushteve të procedimit, të parashikuara në nenin 290 – paragrafi i parë - i KPP) – nuk interferon në rastin në fjalë që sugjeron impenjimin e drejtpërdrejtë të legjislatorit për të “ndërhyrë” - nëpërmjet parashikimit të aplikimit (ushtrimit) të kontrollit juridiksional - edhe në këtë fushë - të konsideruar historikisht si “domen” i aplikimit të diskrecionit ekskluziv (pothuajse të pakontrollueshëm prej organit juridiksional) të prokurorit - lidhur me marrjen dhe regjistrimin e njoftimit për veprën penale (notitia criminis) – në funksion të disiplinimit dhe të kontrollit të këtij diskrecioni me rëndësi thelbësore për zbatimin/jetësimin e parimit kushtetues të barazisë së shtetasve para ligjit nëpërmjet ushtrimit të detyrueshëm të ndjekjes penale.

32. Fillimi i procedimit penal presupozon ekzistencën e një njoftimi/lajmi për veprën penale – tradicionalisht e konsideruar si “informacion i marrë nga prokurori apo nga policia gjyqësore lidhur me një fakt që përbën vepër penale”. Mënyrat e marrjes së njoftimit për veprën penale parashikohen në nenet 281, 282 dhe 283 të KPP dhe identifikohen në “kallëzimin e n/punësve publike, “kallëzimi nga personeli mjekësor” dhe “kallëzimi nga ana e shtetasve”. Prokurori ka detyrimin të regjistrojë – shënoje – në regjistrin e njoftimeve të veprave penale – çdo njoftim të veprës penale që i vjen ose që e

ka siguruar me iniciativë i kompletuar në eventualitet edhe me emrin e autorit të kësaj vepre.

33. Konsiderohet në cilesinë e njoftimit (objektiv) për veprën penale - njohja e thjeshtë e fakteve - të përshkruara - në këtë njoftim/lajm – si (**FAKTE**) **TË “NDODHURA”, “ TË RËNDËSISHËM” DHE KONKRETE”** – korresponduese - në mënyrë të drejtpërdrejtë – tek një normë inkriminuese. Detyrimi i prokurorit për të shënuar në regjistrin e parashikuar nga neni 287 i KPP – një njoftim për veprën penale – notitia criminis - në ngarkim të një subjekti të caktuar “lind” vetëm kur në ngarkim të këtij të fundit dalin/ evidentohen (mbi bazën e materialit kallëzues) **ELEMENTË SPECIFIKE TË KARAKTERIT INDICJAR** – standard provues që përfshihet - duke konsideruar në kushtet e pamjaftueshmërisë – dysimet e thjeshta. Shënimi në regjistrin e njoftimit të veprave penale të prokurorit - i njoftimit për veprën penale - kristalizon momentin gjenetik të fazës së procedimit – të hetimeve paraprake – të destinuar për të përfunduar me “kërkesën për dërgimin e çështjes në gjykim” apo “për pushimin e çështjes”.

34. Në terma të tjerë, **informacioni i “transportuar” nëpërmjet njoftimit/ lajmit për t’u kualifikuar në cilësinë e njoftimit për veprën penale – të notitia criminis – duhet domosdoshmërisht TË PËRMBAJË TIPARET DALLUESE TË FAKTIT – VEPËR PENALE - TË IDENTIFIKUESHME NË ELEMENTIN (ANËN) OBJEKTIVE TË FIGURËS SË VEPRËS PENALE – VEPRIMIN KRIMINAL, PASOJËN DHE LIDHJEN SHKAKËSORE.**

35. Neni 280 i KPP përcakton dy mënyra të marrjes dijeni (prej organit të procedimit penal – prokurorit dhe policisë gjyqësore) për veprën penale – nëpërmjet “njoftimit të bërë nga të tjerët” dhe “me iniciativën e vet”. Në rastin e parë si policia gjyqësore ashtu edhe prokurori luajnë një rol “pasiv” përsa kohë që “operojnë” në cilësinë e “pritësit” të informacionit të ardhur nga “kanale të kualifikuara” (të identifikuar sikurse u sipërcitua në kallëzimet e nëpunësve publike, të personelit mjeësor dhe të shtetasve sipas përcaktimeve të neneve 281, 282, dhe 283 të KPP) dhe nuk kanë asnjë lloj roli në formimin e

këtyre akteve. Ndërkohë që në rastin e dytë – të “marrjes së njoftimit me iniciativen e vet” – konfigurohet – një veprimtari paraprocedurale e këtij organi (të procedimit – prokurori) - kërkimi dhe rikonjicioni të informacionit në “kanale të pakualifikuara” që synon verifikimin e transformimit të tij në njoftim (notitia criminis) legjitim për veprën penale - të përshtatshëm për t’u regjistruar në konformitet me përcaktimet e paragrafit të parë, të nenit 287 të KPP. Në të gjitha këto raste (bëhet fjalë për informacione të ardhura nga burime konfidenciale, operacione nën mbulim, nga fakte të njohura botërisht, nga burime anonime, nga shtypi – mass media – përfshirë shërbimet radiotelevizive dhe investigimet e gazetarisë etj.) prokurori me të marrë (edhe me iniciativen e tij) të dhënë nga burimet e njohjes (informimit) të sipërcituara duhet të kryejë një aktivitet investigues në funksion të verifikimit të prezencës së një njoftimi të mirëfilltë për veprën penale. Mbi këtë bazë edhe përmbajtja e një bisede telefonike të përgjuar në mënyrë të paligjshme e cila në vetvete nuk mund të disponojë cilësitë e njoftimit – notitia criminis - për veprën penale - për shkak të kësaj paligjshmerie, mund të shërbejë si shtysë e dobishme për të investiguar (hetuar) në drejtim të formimit të kësaj të fundit - notitia criminis - me rekuizitat e përshtatshmërisë për t’u regjistruar. Vetëm brenda këtyre limiteve mund të konceptohet lejimi i veprimtarisë së kërkimit të njoftimit (për veprën penale) – prej prokurorit – veprimtari - e cila – “materializohet” në një fazë paraprocedimore të verifikimit të ekzistencës dhe të rëndësisë së informacionit të marrë.

36. Duke u rikthyer tek përmbajtja e njoftimit për veprën penale – kushtet e regjistrueshmërisë së saj (rekuizitat e identifikuese të kësaj cilësie – që informacioni i marrë prej organit procedues – të integrojë cilësinë e notitia criminis – njoftimit për veprën penale) – është e mjaftueshme – duke mbajtur si referim përcaktimin e nenit 293/1 të KPP (I vetmi referim kodifikues lidhur me konceptin – nocionin – e njoftimit për veprën penale) që bën fjalë për referimin e veprës penale nga policia gjyqësore tek prokurori – **të disponojë (përmbaje) “elementet thelbësore të faktit” – të identifikueshëm në komponentët e anës**

objektive të figurës së veprës penale të tilla si sjellja (veprimi) kriminal, pasoja dhe lidhja shkakësore.

37. Përbëjnë – sipas konsideratës së këtij Kolegji – elemente karakterizues të identifikimit të notitia criminis – njoftimit për veprën penale – **1. HIPOTETICITETI (I SAJ)** përsa kohë që qartazi “njoftimi për veprën penale” në çfarëdo lloj forme që materializohet përbën esencialisht një hipotezë krimi (vepre penale) që prezanton një profil të dyfishtë - I pari që i referohet objektit d.m.th. ekzistencës së një fakti dhe kualifikimit të tij si krim (vepër penale) - i dyti – tregimit të përgjegjësit eventual (autorit) të realizimit të këtij fakti si dhe të dënueshmërisë së tij – dhe **2. SPECIFICITETI** - që shërben për t'i dhënë **një sens konkret** njoftimit (për veprën penale) dhe **për ta dalluar atë nga dyshimi i thjeshtë apo hamendja** - të dhëna njohëse këto – të cilat për nga natyra e tyre – konsiderohen të vakëta dhe të papërcaktuara.

38. Termi “ njoftimi për veprën penale” i përdorur rëndom nga legjislatori në KPP mbështetet përreth dy “shtyllave”: **NJOFTIMI/LAJMI DHE VEPRJA PENALE.** I pari, sipas gjuhës së përditshme është një informacion që bën të njohur një fakt, nga deduktohet se thelbin e përmbajtjes së këtij njoftimi/lajmi e përbën informacioni i sipërcituar. Kur mungon përmbajtja e këtij informacioni - në kushtet kur - fakti i referuar nëpërmjet tij rezulton jashtë çdo lloj konteksti hapësire apo kohe, është në kushtet e pamundësisë për t'u realizuar apo është prodhim i fantazisë – nuk mund të bëhet fjalë për njoftim në aspektin teknik. I dyti (vepra penale) – ka të bëjë-përcakton - objektin të cilit i referohet njoftimi – që dedukton konkluzionin se: “njoftimi/lajmi mbi një fakt që - prima facie – përbën (njofton) një paligjshmëri të karakterit civil apo administrativ ose që nuk rezulton juridikisht i rëndësishëm – përfaqëson një njoftim/lajm jo për një vepër penale” - dhe si i tillë – i paaftë për të “influencuar” aktivimin (regjistrimin) e procedimit penal.

39. Duke u kthyer tek rasti konkret – paraqitja e kallëzimit të viktimës Nikaj, tek organi i procedimit penal – prokurori (Prokuroria e Posaçme kundër

Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar) - sekretaria e këtij të fundit - Kodi i *Procedurave Penale*, në Titullin I të tij ku përcakton subjektet e procedimit penal - ndër të tjerë - në nenet 58, 58/a dhe 58/b - identifikon si të tillë “viktimën e veprës penale”. Rëndësia e këtij subjekti procedural është treguar nga ligjvënësi që me shtimin e nenit 9/a, në përbërje të këtij Kodi, duke theksuar detyrimin e organeve publike që të garantojnë që viktimat e veprës penale të trajtohen me respekt për dinjitetin e tyre njerëzor dhe të mbrohen nga ridëmtimi, gjatë ushtrimit të të drejtave të parashikuara nga Kodi. Neni 58 i KPP, megjithëse në pikën 1 të tij tregon të drejtat e viktimës së veprës penale, nuk jep një përkufizim të këtij termi. Në fakt, një përkufizim i tillë nuk jepet as nga ndonjë dispozitë tjetër e Kodit.

40. Në interpretim të kësaj dispozite, Kolegji çmon të sjellë në vëmendje përkufizimin e termi “viktimë e veprës penale” sipas Direktivës 2012/29/BE të Parlamentit dhe Komisionit Europian datë 25.10.2012 “Për përcaktimin e standardeve minimum për të drejtat, mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimës së veprave penale dhe zëvendësimin e Vendimit Kuadër të Komisionit 2001/220/JHA” (Direktiva 2012/29/BE), në të cilën është bazuar ndryshimi i bërë në KPP me ligjin nr. 35/2017. Referuar kësaj directive, me viktimë të veprës penale kuptohet: (i) individ i që ka pësuar një dëm, përfshirë dëmin fizik, mendor, emocional, apo ekonomik, i cili është shkaktuar drejtpërdrejtë nga vepra penale (neni 2, shkronja (a), pika (i)); (ii) anëtar i familjes së personit, vdekja e të cilit është shkaktuar nga një vepër penale dhe i cili ka pësuar një dëm si rezultat i vdekjes së personit (neni 2, shkronja (a), pika (ii)).

41. Referuar përkufizimit të mësipërm, si dhe faktit që kallëzuesja Rajmonda Nika, është bashkëshortja e një prej personave që njoftohet se është vrarë si pasojë e veprimeve kriminale të realizuara prej “forcës publike”, në ngjarjen e datës 21.01.2011 (objekt hetimi), Kolegji vlerëson se ajo paraqitet me cilësinë e viktimës së veprës penale, të cilës Kodi i njeh të drejtat e parashikuara në nenin 58 të tij. Qëllimi i kësaj dispozite (neni 58 të KPP) është të përcaktojë pozitën e viktimës në procesin penal, si dhe të drejtat e saj procedurale nga momenti i njoftimit të veprës penale e deri në përfundim të

procesit. Neni 58 i KPP, rendit të drejtat e viktimës së veprës penale, të cilat mund të kategorizohen në të drejta eventuale (potenciale), të cilat viktimat mund të zgjedhë t'i ushtrojë ose jo dhe të drejta të detyrueshme, ushtrimi i të cilave passjell detyrimin e organit procedues për t'i plotësuar.

42. Në konsideratë të rastit konkret dhe përsa lidhen me të, Kolegji vlerëson të sjellë në vëmendje disa nga të drejtat e viktimës së veprës penale. Një nga të drejtat e viktimës është të kërkojë ndjekjen penale të fajtorit (neni 58/1, shkronja "a", e KPP). Kjo e drejtë e viktimës së veprës penale lidhet me të drejtën e saj për të kërkuar që nga ana e organit të akuzës të ushtrohet ndjekja penale në rastet kur vepra ndiqet kryesisht ose me të drejtën e saj për të kërkuar ushtrimin e ndjekjes penale, duke paraqitur ankim për rastet e parashikuara në nenin 284 të KPP. Neni 58 i këtij Kodi parashikon edhe të drejtën e viktimës së veprës penale që të kërkojë në çdo kohë informacion për gjendjen e procedimit, si dhe të njihet me aktet e provat, pa cenuar parimin e sekretit hetimor (neni 58/1, shkronja "d" i KPP). Në këtë pikë, Kolegji thekson se e drejta e informimit të viktimës është një nga të drejtat thelbësore të saj, të cilat i mundësojnë akses në procedimin penal. Për rrjedhojë, duke pasur të drejtë për një informacion të tillë, është e qartë se kjo është një nga të drejtat themelore të procedurës, për respektimin e të cilës organi procedues duhet të tregojë kujdes të veçantë. Kjo e drejtë e viktimës lidhet me detyrimin e prokurorit për t'i vënë në dispozicion viktimës informacionin e kërkuar, me përjashtim të rasteve kur cenohet parimi i sekretit hetimor. Kjo e drejtë detajohet më tej në nenin 279/a të KPP (dispozitë e shtuar me ligjin nr. 35/2017). Gjithashtu, viktimat e veprës penale ka të drejtë të ketë informacion mbi fatin e hetimit dhe gjykimin (neni 58/1, shkronja "ë" i KPP). Kjo e drejtë e saj është reflektuar edhe në dispozitat e tjera të KPP, në të cilat ligjvënësi ka përcaktuar detyrimin e organit procedues përkatës për të njoftuar viktimën mbi fillimin, vijimin dhe përfundimin e procedimit penal. Konkretisht, në nenin 291, pika 2, të KPP ligji parashikon detyrimin e prokurorit për t'i njoftuar menjëherë viktimës së veprës penale vendimin e mosfillimit të procedimit. Po kështu, në nenin 328, pika 2, ligjvënësi ka parashikuar detyrimin e prokurorit

për t'i njoftuar brenda 5 ditëve viktimës së veprës penale vendimin e tij për pushimin e akuzës ose çështjes në rastin kur procedohet për kundërvajtje. Nga ana tjetër, gjykata ka detyrimin të njoftojë viktimën e veprës penale për të marrë pjesë si në seancën paraprake (neni 332/a, pika 1), ashtu edhe në gjykimin e themelit (neni 333, pika 2), si dhe t'i komunikojë asaj vendimin përfundimtar në rastet kur nuk është e pranishme në gjykim.

43. Kolegji konstaton se në rastin konkret, kallëzuesja (viktima) Rajmonda Nika, ka paraqitur (bashke me subjekte të tjerë - viktima të ngjarjes kriminale) kallëzim penal me shkrim pranë Prokurorisë së Posaçme, në konformitet me përcaktimet e nenit 283 të KPP, (që parashikon kallëzimin e shtetasve) duke dhënë “njoftim për një vepër penale” që ndiqet kryesisht. **Në këtë kallëzim përmbahen elementet thelbësor të faktit, burimet e provës, si dhe gjeneralitetet e personave që i atribuohet fakti penal,** të cilët për aq sa identifikohen përkojnë me subjekte të posaçme në kuptim të nenit 75/a të KPP. Nga ana tjetër, konstatohet se Prokuroria e Posaçme – prokurori - që ka marrë këtë “njoftim për vepër penale” - nëpërmjet drejtuesit të saj- me shkresën Nr.K. 137/1.Prot. A/SH, datë 24.02.2023 – ndonëse - në thelb - është shprehur për “papërshtatshmërinë e këtij njoftimi për të integruar ciësitë e njoftimit për veprën penale – notitia criminis – për shkak të mungesës së indicieve individualizuese të kryerjes së veprës penale prej subjekteve të posaçëm të kallëzuar – i konfirmuar ky konkluzion (gjithnjë sipas përmbajtjes së disponimit të prokurorit) edhe prej hetimeve të zhvilluara prej kohësh por edhe aktualisht lidhur me këtë ngjarje - prej prokurorit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë – ka dërguar kallëzimin – “njoftimin për veprën penale” - për “kompetencë lëndore” në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë.

19. Kallëzimi i falsifikuar, i cituar më sipër, i cili është vetëm një faqe dhe ngre pretendime të karakterit të përgjithshëm për favore, pasuri të dyshuara dhe lidhje të supozuara klienteliste mes një zyrtari të lartë dhe një ndërtuesi privat, nuk përmbush asnjë nga kriteret substanciale të përcaktuara nga Gjykata e Lartë në vendimin nr. 00-2024-1222, datë 12.03.2024, për t'u konsideruar si një njoftim penal i vlefshëm

(*notitia criminis*) dhe për pasojë nuk duhet të ishte regjistruar në regjistrin e njoftimeve të veprave penale. Sipas këtij vendimi, detyrimi i prokurorit për të regjistruar një kallëzim në regjistrin përkatës lind vetëm kur ai përmban elementë konkretë të figurës së veprës penale në aspektin e saj objektiv, pra përshkrimin e një veprimi të ndaluar, pasojën e tij dhe lidhjen shkakësore midis tyre. Kallëzimi i mësipërm, përkundrazi, përbëhet nga hamendje, përfytyrime subjektive dhe aludime pa kohë, pa vendndodhje të qarta, pa emra të personave juridikë të përfshirë në transaksione specifike, pa asnjë dokument referues, dhe pa asnjë akt ose veprim që të përbëjë konkretisht një element objektiv të ndonjë veprë penale.

20. Në këtë kallëzim, asnjë nga faktet nuk paraqitet me elementë të mjaftueshëm konkretizues që të përmbushin kërkesën minimale për hipoteticitetin penal në kuptimin procedural. Për shembull, nuk përshkruhet asnjë kontratë konkrete publike, nuk identifikohet asnjë procedurë prokurimi ku të jetë shkelur ndonjë normë ligjore, nuk përmendet ndonjë akt administrativ i caktuar që të ketë prodhuar favorizim të kundërligjshëm, dhe mbi të gjitha, nuk paraqitet asnjë dokument mbështetës që të përforcojë vërtetësinë e pretendimeve. Çdo referencë ndaj pasurive të supozuara, ndaj marrëdhënieve të afërta apo ndaj prishjes së një ndërtese me mjete publike është shprehur në mënyrë krejtësisht të papërcaktuar në kohë, në rrethana, dhe në lidhje shkakësore me ndonjë vepër të përcaktuar penale, duke u mbështetur në logjikën e dyshimit të lirë, e jo në strukturën e një kallëzimi penal të ligjshëm.
21. Gjykata e Lartë ka qenë e qartë në vendimin e saj: çdo “njoftim” që nuk përmban tiparet dalluese të një veprë penale të ndodhur, e rëndësishme dhe konkrete, nuk është kallëzim në kuptimin ligjor, por informacion i papërdorshëm për të aktivizuar procedimin penal. Pikërisht për këtë arsye, kjo gjykatë ka vendosur që prokurori nuk është vetëm një regjistruar mekanik i çdo akti të paraqitur në formën e një kallëzimi, por ka detyrimin të kryejë një filtër ligjor të menjëhershëm për të vlerësuar nëse njoftimi përmbush kriteret minimale për të qenë një *notitia criminis*. Në rastin konkret, mungon krejtësisht specifikimi, pra, nuk jepen të dhëna të verifikueshme që t’i japin sens real faktit të pretenduar, duke e dalluar atë nga opinioni subjektiv apo nga një dyshim abstrakt. Pretendimet për tre vila në pronësi të z. Veliaj në një kompleks privat, pa asnjë referencë për dokumentin e pronësisë, për burimin e financimit, për ndonjë

transaksion të paligjshëm, apo për ndonjë vendimmarrje administrative që të ketë sjellë përfitim të paligjshëm, nuk përbëjnë objekt juridikisht të identifikueshëm që të mund të përkufizohet si “fakt penal”.

22. Për më tepër, ky “njoftim” është i falsifikuar, i paraqitur nga një person, në emër të një personi që nuk ekziston. Edhe pse anonimati nuk është automatikisht pengesë për regjistrimin e kallëzimit, ai forcon nevojën për një analizë edhe më rigoroze të përmbajtjes, sepse prokuroria nuk ka mundësi të kërkojë sqarime shtesë nga burimi, nuk ka kush të përballojë përgjegjësinë e kallëzimit dhe nuk mund të verifikojë nëse kemi të bëjmë me një denoncim në mirëbesim apo me një formë keqpërdorimi të sistemit të ndjekjes penale. Kjo ndërlikon më tej qëndrueshmërinë ligjore të kallëzimit, duke e bërë atë edhe më të papërshtatshëm për të justifikuar regjistrimin e një procedimi penal.
23. Për më tepër, në përputhje me arsyetimin e Gjykatës së Lartë, lejimi i regjistrimit të një kallëzimi të tillë do të krijonte një precedent të rrezikshëm: ai do t’i hapte rrugën një prirjeje për të mbingarkuar organet e ndjekjes me “kallëzime” të një natyre spekulative, të cilat nuk synojnë realisht ndjekjen e një vepre penale të caktuar, por shërbejnë si instrument presioni, diskreditimi publik, ose edhe hakmarrjeje institucionale. Kjo nuk është thjesht një çështje teknike; është një problem sistematik që cenon vetë balancën institucionale të ndjekjes penale, burimet e saj të kufizuara dhe funksionin e saj legjitim. Ligji i njeh prokurorisë një kompetencë të kufizuar, të përcaktuar qartë për të ndjekur penalisht mbi bazën e njoftimeve që përmbajnë indicie të mirëfillta penale, jo për të hetuar mbi çdo opinion të pakonfirmuar, çdo aludim të përgjithshëm apo çdo shprehje të një mosbesimi personal ndaj një zyrtari.
24. Në përfundim, rasti konkret nuk përmbush as kriterin e hipoteticitetit, pasi nuk ka një fakt penal të identifikueshëm, as të specifik, pasi mungojnë elementët konkretë, kohorë, materialë dhe indiciarë. Për rrjedhojë, ky kallëzim nuk është as teknikisht, as juridikisht, një kallëzim penal. Prokuroria jo vetëm që nuk ka qenë e detyruar ta regjistrojë, por ka qenë e detyruar të vendosë mosfillimin e procedimit penal, për të shmangur instrumentalizimin e drejtësisë dhe për të ruajtur integritetin e ndjekjes penale brenda kufijve që kërkon ligji dhe jurisprudenca e lartë. Regjistrimi dhe ndjekja

e këtij lloji kallëzimi të tillë përbën cenim të barazisë së shtetasve përpara ligjit, keqpërdorim të mjeteve procedurale dhe shkelje të parimit të ligjshmërisë në ndjekjen penale.

3. Moskryerja e veprimeve hetimore në drejtim të identifikimit të kallëzuesit

25. Saktësisht në dritën e faktit që kallëzimi në fjalë është i falsifikuar, i pambështetur në prova, dhe i drejtuar ndaj një zyrtari të lartë të pushtetit vendor, konkretisht Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, mospërpyjekja e Prokurorisë për të hetuar rrethanat e autorësisë së këtij kallëzimi përbën jo vetëm një cenim të detyrimeve procedurale të prokurorit hetues, por në thelb një dështim për të ushtruar funksionin e saj institucional si garantuese e integritetit të ndjekjes penale në një rend demokratik. Në çdo sistem të së drejtës që mbështetet mbi parimet e ligjshmërisë, objektivitetit dhe proporcionalitetit, kallëzimet anonime e për më tepër ato të falsifikuara, që ngrihen ndaj funksionarëve të lartë publikë duhet të trajtohen me kujdes të shtuar, jo për t'u shpërfillur automatikisht, por për të shmangur rrezikun e shndërrimit të procedurës penale në një instrument presioni politik, linçimi publik apo goditjeje institucionale. Kjo ndjeshmëri buron nga fakti se vetë pozita e të kallëzuarit, në këtë rast një kryetar bashkie i zgjedhur me votë, ka përmasë institucionale dhe përfaqësuese, dhe çdo ndjekje ndaj tij ka pasoja që nuk kufizohen vetëm në planin individual, por prekin edhe funksionimin e qeverisjes vendore, ekuilibrat e pushteteve dhe besimin publik në neutralitetin e drejtësisë.
26. Kjo situatë, e kombinuar me kontekstin politik të kohës, i cili nuk mund dhe nuk duhet të anashkalohet apo të relativizohet nga një institucion publik si prokuroria, ngre dyshime të forta për një trajtim të njëanshëm dhe të motivuar të procedimit penal.
27. Në periudhën e realizimit të kallëzimit ndaj z. Veliaj, klima politike ishte e ngarkuar rëndë nga një presion i jashtëzakonshëm politik, i ushtruar nga opozita shqiptare dhe i përforcuar nga segmentet mediatike që e mbështesin atë. Ky presion publik dhe mediatik shërbeu si katalizator për krijimin e një atmosfere që, në mënyrë të qëllimshme apo të nënkuptuar, e ekspozoi prokurorinë ndaj një detyrimi politik për të vepruar, edhe jashtë standardeve ligjore.

28. Kjo rrethanë e bën edhe më të rëndë **mosveprimin e prokurorisë** ndaj një kallëzimi të bërë në mënyrë të hapur në **mashttrim të organit të akuzës**, duke përdorur një **sigël të falsifikuar** dhe me qëllim të qartë manipulues. Në vend që të hetonte seriozitetin dhe bazën e këtij kallëzimi, i cili që në pamje të parë paraqiste elementë të dukshëm të falsifikimit, prokuroria jo vetëm që nuk e vlerësoi atë në mënyrë të pavarur, por e shfrytëzoi si pretekst për të filluar një hetim penal ndaj kryetarit të Bashkisë së Tiranës.
29. Të gjitha këto rrethana, të vlerësuara në tërësinë e tyre, e bëjnë të pranueshëm dhe të arsyeshëm konkluzionin se prokuroria nuk ka qenë në kërkim të së vërtetës, por ka funksionuar si një instrument i heshtur apo i ndërgjegjshëm i presionit politik, duke kaluar nga mosveprimi procedural në bashkëpunim pasiv ose aktiv në ndërtimin e një procedimi penal të pajustificuar.
30. Kur një kallëzim është i falsifikuar, e vetmja mënyrë që Prokuroria të justifikojë regjistrimin e procedimit penal është të kryejë një vlerësim të hollësishëm të përmbajtjes dhe, në rast dyshimi mbi qëllimin apo burimin e informacionit, të ndërmarrë hetime proaktive për të identifikuar autorin. Kjo nuk është një zgjedhje diskrecionale, por një detyrim që buron nga natyra e veçantë e njoftimit, nga mungesa e mundësisë për ta verifikuar atë në rrugë të drejtpërdrejtë përmes kallëzuesit, si dhe nga nevoja për të ruajtur procedurën penale nga ndërhyrjet e aktorëve të padukshëm që synojnë të përdorin ndjekjen penale për qëllime jo të ligjshme, apo mw tej akoma politike.
31. Mungesa totale e çdo veprimi për të identifikuar autorin e kallëzimit në këtë rast përforcon bindjen se Prokuroria nuk ka ushtruar rolin e saj si filtër institucional, por ka vepruar në mënyrë formale dhe të njëanshme, duke trajtuar një tekst të paidentifikueshëm si të ishte një kallëzim legjitim dhe i verifikuar. Kjo mospërmbushje nuk është thjesht një neglizhencë, por për shkak të pozicionit të personit të kallëzuar, krijon dyshime serioze mbi motivimin e ndjekjes penale, paanshmërinë e hetimit dhe legjitimitetin e të gjithë procesit penal.
32. Më tej, në kushtet kur kallëzimi përmban akuza të përgjithshme, pa përshkrim faktesh konkrete, pa kohë, pa vend, pa referencë dokumentare dhe pa emërues të identifikueshëm të asnjë veprimi të paligjshëm, dhe në mungesë të çdo verifikimi

paraprak mbi burimin, vendimi i Prokurorisë për të regjistruar procedimin penal merr pamjen e një aktivizimi të qëllimshëm të ndjekjes penale mbi një bazë që nuk përmbush asnjë standard ligjor, duke e ekspozuar këtë akt si të nxitur jo nga dyshimi penal, por nga nevoja për të reaguar ndaj një sinjali publik të paautorizuar dhe të pasigurt.

33. Për më tepër, duke qenë se në përmbajtje kallëzimi i referohet pasurive, kontakteve me ndërtues, udhëtimeve dhe marrëdhënieve personale që lidhen me pozicionin zyrtar të z. Veliaj, mosverifikimi i burimit të këtij kallëzimi jo vetëm që cenon drejtësinë procedurale, por ngre edhe dyshime të bazuara se kemi të bëjmë me një kallëzim të prodhuar për qëllime destabilizuese ndaj një institucioni të zgjedhur vendor, në një kontekst politik të caktuar. Në mungesë të identifikimit të autorit, nuk mund të përjashtohet mundësia që ky kallëzim të jetë hartuar nga një subjekt privat apo institucional që ndodhet në konflikt me Bashkinë e Tiranës, që është në hetim për çështje të tjera, ose që ka interes të ndikojë në agjendën publike dhe politike përmes hetimeve penale, ku nuk përjashtohet edhe vetw organi i akuzws.
34. Në një sistem demokratik, ndjekja penale duhet të funksionojë mbi bazën e transparencës procedurale dhe llogaridhënies së çdo aktori institucional që ndikon mbi fatin penal të një individi. Një kallëzim anonim, për nga natyra, shman çdo formë llogaridhënieje nga autori i tij. Kjo mungesë përgjegjësie përmban në vetvete një rrezik të lartë që institucioni i prokurorisë të bëhet një mjet pasiv në duart e burimeve të padukshme, të cilat veprojnë pa ndonjë kufi ligjor apo etik. Nëse një kallëzim nuk ka autor dhe nuk ka përmbajtje konkrete, ai nuk është një akt juridik që gjeneron përgjegjësi, por një akt anonim i njëanshëm, që bie ndesh me kërkesat për veprim institucional të bazuar në prova, verifikim dhe gjurmueshmëri. Për më tepër që në rastin konkret kallëzimi është i falsifikuar.
35. Nëse regjistrohet një procedim penal ndaj një zyrtari të lartë publik në bazë të një kallëzimi të falsifikuar, pa verifikim të burimit dhe pa prova konkrete, ky akt prodhon një efekt të menjëhershëm publik që i paraprin çdo vlerësimi gjyqësor. Në rastin e një kryebashkiaku siç është z. Veliaj, rreziku është i dyfishtë: jo vetëm që individi dhe të drejtat e tij kushtetuese vihet nën një dritë të rëndë publike, por edhe institucioni që ai

përfaqëson dëmtohet në autoritetin e tij institucional, në stabilitetin administrativ dhe në marrëdhënien me qytetarët.

36. Procedimi penal nuk është një qëllim në vetvete, por një mjet i shtetit të së drejtës për të garantuar rendin ligjor dhe mirëqeverisjen publike, në përputhje me Kushtetutën dhe të drejtat themelore të njeriut. Në këtë kuadër, është e papranueshme që ky instrument të përdoret në mënyrë të pakujdesshme ose me qëllim politik, në dëm të funksionimit të rregullt të institucioneve të zgjedhura. Madje vetë qytetarët dhe e drejta e tyre për të zgjedhur qeverisjen e tyre lokale dëmtohen drejtpërdrejt nga fillimi i një procedimi penal mbi baza krejtësisht të pakujdesshme apo më tej, të qëllimshme, duke u mohuar në këtë mënyrë qytetarëve të kryeqytetit të drejtën e tyre për t'u qeverisur. Procedimi penal nuk mund të jetë instrument për të ndërprerë përfaqësimin politik të votuar nga sovrani popullor, për më tepër kur bazohet në një kallëzim të falsifikuar dhe në një hetim të nisur në mënyrë të njëanshme. Nëse në emër të mirëqeverisjes pezullohet vetë qeverisja, atëherë procedura nuk shërben më interesin publik, por shkatërron vetë themelet e demokracisë përfaqësuese.
37. Ky dëm, shpeshherë i pakthyeshëm, nuk mund të justifikohet me idenë se “Prokuroria po bën punën e saj”, kur në fakt nuk ka asnjë element objektiv që të legjitimojë regjistrimin e procedimit. Në këtë pikë, ndjekja penale shndërrohet nga një mjet për mbrojtjen e interesit publik në një rrezik për integritetin institucional dhe rendin kushtetues lokal dhe autonominë vendore.
38. Praktika e mosregjistrimit formal të një personi si subjekt i kallzuar, ndërkohë që ndaj tij kryhen hetime aktive (shkelje që do të elaborohet më poshtë), e kombinuar me përdorimin e një kallëzimi anonim si justifikim formal për nisjen e ndjekjes penale, krijon një precedent thellësisht të rrezikshëm: legalizimin e një faze paralele hetimore joformale, të paautorizuar dhe të pakontrolluar gjyqësisht. Një praktikë e tillë bie ndesh në mënyrë flagrante me qëllimin e dispozitave të Kodit të Procedurës Penale dhe me vetë parimet e procesit të rregullt ligjor, të cilat kërkojnë që çdo person që është në realitet objekt i hetimit të gëzojë garanci të plota procedurale që në fazën më të hershme të tij. Përdorimi i kallëzimeve të tilla anonime si mekanizëm procedural për të kaluar nga një hetim i fshehtë në ndjekje zyrtare nuk është veçse një regres i rrezikshëm

drejt arbitraritetit hetimor, ku e drejta për mbrojtje, parimi i kontradiktoritetit dhe siguria juridike sakrifikohen në emër të një efikasiteti të rremë dhe të pajustificuar nga asnjë interes legjitim të shtetit të së drejtës. Në përputhje me parimet kushtetuese të ndarjes së pushteteve dhe balancës institucionale, Prokuroria ka përgjegjësi jo vetëm për të ndjekur penalisht autorët e veprave penale, por edhe për të ruajtur vetë integritetin e funksionit të saj nga ndikimet e jashtme, përfshirë ato politike, ekonomike apo mediatike. Regjistrimi i një procedimi penal mbi bazën e një dokumenti anonim, pa asnjë verifikim të burimit dhe pa prova, përbën një dështim për të mbrojtur vetë funksionin e saj nga instrumentalizimi. Nëse burimi është anonim apo i falsifikuar, përmbajtja e kallëzimit është e përgjithshme dhe nuk kryhen as veprime hetimore minimale për të identifikuar kush fshihet pas falsifikimit, atëherë Prokuroria vetë bëhet një hallkë në zinxhirin e instrumentalizimit, në vend që të jetë një filtër i drejtësisë dhe neutralitetit.

39. Për të gjitha këto arsye, në rrethanat konkrete, moskryerja e hetimeve për të identifikuar autorin e kallëzimit nuk përbën thjesht një cenim të ligjshmërisë procedurale, por është një faktor i drejtpërdrejtë që komprometon paanshmërinë reale dhe të perceptuar të procesit penal dhe, rrjedhimisht, legjitimitetin e tij. Prokuroria ka pasur jo vetëm mundësinë faktike, por edhe detyrimin kushtetues dhe ligjor për të vepruar me kujdes të shtuar, për të verifikuar origjinën dhe autenticitetin e kallëzimit, dhe për të garantuar që procedura penale nuk përdoret si instrument për qëllime të tjera: politike, personale apo institucionale. Mospërmbushja e këtij detyrimi përbën jo vetëm mungesë objektiviteti hetimor, por një shkelje të drejtpërdrejtë të parimeve themelore të procesit të rregullt ligjor, përfshirë sigurinë juridike, barazinë e palëve dhe ndarjen funksionale të pushteteve në një shtet demokratik. Kur organi i ndjekjes penale shmanget me vetëdije verifikimin e një kallëzimi të rremë, rreziku që ai të jetë bërë palë me interesa të jashtme të procesit nuk është më hipotetik, por real dhe i dokumentueshëm.

4. Kryerja e hetimeve në tejkalim të afateve procedurale ligjore

40. Në një shtet të së drejtës, një ndër shtyllat themelore të një procedimi penal është respektimi i standardeve të ligjshmërisë që rregullojnë regjistrimin e ndjekjes penale

dhe të drejtën e subjektit nën hetim për të ushtruar mbrojtjen e tij në çdo fazë të procesit. Në rastin konkret, është e qartë se Prokuroria e Posaçme ka ndërtuar një hetim të qëllimshëm ndaj një personi të identifikuar që në muajin shkurt 2024, z. Erion Veliaj, Kryetar i Bashkisë Tiranë, pa e formalizuar në kohën e parashikuar nga ligji, regjistrimin e emrit të tij në regjistrin e njoftimit të veprës penale, siç kërkohet në mënyrë eksplicite nga ligji procedural penal. Kjo zgjedhje e qëllimshme, për të zhvilluar një hetim të gjatë, kompleks dhe të thelluar në mungesë të formalizimit të statusit procedural të personit, përbën një shmangie serioze nga standardet e ligjshmërisë procedurale dhe një mohim efektiv të të drejtave të mbrojtjes.

41. Regjistrimi i një procedimi penal duhet të paraprihet nga dy elementë thelbësorë: ekzistenca e një dyshimi të arsyeshëm mbi një vepër penale dhe identifikimi i indicieve që lidhen me këtë vepër. Në këtë rast, ajo që ndodhi në praktikë ishte e kundërta: u piketua fillimisht individi dhe më pas u ndërtua përreth tij një kornizë akuzuese, duke filluar një hetim “de facto” shumë kohë përpara formalizimit të ndjekjes “de jure”. Megjithëse procedura hetimore ishte përqendruar gjatë në drejtim të z. Veliaj, prokuroria ka zgjedhur të përfshijë emrin e tij në regjistrin përkatës vetëm në momentin e paraqitjes së kërkesës për masë sigurimi, jo në fillim të hetimeve, siç kërkon ligji, por vetëm në pikën kur duhej të mbështeste një kërkesë për marrjen e një mase sigurimi ndaj tij.
42. Prokuroria e Posaçme, pavarësisht se hetimin e kishte orientuar drejt një personi të caktuar, të identifikuar që në Shkurt 2024 si Kryetari i Bashkisë Tiranë, madje edhe vetë kallëzimi drejtohej kundër z. Veliaj, Prokuroria e Posaçme sërish ka zgjedhur të shënojë emrin e tij në regjistrin për njoftimin e veprës penale ditën e paraqitjes së kërkesës në Gjykatë për caktim mase sigurimi. Ndaj edhe vendimi i Gjykatës bazohet në akte procedurale absolutisht të pavlefshme dhe në prova të papërdorshme, në shkelje të nenit 151 pika 3 e K.Pr.Penale.
43. Plot 7 muaj i janë dashur Prokurorisë së Posaçme dhe BKH-së për hetimin e një kallëzimi të falsifikuar, gjithsej 1 fletë, ndërkohë që brenda 15 ditëve prokurori duhet të kishte konstatuar ekzistencën e rrethanave që nuk lejojnë fillimin e një procedimi penal, apo në të kundërt, të kishte regjistruar procedim penal. Për më tepër që përmbajtja e

këtij kallëzimi anonim lidhet me fakte të njohura për publikun (si psh emërimi i z. Veliaj si Ministër i Punës dhe znj. Sula si zv.Ministre) që nuk pse të marrin shumë muaj kohë për t'u verifikuar nga një strukturë e specializuar si Prokuroria e Posaçme.

44. Veprimet e kryera nga prokuroria nuk kanë pasur karakter verifikues, por hetimor në kuptimin e plotë të fjalës. Sipas ligjit, veprimet e verifikimit kufizohen vetëm në marrjen e informacionit nga burime të hapura ose joformale, pa përdorimin e autoritetit publik kushtetues që i jepet prokurorit vetëm pas regjistrimit të procedimit penal. Në rastin konkret, prokuroria ka ndërmarrë veprime të natyrës hetimore përmes kërkesash dhe urdhrash zyrtarë drejtuar institucioneve shtetërore dhe subjekteve private duke përdorur mjetet ligjore të rezervuara për fazën e hetimit, pa regjistruar më parë procedimin penal dhe pa identifikuar subjektin ndaj të cilit i atribuohet vepra penale. Në këtë moment, prokurori ka vepruar brenda një kompetence që ligjërisht i njihet vetëm pas fillimit të procedimit penal, duke shkelur qartazi ndarjen mes fazës së verifikimit paraprak dhe ushtrimit të pushtetit hetimor. Kjo përbën jo vetëm një tejkalim të kompetencës së prokurorisë, por edhe një shkelje të së drejtës për siguri juridike, pasi veprimet hetimore janë kryer jashtë çdo forme procedurale të parashikuar nga ligji.
45. Çdo të dhënë shkresore që ka prodhuar verifikimi i kryer përtej këtij afati ligjor procedural, nuk mund të shërbejë si element i vlefshëm (burim prove apo indicie) që mund t'i bashkalidhet një kallëzimi anonim apo të përbëjë bazë të mjaftueshme të dhënash për të urdhëruar regjistrimin e një procedimi penal. Tejkalimi i këtyre afateve ligjore flet qartazi për njëanshmëri në hetim, për të prodhuar medoemos një procedim pa patur fakt penal, por edhe kur fakti i pretenduar është orientuar drejt një personi konkret, nuk ka asnjë të dhënë minimale për të urdhëruar shënimin e emrit të tij në regjistrin për njoftimin e veprave penale.
46. Në datën 8 Shkurt 2024 Prokuroria e Posaçme ka administruar informacionin për referimin e veprës penale nga BKH-ja dhe po atë ditë, mqs ka patur dyshime për ekzistencën e veprës penale të parashikuar nga neni 260 i Kodit Penal, ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal Nr.27 të vitit 2024, pa autor konkret, edhe pse i hetuar de facto prej asaj kohe ka qënë Kryetari i Bashkisë Tiranë. Ky referim policor ka patur

synim verifikimin e rrethanave që paraqiste kallëzuesi anonim në Korrik 2023, pa cituar asnjë të dhënë që krijon dyshim për akt korruptiv, aq më pak për vepra të tjera si pastrimi i produkteve të veprës penale etj.

47. Prokurori ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal nr.27/2024 mbi bazën e kallëzimit të “Nesti Angoni” dhe referimit të hetuesve të BKH-së. Ky procedim penal është regjistruar pa autor, edhe pse i kallëzuari apo personi konkret që do të hetohej ishte identifikuar me emër konkret, madje vet Prokuroria e Posaçme në urdhrin e tij për fillimin e çështjes, përveç faktit penal objekt hetimi, citon emrin e z. Erion Veliaj, edhe më vonë kur pasqyron ndryshime në regjistër për veprat penale objekt hetimi. Duke vepruar në këtë mënyrë, Prokuroria e Posaçme ka përfituar padrejtësisht afate hetimore e në mënyrë abuzive, edhe pse kishte të dhëna të plota për emrin e personit që duhet të hetonte, nuk ka shënuar në regjistër emrin e tij deri në datën 24.01.2025. Pra prokurori ka mbuluar tejkalimin e afateve hetimore, shkeljen e neneve 323, 324 dhe 325 të K.Pr.Penale, duke i dhënë vetes atributet e një Gjykate që legjitimon zgjatjen e hetimeve dhe njëkohësisht ka prodhuar hetime të njëanshme, sepse nuk i ka dhënë mundësinë personave nën hetim të ushtrojnë të drejtat e tyre kushtetuese dhe procedurale. Duke mos e regjistruar emrin e personit të cilit i atribuohet vepra penale, edhe pse dihej se cili do të ishte personi që po hetohej prej vitit 2023, prokurori ka cënuar interesat e ligjshëm të personit apo subjekteve juridike që faktikisht janë nën presionin e hetimit e që në bazë të ligjit dhe Kushtetutës, mund të mbahen në hetim vetëm për një afat të arsyeshëm. Madje personat *de facto* nën hetim, duke u thirrur e pasur *de jure* pozitën e personit që ka dijeni për rrethanat e hetimit, përpos detyrimit për të dëshmuar, vihen në një pozitë të disfavorshme në krahasim me organin e akuzës dhe detyrohen të dëshmojnë ndaj njëri-tjetrit, në kundërshtim me nenet 37, 157.2 apo 158 të K.Pr.Penale.

48. Vetë fakti se procedimi penal është regjistruar për një “zyrtar të lartë”, tregon qartë se organi i akuzës e ka ditur dhe synuar konkretisht hetimin e Erion Veliajt. Ky fakt provon se që në momentin e regjistrimit të procedimit penal, prokuroria e ka ditur me saktësi ndaj kujt subjekti po ushtronte ndjekje penale, por ka shmangur qëllimisht formalizimin e këtij statusi për të mos i njohur personit asnjë nga të drejtat që burojnë nga Kushtetuta dhe Kodi i Procedurës Penale. Me vendimin e datës 27.12.2024 organi i

akuzës ka vlerësuar të urdhërojë shënimin në regjistrin për njoftimin e veprave penale nenet 245, 287/2 e 257/a/2 të Kodit Penal, edhe këto vepra objekt hetimi nuk i atribuohen deri në këtë datë ndonjë personi konkret. Njëkohësisht me paraqitjen e kërkesës për caktim mase sigurimi sipas nenit 244 të K.Pr.Penale, Prokuroria e Posaçme ka urdhëruar shënimin në regjistër për njoftimin e veprave penale të emrit të personit nën hetim Erion Veliaj, si i dyshuar për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 260-25 dhe 287/2 të Kodit Penal.

49. Nga aktet e dosjes rezulton se hetuesit e BKH kanë zhvilluar një sërë veprimesh verifikimi, vëzhgimi, identifikimi dhe analizimi të të dhënave që në mënyrë të qartë përbëjnë akte tipike procedurale, përpara se prokurori të kryente zyrtarisht një regjistrim të procedimit penal. Konkretisht përgjatë periudhës nga data 19.07.2023 (data kur është depozituar kallëzimi nga personi anonim) deri në datën 08.02.2024 (data kur është regjistruar procedimi penal) hetuesit e BKH kanë kryer një sërë veprimesh procedurale rreth këtij kallëzimi si: Verifikime në sistemin ASHK mbi pasuritë e Erion Veliaj dhe familjarëve të tij; Verifikime në sistemin TIMS për lëvizjet e tij; Kqyrje dhe analiza të llogarive bankare të tij dhe të personave të lidhur; Administrim të të dhënave nga QKB dhe ILDKPKI; Mbledhje të informacionit nga burime të ndryshme të mbyllura dhe sensitive, të gjitha këto jashtë kompetencave të policisë gjyqësore dhe pa akt delegimi nga ana e prokurorit të çështjes, pasi çështja nuk ishte e regjistruar. Mjafton ky fakt, që aktet e mbajtura nga policia gjyqësore të konsiderohen absolutisht të pavlefshme.
50. Në përputhje me të drejtën për proces të rregullt ligjor, çdo veprim procedural duhet të kryhet në përputhje me parashikimet përkatëse ligjore. Në fakt rezulton se hetuesit e BKH kanë kryer akte procedurale para se të regjistrohej procedimi penal, në kundërshtim me parashikimet e KPP duke i hequr praktikisht personit nën hetim Erion Veliaj çdo mundësi të ushtronte të drejtat dhe përfitonte nga garancitë procedurale që do të rridhnin nga statusi i personit nën hetim: e drejta për t'u njohur në kohën e duhur lidhur me veprën penale për të cilën hetohet (neni 34/a, pika 1, shkronja "a" e KPP); e drejta për të zgjedhur një mbrojtës (neni 34/a, pika 1, shkronja "ç" e KPP); e drejta për të kundërshtuar apo kryer veprime hetimore që kundërshtojnë provat e organit procedues (neni 34/a, pika 1, shkronja "e" e KPP).

51. Përdorimi i të dhënave të mbledhura nga hetuesit e BKH në kundërshtim me dispozitat procedurale, i ka hequr arbitrarisht personit nën hetim Erion Veliaj çdo të drejtë për t'u mbrojtur që në fazë të hershme. Duke qenë se këto veprime procedurale janë kryer para se regjistrohej procedimi penal, personi nën hetim Erion Veliaj është ekspozuar ndaj një pozicioni të disfavorshëm duke mos pasur asnjë mundësi të zgjidhte mbrojtës apo të mbrohej vetë pasi formalisht nuk kishte marrë ende statusin procedural të personit nën hetim duke cënuar në thelb të drejtën e tij për një mbrojtje efektive.
52. Ky formalizim i vonuar i regjistrimit të emrit të personit që i atribuohet vepra penale në regjistër, përbën jo vetëm një cenim të së drejtës për t'u mbrojtur përgjatë hetimeve paraprake, e drejta për t'ju drejtuar gjykatës së hetimit paraprak, por edhe një mungesë transparence që e bën procedimin penal të pabesueshëm nga pikëpamja e drejtësisë procedurale. Duke mos qenë i regjistruar si person nën hetim gjatë gjithë fazës së parë të procedimit, z. Veliaj është vendosur në pozitën e një subjekti realisht të hetuar, por ligjërisht të përjashtuar nga çdo garanci që rrjedh prej këtij statusi, përfshirë të drejtën për të ushtruar kërkesa, për të paraqitur prova, për t'u njoftuar për aktet, apo për të ndjekur zhvillimin e hetimeve në mënyrë efektive. Neni 287 i Kodit të Procedurës Penale parashikon:

Neni 287

Regjistrimi i njoftimit të veprave penale

1. Prokurori shënon në regjistër ***çdo*** njoftim të veprës penale që i vjen ose që ka marrë me iniciativën e vet dhe ***në të njëjtën kohë ose nga momenti në të cilin rezulton, emrin e personit të cilit i atribuohet vepra penale.***

2. Kur gjatë hetimeve paraprake ndryshon cilësimi juridik ose ndonjë rrethanë e kryerjes së veprës penale, prokurori urdhëron pasqyrimin e tyre në shënimet e bëra sipas paragrafit 1 të këtij neni.

3. Ndalohet publikimi i regjistrimeve të bëra deri në marrjen si të pandehur të personit që i atribuohet vepra penale.

53. Ky parashikim përcakton dy elemente të rëndësishëm të procedimit penal: prokurori është i vetmi organ procedues që ka kompetencën për të autorizuar nisjen e një

procedimi penal; aktet procedurale mund të kryhen vetëm pas formalizimit të këtij momenti procedural përmes regjistrimit nga prokurori të njoftimit të veprës penale në regjistrin e veprave penale, regjistrimi që shënon proceduralisht edhe pikënisjen formale të procedimit penal. Ky parashikim është thelbësor, jo vetëm për të përcaktuar formalisht datën e fillimit të procedimit penal, por sidomos për të vendosur vijën ndarëse ndërmjet fazës paraprake të mbledhjes së të dhënave dhe informacioneve nga burime të hapura nga ana e agjencive ligjzbatuese dhe fazës së procedimit penal.

54. Në kuptimin praktik ky regjistrim ka rëndësi pasi ndihmon organet ligjzbatuese për të kuptuar se ato mund të kryejnë akte procedurale vetëm pas këtij regjistrimi. Ndërsa në kuptimin doktrinar, rëndësia e parashikimit të kompetencës së prokurorit për të shënuar nisjen e procedimit penal me anë të këtij regjistrimi, është se aktet procedurale ndryshojnë nga veprimet e kryera nga organet ligjzbatuese para regjistrimit të procedimit penal, pasi ato për nga natyra kanë karakter invaziv ndaj të drejtave dhe lirive të individit. Për këtë arsye kryerja e tyre duhet të kryhet vetëm me autorizimin e prokurorit i cili kryen edhe kontrollin e procedurave të ndjekura për kryerjen e tyre, me qëllim zbatimin në çdo rast të garancive dhe të drejtave procedurale për personin nën hetim si e drejta për t'u njohur me aktet procedurale, e drejta për t'u ndihmuar nga një mbrojtës, e drejta për të marrë pjesë në disa veprime procedurale, e drejta për të kundërshtuar aktet procedurale, për të bërë kërkesa për marrjen e provave në favor të tij etj. Kjo do të thotë se nëse një veprim procedural që i përket fazës së procedimit penal kryhet përpara regjistrimit të procedimit penal, ai veprim proceduralisht është një akt procedural i papërdorshëm për shkak të mosrespektimit të këtij ndalimi.
55. Detyrimi i prokurorit i përcaktuar në këtë nen përbën garanci procedurale dhe kusht për respektimin e të drejtave të personit ndaj të cilit zhvillohen hetime. Sa më sipër lidhet me fillimin e afatit të hetimeve të zhvilluara nga prokurori.
56. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në Vendimin Unifikues nr.3, datë 27.09.2002 kanë trajtuar qartë konceptin e subjektit procedural të cilit “i atribuohet” vepra penale, duke përcaktuar në këtë mënyrë edhe momentin se kur subjekti merr statusin e “personit të cilit i atribuohet vepra penale”. Sipas këtij vendimi unikues, nëse kallëzuesi e përcakton në kallëzim personin që ai mendon se ka kryer veprat

penale objekt kallëzimi, prokurori do të duhet të regjistrojë emrin e këtij personi në cilësinë e “personit të cilit i atribuohet vepra penale”, më konkretisht:

Terminologjia e përdorur nga Kodi i Procedurës Penale, gjatë fazave të ndryshme të procedimit penal, ndryshon nga çasti i fillimit të marrjes dijeni për veprën penale deri në përgatitjen dhe dërgimin e çështjes penale për gjykim. Cilësimi dhe emërtimi i subjekteve dhe i personave në raport me veprën penale fillojnë me termin: “personi, të cilit i atribuohet vepra penale” (neni 287 K.Pr.Penale), “person, ndaj të cilit zhvillohen hetime” (nenet 293/1, 295/1, 296/1 e 2, 302, 303/2 – “b” e “d” dhe 308, etj.) dhe më pas “i pandehur” që ndeshet në shumë dispozita të Kodit të Procedurës Penale. Autori i mundshëm i veprës penale mund t’i marrë këto emërtime në faza të ndryshme të procedimit penal. Këto emërtime nuk përfaqësojnë të njëjtën gjë dhe nuk kanë të njëjtin kuptim.

*Termi “person, të cilit i atribuohet vepra penale”, parashikohet në nenin 287 të K.Pr.Penale dhe ligjvënësi jo pa qëllim e ka përdorur atë në kreun e dytë të titullit të gjashtë të K.Pr.Penale, ku flitet për mënyrën se si njoftohet dhe merret dijeni për një vepër penale nga ana e prokurorit dhe policisë. **Cilësia e personit, të cilit i atribuohet vepra penale, fillon: a) ose kur njoftuesi i saj mendon se e di, se cili mund të jetë autori i veprës penale dhe prokurori shënon paralelisht në regjistrin e njoftimeve të veprave penale, krahas veprës edhe emrin e personit kur ai njihet, ose b) mbasi është bërë regjistrimi i veprës penale, që nga çasti i mëtejshëm kur nga hetimet rezulton një emër personi të cilit, i atribuohet vepra penale. Në këto kushte, nuk ka asnjë dyshim se ky cilësim i përket fazës fillestare të procedimit penal. Përcaktimi i termit: “person, të cilit i atribuohet vepra penale”, i marrë në kontekstin e përcaktuar nga neni 287 i K.Pr.Penale, si dhe pasur parasysh fazën procedurale në të cilën ai përdoret, do të thotë se ai nuk mund të barazohet me termin: “person, ndaj të cilit zhvillohen hetime”, e as me termin person “i pandehur”. Emri i personit, të cilit i atribuohet vepra penale shënohet në regjistër vetëm në ato raste kur ai është i njohur, por mund të ketë edhe raste kur, shpeshherë, kallëzuesi apo autoriteti referues nuk është akoma në gjendje***

të tregojë se kush mund të mendohet si autor i mundshëm i një veprë penale në fillimin e hetimeve. **Atribuimi i faktit që përbën veprë penale ndaj një personi, nuk do të thotë se personi ka realisht lidhje me veprën penale.** Lidhja e veprës penale me një emër personi, mund të dalë vetëm me kryerjen e hetimeve dhe të dhënave të mbledhura, prej të cilave do të rezultojë një lidhje mes veprës penale që procedohet dhe përgjegjësisë së prezumuar të një personi të caktuar. Vetëm pas daljes së kësaj lidhje dhe në çastin kur identifikohet emri i personit (neni 293 K.Pr.Penale) vepra penale mund t'i atribuohet një personi të caktuar.

PRA, KRAHAS LAJMIT PËR KRYERJEN E NJË VEPRE PENALE OË MERRET ME KALLËZIMIN APO REFERIMIN, NË REGJISTËR SHËNOHET EDHE EMRI I PERSONIT, TË CILIT “I ATRIBUOHET” VEPRA PENALE.

Me avancimin e fazës së hetimeve paraprake, kuptohet se ndryshon dhe gjendja procedurale penale e subjektit të veprës penale, i cili nga cilësia e personit që i atribuohet vepra penale, kalon në cilësinë e “personit ndaj të cilit, zhvillohen hetime”. Fakt ky që nënkupton se gjatë hetimeve paraprake, nga momenti fillestar i çeljes së procedimit penal kanë filluar të mblidhen të dhëna, të cilat janë në gjendje të mbështesin akuzën që do të mund të ngrihet në fazën e gjykimit. Termi: personi ndaj të cilit zhvillohen hetime është frymëzuar nga sistemet procedurale penale që pranojnë rregullin, sipas të cilit, cilësimi si i pandehur bëhet në përfundim të hetimeve, vetëm atëherë kur ka elemente për të vendosur që çështja penale mund t'i kalojë gjykatës për gjykim. Edhe ky cilësim i dytë që merr autori i mundshëm i veprës penale gjatë hetimeve paraprake nuk mund të barazohet me termin “i pandehur”. Personi ndaj të cilit zhvillohen hetimet është një figurë procedurale e ndërmjetme që qëndron midis asaj që Kodi Procedurës Penale quan “person, të cilit i atribuohet vepra penale” dhe “të pandehurit”. Vetëm drejt çasteve të përfundimit të fazës së hetimeve paraprake, Kodi i Procedurës Penale përdor termin “i pandehur”. I pandehuri është personi që i atribuohet formalisht vepra penale me aktin e njoftimit të akuzës. Ky status procedural është më i avancuar dhe relativisht më i qëndrueshëm, i cili ruhet i pandryshuar, në çdo

gjendje dhe shkallë të procesit penal, derisa të ketë marrë formë të prerë vendimi i pushimit, i pafajësisë ose fajësisë (neni 34/2 i K.Pr.Penale).

Sa më sipër, arrihet në përfundimin se figura procedurale e autorit të mundshëm të veprës penale që nga çasti i njoftimit të saj në prokurori e deri në momentin e përfundimit të hetimeve paraprake (neni 327 i K.Pr.Penale), evoluon gradualisht nga “personi, të cilit i atribuohet vepra penale” në “personin ndaj të cilit zhvillohen hetime” dhe së fundmi në atë të “të pandehurit”, pavarësisht nëse çështja pushohet (neni 328) apo dërgohet për gjykim (neni 331). Si rregull, statusi i të pandehurit merret në përfundim të hetimeve paraprake përpara se të depozitohet fashikulli i gjykit, por ky status mund të merret edhe me përpara. Kjo është në çmimin e prokurorit, i cili mund të bëjë njoftimin e akuzës në çdo fazë të hetimeve, deri në përfundimin e tyre, pasi ai të ketë mbledhur të dhënat e mjaftueshme (neni 34/1 i K.Pr.Penale).

57. Ndërkohë në vendimi unifikues nr.2, datë 20.06.2013 Kolegjet e Bashkuara shprehen:

*Procedimi penal merr shkas nga njoftimi që merr prokurori kryesisht apo nga policia gjyqësore, por edhe nga kallëzimi i shtetasve apo personave juridikë për ngjarjen e një vepre penale. Prokurori **regjistron** procedimin penal fillimisht për veprën që ai ka marrë njoftim se është kryer e, sipas rastit, edhe emrin e personit që i atribuohet vepra penale. **Është pikërisht ky momenti që prokurori ka mundësi të verifikojë nëse ndodhemi para rasteve të parashikuara prej nenit 290 të Kodit të Procedurës Penale, pra nëse ndodhemi përpara rrethanave që nuk lejojnë fillimin e procedimit penal dhe që legjitimojnë marrjen e vendimit mbi mosfillimin e procedimit penal.** Rastet e mosfillimit të çështjes penale nuk kërkojnë ndonjë hetim të thellë. Konstatimi i rrethanave është i lehtë dhe përgjithësisht bëhet para fillimit të procedimit penal, për këtë, mjaftojnë vetëm disa verifikime të shpejta për të konkluduar rreth marrjes së një vendimi mosfillimi. Si subjekte që marrin pjesë në këtë*

fazë, përveç prokurorit dhe policisë gjyqësore, janë edhe kallëzuesi, si njoftues i veprës penale, e në varësi të rast.

58. Gjithashtu, Vendimi nr. 7 datë 16.01.2012 i Gjykatës Kushtetuese, pasi afirmon vendimin unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr.3, datë 27.09.2022 shprehen se nëse kallëzuesi në kallëzimin e tij mendon se një person i caktuar është autor i ndonjë veprë penale, ky person të cilit kallëzuesi i atribuon autorësinë e veprës penale do të duhet të regjistrohet në pozitën e personit të cilit i atribuohet veprë penale.
59. Në një prej dokumenteve të hartuara në kuadër të monitorimit të zbatimit të reformës në drejtësi¹ evidentohet në mënyrë konkrete se pse prokurorët e çështjes kanë zgjedhur të shkelin haptazi parashikimet e ligjit të posaçëm procedural duke mos e regjistruar z. Veliaj në regjistër. Në nënpikën me titull “*Tejzgjatje fizike e fazës së hetimit paraprak*”, evidentohet:

Shpesh, prokurorët regjistrojnë procedimin penal pa autorë me qëllim mos kalimin e afateve të hetimit paraprak, të cilat janë 3 muaj për prokurorinë e zakonshme dhe 6 muaj për prokurorinë speciale SPAK, nga momenti që regjistrohet procedimi penal me autor. Ndërkohë, pa e regjistruar subjektin si person nën hetim, prokurorët vazhdojnë dhe kryejnë veprime hetimore të tilla si, pyetja e personit të dyshuar si person nën hetim, marrja e provës me ekspert, kryerja e ballafaqimeve, ekspertimi, njohja, marrja e provave të tjera. Këto prova nuk i njoftohen këtij personi, gjatë marrjes së tyre. Pra, të gjitha këto veprime tregojnë qartazi se ky person ka statusin e personit nën hetim, pasi të gjitha veprimet po drejtohen ndaj tij, por prokuroria nuk i jep akses që të jetë prezent, apo t’i njoftohen provat gjatë marrjes së tyre, duke mos garantuar kështu akses në hetimin paraprak dhe në drejtësi në përgjithësi. Provat e marra në këtë mënyrë nga prokurori, gjatë fazës së hetimit paraprak, mund të bëhen të papërdorshme, pasi janë bërë në përfundim të hetimit paraprak. Gjykata në

¹ Monitorimi i zbatimit të ndryshimeve të Kodit të Procedurës Penale për aksesin në drejtësi të viktimës dhe të të pandehurit V Tiranë, 2020, përgatitur në kuadër të projektit “Monitorimi i Zbatimit të Reformës në Drejtësi”, zbatuar nga Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, faqe 55

seancë paraprake mund t'i kthejë aktet mbrapsht për të vazhduar me hetime shtesë, duke i ribërë edhe njëherë këto akte, apo veprime hetimore.

60. Zbatimi korrekt i nenit 287, si dhe vendimet e mësipërme unifikuese dhe ai i Gjykatës Kushtetuese e përcaktojnë qartësisht se cili është momenti në të cilin subjekti merr statusin e personit që i atribuohet vepra penale, shkelja e ligjit procedural penal nuk mund të shërbejë si “truk procedural” për mosllogaritjen e afateve të hetimit sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Penale. Si rrjedhojë, bazuar në parashikimet e mëposhtme të Kodit të Procedurës Penale, hetimet e Prokurorisë së Posaçme janë zhvilluar në tejkalim të afateve ligjore. Më konkretisht:

Neni 323

Afati i hetimeve paraprake

1. *Brenda përfundimit të afatit ligjor të hetimeve, prokurori vendos sipas paragrafit 6, të nenit 327, të këtij Kodi.*
2. *Afati i përfundimit të hetimeve është tre muaj nga data në të cilën emri i personit që i atribuohet vepra penale është shënuar në regjistrin e njoftimit të veprave penale, dhe gjashtë muaj për veprat penale të parashikuara nga shkronjat “a” dhe “b”, të nenit 75/a, të këtij Kodi.*

Neni 327

Veprimet e policisë gjyqësore dhe të prokurorit

1. *Pasi kryen veprimet e nevojshme hetimore, policia gjyqësore i dërgon aktet prokurorit bashkë me një relacion shpjegues për faktin dhe provat, si dhe me sugjerimet e veta për mënyrën e përfundimit të hetimeve.*
2. *Brenda afatit të parashikuar nga neni 324, i këtij Kodi, prokurori njofton mbi përfundimin e hetimeve paraprake të pandehurin, mbrojtësin e tij, si dhe viktimën ose trashëgimtarët e saj, kur identiteti dhe vendbanimi i tyre rezultojnë nga aktet e procedimit.*
3. *Njoftimi përmban përshkrimin e përmbledhur të faktit penal për të cilin procedohet, kohën dhe vendin e kryerjes, cilësimin juridik, lajmërimin për*

depozitimin e akteve në sekretari dhe të drejtën për t'u njohur me aktet dhe për të marrë kopje.

4. I pandehuri njoftohet gjithashtu, se ka të drejtë **që brenda dhjetë ditëve të paraqesë** memorie e dokumente, t'i kërkojë prokurorit kryerjen e hetimeve shtesë, të bëjë deklarime apo të kërkojë që të merret në pyetje. Kur i pandehuri kërkon të pyetet, prokurori është i detyruar të procedojë me pyetjen e tij.

5. Kur prokurori pranon kërkesën e të pandehurit për të kryer hetime shtesë, ato duhet të përfundojnë brenda tridhjetë ditëve nga paraqitja e kërkesës. Ky afat mund të zgjatet vetëm një herë dhe jo më shumë se dy muaj dhe në çdo rast pa kaluar afatin tërësor të hetimit. Kur nuk e pranon kërkesën e të pandehurit, prokurori merr vendim të arsyetuar, sipas paragrafit 2, të nenit 110, të këtij Kodi.

6. Në përfundim të hetimeve paraprake, prokurori procedon si më poshtë:

a) vendos pushimin e akuzës apo çështjes, në rastet e parashikuara nga paragrafi 1, i nenit 328, ose i kërkon gjykatës pushimin e akuzës apo çështjes, në rastet e parashikuara nga neni 329/a i Kodit;

b) i kërkon gjykatës dërgimin e çështjes në gjyq, kur nuk procedon sipas neneve 400, 406/a dhe 406/dh të këtij Kodi.

61. Si rrjedhojë, bazuar në prg. 4 të nenit 324, si dhe në paragrafin 2 të nenit 331 të Kodit të Procedurës Penale, edhe kërkesa potenciale për dërgimin e çështjes në gjyq do të ishte e pavlefshme dhe provat e mbledhura pas afatit nuk mund të përdoren:

Neni 324

4. Provat e marra pas mbarimit të afatit nuk mund të përdoren.

Neni 331

2. *Kërkesa për dërgimin e çështjes në gjyq është e pavlefshme kur nuk respektohen përcaktimet e paragrafëve 2, 3 dhe 4, të nenit 327, të këtij Kodi.*

62. Pasojë e kësaj mënyre të proceduari është që vetë kërkesa për caktimin e masës së sigurimit mbështetet mbi një akt themelor, regjistrimi i procedimit penal, i cili është i nxjerrë jashtë kriterëve ligjore, i vonuar dhe i ndërtuar si mbulesë formale për një proces që kishte filluar dhe zhvilluar në mënyrë të njëanshme. Kjo e bën tërësinë e akteve që pasojnë, përfshirë vendimet e Gjykatave, të mbështetura në themele procedurale, por edhe akte provuese të papranueshme në Kodit të Procedurës Penale, për shkak se aktet procedurale që nuk respektojnë normat thelbësore të ligjshmërisë janë të pavlefshme dhe çdo provë që buron nga akte të tilla janë të papërdorshme.
63. Neni 291 i Kodit të Procedurës Penale përcakton qartë se, nëse brenda 15 ditëve nga marrja e njoftimit për veprën penale prokurori nuk vendos “mosfillimin e procedimit penal”, ai është i detyruar të urdhërojë regjistrimin e tij. Kjo rrjedh drejtpërdrejt nga përmbajtja e paragrafit 4 të këtij neni, i cili parashikon se, në rast se prokurori ka vendosur jo në përputhje me ligjin “mosfillimin”, gjykata e detyron të regjistrojë procedimin penal. E aplikuar në rastin konkret, për sa kohë prokurori nuk ka marrë një vendim për “mosfillim” brenda afatit 15-ditor, ai kishte detyrimin ligjor që ditën e 16-të të kryente regjistrimin e procedimit penal. Çdo veprim hetimor i kryer nga organi i policisë gjyqësore para këtij regjistrimi dhe pa pasur delegim të posaçëm nga prokurori përbën veprim juridikisht *nul*.
64. Në përfundim, ajo që ndodhi nuk ishte një mangësi aksidentale apo një gabim teknik në ndjekjen e procedurës, por një zgjedhje e vetëdijshme institucionale për të shmangur kufijtë që vendos ligji, për të zhvilluar një hetim të fshehtë ndaj një individi të përzgjedhur dhe për ta vendosur më pas atë përballë një kërkesë për masë sigurimi në një pozitë pa mbrojtje, pa njohje të akteve, pa asnjë mundësi reale për të ndërhyrë në dinamikën e hetimit. Kjo qasje është në kundërshtim të hapur me parimet e të drejtës penale procedurale, me të drejtën për një mbrojtje efektive dhe me standardet e një shteti të së drejtës.
65. Duke shmangur regjistrimin e emrit të z. Erion Veliaj si person ndaj të cilit i atribuohet vepra penale në regjistrin përkatës, Prokuroria e Posaçme ka krijuar vetes një

hapësirë të paligjshme manovrimi, duke i shmangur në mënyrë të vetëdijshme kufijtë kohorë të hetimit të parashikuar nga ligji. Sipas Kodit të Procedurës Penale, afatet hetimore nuk lidhen me datën e përgjithshme të regjistrimit të procedimit penal, por fillojnë të llogariten vetëm nga momenti kur në regjistër shënohet emri i personit ndaj të cilit atribuohet vepra penale. Kjo do të thotë se, duke mos regjistruar emrin e tij për një periudhë të gjatë kohore, ndonëse hetimet faktikisht ishin përqendruar tërësisht mbi të, prokuroria ka vepruar përtej çdo afati të ligjshëm kontrolli dhe ka shmangur çdo mekanizëm procedural që detyron hetuesin të veprojë brenda një kohe të caktuar dhe të justifikojë zgjatjet apo veprimet që kryen. Kjo sjellje jo vetëm që cenon barazinë e palëve dhe të drejtën për një mbrojtje efektive, por rrënon edhe parimin e sigurisë juridike, duke krijuar një precedent ku hetimet ndaj një personi mund të zhvillohen për një kohë të pacaktuar, në mënyrë të fshehtë dhe pa asnjë mbikëqyrje gjyqësore të afateve, për sa kohë emri i tij nuk formalizohet në regjistër. Në këtë mënyrë, prokuroria ka vendosur vetë ritmin, përmasat dhe kohëzgjatjen e një hetimi personalizues, pa qenë kurrë formalisht e kufizuar nga afatet që ligji vendos për mbrojtjen e të drejtave të të hetuarit.

66. Në këtë mënyrë, prokuroria vendos të zhvillojë hetimin jashtë çdo llogaridhënie procedurale, duke uzurpuar kompetenca që ligji i ka dhënë gjykatës dhe duke eliminuar filtrin institucional të kontrollit të ligjshmërisë dhe proporcionalitetit të ndjekjes penale.
67. Kryerja e hetimeve përtej afatit hetimor nuk është një mangësi thjesht formale, por një shkelje që godet drejtpërdrejt funksionin mbrojtës të këtij afati si garanci kundër arbitraritetit dhe pasigurisë së zgjatur procedurale. Kur ky afat tejkalohet pa një vendim të vlefshëm dhe të motivuar ligjërisht, i pandehuri mbahet në mënyrë të pajustificuar për një periudhë të gjatë nën statusin e subjektit të akuzës, duke u vendosur në një gjendje pasigurie të vazhdueshme që ndikon në jetën e tij personale, profesionale dhe familjare. Në këto rrethana, procedimi humbet karakterin e tij të rregullt dhe shndërrohet në një mjet presioni të zgjatur ndaj të pandehurit, pa asnjë lidhje të domosdoshme me qëllimin hetimor.
68. Zgjatja e hetimeve përtej kufijve të përcaktuar nga ligji, pa arsye të ligjshme dhe të dokumentuara, prish ekuilibrin procedural midis palëve. Prokuroria fiton kohë shtesë

për të ndërtuar akuzën dhe për të përpunuar prova, ndërkohë që mbrojtja mbetet e kufizuar nga të njëjtat afate dhe pa mundësi reale për të kompensuar këtë disavantazh. Kjo krijon një situatë të pabarabartë dhe disproporcionale, ku e drejta e mbrojtjes dobësohet në mënyrë të dukshme dhe parimi i barazisë së armëve humbet efektin e tij praktik.

69. Tejzgjatja e hetimeve përtej afatit ligjor, sidomos kur shoqërohet me mungesë transparence për vendimin e vazhdimet, cenon gjithashtu parimin e prezumimit të pafajësisë. Një procedurë e tillë gjeneron një perceptim publik se i pandehuri ka një faj të nënkuptuar, duke i dhënë pamjen e një procesi ku akuzuesi po “mbledh” prova deri sa të arrijë rezultatin e dëshiruar. Një perceptim i tillë e zhvendos barrën e provës në mënyrë të padrejtë mbi të pandehurin, duke e detyruar atë të justifikojë pafajësinë e vet, gjë që bie ndesh me vetë themelin e procesit penal dhe rrezikon të ndikojë edhe në gjykim.
70. Në një shtet të së drejtës, ndjekja penale nuk mund të jetë një proces me dy anë, njëra formalisht e rregullt dhe tjetra fshehtas arbitrare. Përkundrazi, ligjshmëria e ndjekjes kërkon që çdo fazë e procedurës të jetë e verifikueshme, e kufizuar në kohë dhe e nënshtruar ndaj standardeve të kontrollit dhe mbrojtjes që ligji parashikon. Në këtë rast, duke mos regjistruar emrin e z. Veliaj për një kohë të gjatë, prokuroria jo vetëm ka cënuar rëndë të drejtën për mbrojtje, por ka çmontuar vetë mekanizmin e kontrollit kohor të procedimit penal, duke instaluar një trajtim të veçantë jashtë çdo garancie procedurale dhe duke prodhuar pasoja të dëmshme për vlefshmërinë e të gjithë hetimit që pason. Hetimi penal ndaj një personi duhet të zhvillohet në mënyrë transparente, në respekt të afateve të arsyeshme dhe nën mbikëqyrjen e një gjykate të paanshme. Duke vepruar jashtë këtyre kriterëve, prokuroria ka cënuar rëndë parimin e parashikueshmërisë së ndjekjes penale dhe e ka zhveshur individin nga çdo mundësi për të ndërtuar një mbrojtje reale dhe të efektshme në kohë.

5. Kryerja e akteve procedurale nga hetuesit e BKH para regjistrimit të procedimit penal nga Prokuroria

71. Sipas nenit 287 të Kodit të Procedurës Penale del qartë se BKH nuk ka pasur asnjë kompetencë të kryente akte procedurale pa njoftuar më parë Prokurorinë dhe pa u regjistruar më parë prej Prokurorisë nisja e një procedimi penal. E vetmja kompetencë e BKH në këtë fazë është marrja dijëni rreth ndodhjes së një veprë penale, duke mbledhur informacione por vetëm nga burime të hapura. Nga ana tjetër neni 30 parashikon kompetencën e kryerjes me iniciativë të veprimeve të disa akteve procedurale. Konkretisht ky nen parashikon se: *“Policia gjyqësore, edhe me iniciativën e vet, duhet të marrë dijëni për veprat penale, të pengojë ardhjen e pasojave të mëtejshme, të kërkojë autorët e tyre, të kryejë hetime dhe të grumbullojë gjithçka që i shërben zbatimit të ligjit penal”*. Por megjithatë ky parashikim nuk mund të interpretohet si e drejtë e BKH për të kryer akte procedurale të karakterit të procedimit penal pa autorizimin e Prokurorisë, por si mundësi që Kodi i Procedurës Penale i njeh Policisë Gjyqësore (përfshirë edhe BKH) të kryejë grumbullim informacioni dhe çdo verifikim tjetër me karakter policor të cilat në vetvete nuk kanë karakterin e një veprimi procedural.

72. Është e vërtetë se në raste përjashtimore KPP i njeh Policisë Gjyqësore kompetencën të kryejë veprime me karakter procedural qoftë edhe nga ato që cenojnë të drejtat e individëve (p.sh. kërkim të dhënave bankare, përgjime, sekuestime, marrje në pyetje të të dyshuarve etj). Por kjo kompetencë është parashikuar si përjashtim nga rregulli dhe vetëm për shkaqe emergjence. Nga ana tjetër aktet e kryera procedurale nga Policia Gjyqësore në kushte emergjente janë kushtëzuar me vleftësimin e tyre nga Prokuroria brenda një afati kohor tepër të ngushtë (48 orë). Në të kundërt ato konsiderohen si akte absolutisht të pavlefshëm. Ky është rasti tipik kur organi i policisë gjyqësore vepron me nismë vetjake, pa dijeninë dhe pa autorizimin e prokurorit, pasi ende nuk është individualizuar elementi i veprës penale. Ndërsa në situatën tonë kemi një kallëzim penal të depozituar dhe të bërë i njohur prokurorit, duke e vënë çështjen nën autoritetin e tij ekskluziv për të vendosur nëse do të urdhëronte “mosfillimin” apo regjistrimin e procedimit penal. Në momentin që kallëzimi është regjistruar pranë prokurorisë, çdo

veprim hetimor mund të kryhet vetëm pas regjistrimit formal të procedimit penal; çdo veprim i kryer përpara këtij momenti është i jashtëligjshëm.

73. Po kështu hetuesit e BKH kanë kryer shkelje të nenit 293 pika 1 të K.Pr.Penale. Pranimi nga Gjykata i akteve procedurale të kryera nga hetuesit e BKH para regjistrimit të procedimit penal, edhe pse të kryera në shkelje të parashikimeve ligjore të sipërpërmendura, përbën shkelje të drejtpërdrejtë të parimit të ligjshmërisë parashikuar në nenin 2 të K.Pr.Penale.
74. Në dritën e parashikimeve të nenit 287 të Kodit të Procedurës Penale, është e padiskutueshme se Byroja Kombëtare e Hetimit nuk ka asnjë kompetencë për të kryer veprime procedurale pa autorizim të Prokurorisë dhe pa ekzistuar më parë regjistrimi formal i procedimit penal nga organi i ndjekjes. Ky kufizim është vendosur qëllimisht nga ligjvënësi për të siguruar një kufi të prerë ndërmjet fazës së informacionit të përgjithshëm dhe fazës së procedimit penal të formalizuar, për të shmangur rreziqet e arbitraritetit, cenimit të të drejtave themelore dhe shmangies nga kontrolli gjyqësor.
75. Në këtë kuptim, çdo veprim i ndërmarrë nga hetuesit e BKH-së përpara se të jetë regjistruar zyrtarisht procedimi penal, përbën një devijim nga ligjshmëria dhe një cenim të kompetencës ekskluzive të Prokurorisë për të udhëhequr dhe autorizuar procedurën. Kompetenca e parashikuar në nenin 30 të K.Pr.Penale për policinë gjyqësore që të ndërmarrë veprime me iniciativë nuk duhet të interpretohet si një licencë për hetim penal “në hije”, por si një autorizim i kufizuar për të ndërmarrë verifikime me karakter informativ dhe policor, të cilat nuk mund të kenë natyrë procedurale, për sa kohë mungon një vendim i Prokurorisë për regjistrimin e çështjes dhe për të vendosur drejtimin dhe objektin e ndjekjes penale.
76. Më tej, edhe në ato raste të jashtëzakonshme ku ligji njeh mundësinë që policia gjyqësore të kryejë veprime me karakter procedural, si në rastet e emergjencës që rrezikojnë humbjen e provave apo parandalimin e pasojave të rënda, kjo kompetencë është e rreptësisht e kufizuar në kohë dhe në natyrë, dhe nuk ka asnjë vlerë ligjore nëse nuk verifikohet brenda afateve ligjore nga Prokuroria. Në rastin konkret, nuk bëhet fjalë për situatë emergjente, as për ndonjë rrezik konkret që justifikon veprime të menjëhershme të BKH-së pa ndërhyrjen e Prokurorisë. Përkundrazi, bëhet fjalë për një

hetim të përgatitur, të qëllimshëm dhe të organizuar ndaj një funksionari të lartë publik, ku hetuesit e BKH kanë ndërmarrë akte procedurale pa respektuar as rregullin e përgjithshëm, as përjashtimin që ligji parashikon. Gjykata, nëse pranon prova apo veprime të tilla, jo vetëm bie ndesh me parimin e ligjshmërisë së procedurës, por shndërrohet në një hallkë që i jep efekt juridik një procesi që ka nisur dhe është ndërtuar jashtë çdo garancie formale të ligjit.

77. Një aspekt tjetër që duhet theksuar është se përfshirja e BKH-së në veprime procedurale pa autorizimin e Prokurorisë krijon një konfuzion funksional dhe kompetencash që minon arkitekturën e ndarjes dhe hierarkisë së veprimeve procedurale në sistemin penal shqiptar. BKH është e destinuar për të mbështetur hetimin në përputhje me urdhrat dhe drejtimin e organit të ndjekjes. Kur ajo vepron jashtë këtij kuadri, pa urdhër, pa regjistrim, dhe pa kontroll, ajo e uzurpon rolin e Prokurorisë dhe e prish balancën e kompetencave që garanton ligjshmërinë e procesit penal.

78. Këto lloj shkeljesh procedurale nuk janë thjesht teknikalitete, ato përbëjnë defekte substanciale që diskreditojnë gjithë ecurinë e hetimit penal, dhe e bëjnë të pamundur përdorimin e akteve dhe provave që burojnë prej tyre. Çdo provë e mbledhur në këto kushte nuk përmbush standardin e ligjshmërisë procedurale dhe për rrjedhojë nuk mund të konsiderohet si provë e vlefshme në kuptim të K.Pr.Penale. Çdo vendim gjyqësor i ndërtuar mbi një bazë të tillë, përbën në thelb, cënim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor.

79. Lejimi nga Gjykata i përdorimit të akteve procedurale të papërdorshme, siç janë ato të kryera nga hetuesit e BKH shkakton shkelje të rënda procedurale, dhe për këtë arsye duhet zbatuar doktrina e “frutit të pemës së helmuar” sipas praktikës së GJEDNJ. Ky qëndrim i mbrojtjes mbi karakterin e rëndë të shkeljeve që kanë pasuar nga lejimi i përdorimit të këtyre akteve të kryera nga BKH:

80. I ka dhënë në mënyrë të paligjshme legjitimitet ekzistencës së vetë procedimit penal; neni 287.1 K.Pr.P. është dispozitë kyçe që përcakton kushtet për nisjen e procedimit penal. Kjo do të thotë nëse regjistrimi i procedimit penal bëhet mbi baza të paligjshme, kjo cenon legjitimitimin e Prokurorisë për të ushtruar ndjekjen penale. Regjistrimi i procedimit penal mbi baza të paligjshme nuk është thjesht një gabim procedural pa

pasoja konkrete, pasi ky regjistrim është bërë për vepra penale të rënda, i cili më pas ka çuar në marrjen e masës ekstreme të sigurimit, atë të “arrestit në burg” ndaj personit nën hetim Erion Veliaj.

81. Ka cënuar të drejtat themelore kushtetuese të personit nën hetim; regjistrimi i procedimit penal mbi baza të paligjshme përbën shkelje të rëndë pasi në rastin e personit nën hetim Erion Veliaj janë shkelur rëndë standartet kushtetuese të një procesi të rregullt ligjor (neni 42 i Kushtetutës). Konkretisht kjo situatë ka bërë që për një periudhë prej jo më pak se 7 muaj, ndaj personit nën hetim janë kryer akte procedurale pa e vënë në dijeni në kohën e duhur dhe për pasojë duke i privuar atij çdo mundësi mbrojtjeje dhe pa patur asnjë garanci procedurale.

6. Përdorimi i deklarimeve me vetë përgjegjësi

82. Lidhur me lejin nga Gjykata të përdorimit të provave të papërdorshme për të vërtetuar motivet e udhëtimit në Rotterdam të personit nën hetim Erion Veliaj. Prokuroria ka mbështetur dyshimin mbi motivet e udhëtimit të datës 03.12.2016 në Rotterdam, Hollandë nga ana e personit nën hetim Erion Veliaj mbi deklaratimet e personit nën hetim Fatmir Bektashi të dhëna me cilësinë e personit që ka dijeni për rrethanat e hetimit. Në ato deklaratime deklaruesi Fatmir Bektashi ka pohuar se udhëtimi në Rotterdam nga personi nën hetim Erion Veliaj është kryer me qëllim verifikimin e seriozitetit të projektit të ndërtimit të kompanisë së tij “Kontakt” shpk. në funksion të sigurimit të miratimit të lejes së ndërtimit për këtë projekt.
83. Në zbatim të gabuar të ligjit Gjykata ka pranuar këto deklaratime me cilësinë e provave, edhe pse ato janë të papërdorshme pasi vjen ndesh me parashikimet e nenit 37 të K.Pr.Penale. Konkretisht, nga përmbajtja e tyre këto deklaratime janë vetëinkriminuese përsa kohë përdoren nga Prokuroria për të vërtetuar motivet e udhëtimit të personit nën hetim Erion Veliaj, në mbështetje të dyshimit të arsyeshëm për kryerjen e veprës penale “korrupsion aktiv” parashikuar nga neni 245 i Kodit Penal në ngarkim të personit nën hetim Fatmir Bektashi. Sipas nenit 37 të K.Pr.Penale deklaratimet me vetpërgjegjësi janë të papërdorshme ndaj personit nën hetim Fatmir Bektashi. Duke qenë se neni 37 i K.Pr.Penale parashikon ndalimin e shfrytëzimit të këtyre deklaratimeve ndaj personit që i

ka dhënë ato, pra ndaj personit nën hetim Fatmir Bektashi, nuk mund të arsyetohet *a contrario* se ato lejohet të përdoren kundër personave të tretë, në këtë rast ndaj personit nën hetim Erion Veliaj.

84. Në fakt ky do të ishte një interpretim i gabuar i ligjit, pasi në të drejtën procedurale penale, doktrina ka zhvilluar parimin e “frutit të pemës së helmuar” sipas të cilit një provë që është e pavlefshme ndaj një prej personave nën hetim nuk mund të përdoret kundër një personi tjetër në të njëjtin procedim penal. Edhe neni 37 i K.Pr.Penale nuk bën dallim mes përdorimit të deklaratës kundër personit që e ka dhënë dhe përdorimit të saj për të provuar fakte kundër të tretëve. Shprehja e përdorur në këtë ne “deklarimet e mëparshme nuk mund të shfrytëzohen kundër personit që i ka bërë” vendos theksin në kufizimin e përdorimit kundër deklaruesit, por nuk thotë asgjë të shprehur nëse mund këto deklarime të lejueshme të përdoren kundër të tjerëve.
85. Nëse do të lejohej përdorimi i këtyre deklarimeve ndaj personit nën hetim Erion Veliaj kjo do të ishte një mënyrë e tërthortë për të inkriminuar indirekt vetë deklaruesin pasi në këtë procedim penal personi nën hetim Fatmir Bektashi do të duhej të konfirmonte deklarimet e tij të dhëna me cilësinë e dëshmitarit në funksion të vërtetimit të akuzës në ngarkim të personit nën hetim Erion Veliaj, gjë që në thelb do të minonte mbrojtjen që synon t’i japë atij ligjvënësi me anë të parashikimit në nenin 37 të pamundësisë në çdo formë të shfrytëzimit të deklarimeve vetinkriminuese.
86. Ky veprim vjen ndesh me parashikimet e nenit 156.1 shkronja “b” të K.Pr.Penale: *“Nuk mund të pyeten si dëshmitarë të pandehurit në një vepër penale të përbashkët ose në një procedim të lidhur, kur ndaj tyre është dhënë vendimi i mosfillimit të procedimit, i pushimit të akuzës ose çështjes, ose i dënimit, duke përfshirë edhe rastet e gjyqimit me marrëveshje dhe të urdhrin penal të dënimit, me përjashtim të rasteve kur vendimi i pafajësisë ka marrë formë të prerë”*. Edhe pse në vendimin për dhënien e masës së sigurisë (prg.153.5.4.3), GJKKO e cilëson të parashkruar këtë episod të veprës penale të “korrupsionit aktiv”, megjithatë deklaruesi Fatmir Bektashi vazhdon të jetë nën hetim në kuadër të këtij procedimi penal për të cilin ndaj tij nuk është dhënë ende ndonjë vendim pafajësie deri aktualisht.

87. Në këtë kuptim çdo deklaram i dhënë prej tij në cilësinë e dëshmitarit në të njëjtin proces penal bien ndesh me këtë ndalim të shprehur të nenit 135 të K.Pr.Penale. Ky veprim përbën shkelje të së drejtës për një gjykim të drejtë sipas të cilit çdo person ka të drejtë që çështja e tij të shqyrtohet në mënyrë të drejtë. Në fakt lejimi i përdorimit të deklarimeve me vetpërgjegjësi bie ndesh me këtë parim pasi lejon përdorimin e provave të cilat ligji shprehimisht i ndalon (neni 37 K.Pr.Penale). Ky veprim përbën gjithashtu shkelje të së parimit të prezumimit të pafajësisë sipas të cilit çdo person i akuzuar për një vepër penale duhet të prezumohet i pafajshëm deri sa të provohet fajësia e tij. Në fakt përdorimi i deklarimeve të tilla nga Prokuroria bie ndesh me këtë parim pasi Prokuroria ka përdorur statusin e personit “dëshmitar” për ta detyruar personin nën hetim të bëjë deklaram qoftë edhe vetinkriminuese, dhe më pas i ka përdorur ato deklaram vetinkriminuese si provë për të mbështetur akuzën ndaj personit nën hetim Erion Veliaj.
88. E njëjta shkelje vërehet edhe lidhur me deklaramet e shtetases Abigail Voshtina, e cila ka bërë deklaram që e vetëngarkojnë me përgjegjësi penale. Lejimi i përdorimit të deklarameve me vetëpërgjegjësi, për të mbështetur indicien penale ndaj një personi tjetër, në të njëjtin procedim penal, përbën një shkelje substanciale të sistemit të ndalimeve probatore. Në thelb, kjo përbën një anashkalim të ndalimit të shprehur për shfrytëzimin e deklarameve vetëinkriminuese, i cili nuk është vendosur vetëm për të mbrojtur individin që i ka dhënë ato, por për të garantuar që një provë e kontaminuar në burim nuk mund të riciklohet në mënyrë të tërthortë në dëm të një bashkëhetuari. Vetë mënyra se si prokuroria i ka përdorur deklaramet e Fatmir Bektashit për të ndërtuar qëllimin e udhëtimit të Erion Veliajt në Rotterdam është në thelb një instrumentalizim i një prove të papërdorshme, që e rihyn në sistem nga një derë anësore për të prodhuar efekt ndaj një subjekti tjetër.
89. Ky veprim deformon qëllimin e nenit 37 të Kodit të Procedurës Penale, i cili nuk bën dallim dhe nuk lejon përdorim selektiv të deklarameve vetëinkriminuese. Lejimi i përdorimit të tyre kundër një të hetuari tjetër, kur deklaruesi është ende subjekt i të njëjtit procedim penal, nënkupton që ky i fundit vendoset në një pozitë të dyfishtë juridike: formalisht si dëshmitar, por në substancë si i bashkëpandehur që kontribuon në ndërtimin e akuzës. Kjo sjell një përmbysje të skemës tradicionale të mbrojtjes

procedurale: deklarata e personit përdoret si mjet akuzues, pa i dhënë këtij personi ndonjë nga garancitë që ligji procedural parashikon për marrjen e kësaj prove. Ky është rast i pastër i një shkeljeje funksionale të ndalimit për vetëinkriminim, i maskuar si “përdorim kundër një tjetri”.

90. Në këto kushte, çdo provë e ndërtuar mbi këtë bazë është jo vetëm e papërdorshme, por e ndaluar. Pranimi i saj nga Gjykata jo vetëm që legjitimon një mekanizëm të ndaluar, por minon parimin e ndershmërisë së procedurës dhe e bën të pavlefshëm çdo akt që mbështetet mbi të, sipas të njëjtës logjike si ajo e "frutit të pemës së ndaluar". Kjo cenon barazinë e palëve dhe krijon një precedent të rrezikshëm për vetë funksionin garantues të së drejtës procedurale penale.

7. Sekuestrimi i të dhënave kompjuterike pa vendim gjykate

91. Të dhënat kompjuterike nga celularët dhe sistemet e tjera kompjuterike të sekuestruara në kuadër të procedimit nr. 27, të vitit 2024 janë këqyrur dhe sekuestruar në kundërshtim me parashikimet ligjore. Për të sekuestruar të dhënat kompjuterike apo më tej akoma komunikime private, që ndodheshin brenda në celular, Prokurorët e çështjes duhet të kishin zbatuar paraprakisht përcaktimet e bëra në nenin 208/a të Kodit të Procedurës Penale. Referuar këtij neni Prokurori nuk ka asnjë të drejtë/kompetencë ligjore që të caktojë një ekspert për nxjerrjen dhe marrjen e të dhënave kompjuterike, pa siguruar paraprakisht përmes një kërkesë të tij, një vendim gjykate që urdhëron sekuestrimin e të dhënave kompjuterike, përcakton të drejtën për të hyrë, kërkuar dhe marrë të dhënat kompjuterike, si dhe që ndalon kryerjen e veprimeve të mëtejshme me këto të dhëna.
92. Theksojmë që sistemi i operimit/procesimit të të dhënave në një celular smartphone konsiderohet një sistem kompjuterik², ndërsa të dhënat që procesohen/ruhen nga këto sisteme konsiderohen të dhëna kompjuterike. Sipas përkufizimit në Konventën e Budapestit për Krimin Kibernetik, "të dhënat kompjuterike" përfshijnë çdo përfaqësim të fakteve, informacionit ose koncepteve në një formë të përshtatshme për përpunim në

² Shiko seksionin 2.2 “mobile devices” të Udhëzimit të Këshillit të Evropës dhe Bashkimit Evropian mbi “provat elektronike”. <https://rm.coe.int/0900001680acb9a0>

një sistem kompjuterik, përfshirë programet që bëjnë një sistem kompjuterik të kryejë funksione.

93. Një telefon smart është një sistem kompjuterik sepse ka një procesor, memorje, sisteme operimi dhe është në gjendje të përpunojë të dhëna, duke përfshirë:

- **Të dhëna për komunikime** (mesazhe, thirrje, email-e)
- **Fotografi dhe video**
- **Aplikacione dhe të dhënat e tyre të ruajtura**
- **Gjeolokacionet** (të dhënat nga GPS)
- **Shënime dhe kalendarë**
- **Logjet e aktivitetit dhe të dhënat e tjera të përdoruesit**

94. Në këtë kuptim është e domosdoshme marrja e një vendimi gjykate para se të aksesohet ky sistem dhe të sekuestrohen të dhënat e tij kompjuterike. Nëse Prokurorët e çështjes do të kishin zbatuar përcaktimet e bëra në nenin 208/a të Kodit të Procedurës Penale duke i paraqitur një kërkesë Gjykatës për sekuestrimin e këtyre të dhënave kompjuterike, jo vetëm që kërkesa do të duhej të ishte e motivuar dhe e kufizuar brenda objektit dhe qëllimit të procedimit penal nr. 27, të vitit 2024, por njëkohësisht edhe gjykata do të duhej të tregonte kujdes në miratimin e kësaj kërkesë duke e limituar atë vetëm në sekuestrimin e të dhënave që lidhen me nevojat dhe objektin e hetimit.

95. Referuar përcaktimit të bërë në nenin 208 të Kodit të Procedurës Penale, sekuestrimi i një sendi (në rastin konkret një celulari/laptopi) mund të bëhet si me vendim Gjykate ashtu dhe me vendim të Prokurorit, por referuar përcaktimeve të bëra në nenin 208/a të Kodit të Procedurës Penale, sekuestrimi i të dhënave kompjuterike që ndodhen brenda këtij sendi (celulari) mund të bëhen nga Prokurori, oficeri i policisë gjyqësore apo eksperti vetëm në zbatim të një vendimi gjykate. Ky preokupim i ligjvënësit konsiderohet i arsyeshëm për faktin se të dhënat kompjuterike, objekt i sekuestros, ndryshe nga të dhënat e përfuara nëpërmjet vendosjes së sekuestros mbi sendet e tjera, për shkak të natyrës së tyre të veçantë, është më e vështirë të individualizohet, si dhe, duke qenë se si rregull “depozitohen” në sisteme kompjuterike, në të cilat “parkohen” edhe të dhëna të tjera që mund të mos kenë lidhje me vërtetimin e faktit penal, ekziston

rreziku i ekspozimit të të dhënave të tjera, (që nuk kanë lidhje me faktin penal për të cilin hetohet) marrja e të cilave mund të cenojë liri dhe të drejta të rëndësishme të qytetarëve, të cilat gëzojnë mbrojtje kushtetuese dhe konventore, si liria dhe fshehtësia e korrespondencës ose e çdo mjeti tjetër të komunikimit, nëpërmjet nenit 36 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare, nenit 8 të KEDNJ, apo lirinë e shprehjes, neni 22 i Kushtetutës, të drejtën e informimit, neni 23 i Kushtetutës, të mbrojtura gjithashtu dhe nga neni 10 i KEDNJ. Sikundër parashikohet në nenin 17 të Kushtetutës kufizime të të drejtave dhe lirive kushtetuese mund të vendosen vetëm me ligj, për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë. Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në KEDNJ.³

96. Për krahasim, vërtet gjykata mund të marrë vendim për sekuestrimin e një apartamenti, por për kontrollin e tij dhe gjetjen dhe marrjen e provave gjatë këtij kontrolli duhet një vendim tjetër gjykate që në çdo rast nuk ka se si të parashikojë në mënyrë të përgjithshme marrjen e çdo gjëje që gjendet brenda në shtëpi, por marrjen ngushtësisht të vetëm atyre provave që lidhen me çështjen. Në rastin konkret, Prokurorët e çështjes, duke shmangur kufizimet që normalisht sjell një vendim gjykate, kanë marrë vetë vendimin dhe kanë urdhëruar ekspertët për të marrë apriori pa kurrfarë kufizimi çdo të dhënë kompjuterike që gjendej në celularët dhe laptopët e sekuestruar. Për sa më sipër, vendimi i Prokurorëve për caktimin e ekspertëve dhe kryerjen e ekspertimeve teknike telefonike të celularëve dhe pajisjeve të tjera kompjuterike, janë vendime të paligjshme, të marra në shkelje dhe në shmangienë të nenit 208/a të Kodit të Procedurës Penale dhe për rrjedhojë të paligjshme konsiderohen edhe aktet e ekspertimit, të ekspertëve që zbatuan këto vendime të Prokurorëve si dhe të paligjshëm konsiderohen edhe procesverbalët e këqyrjes së të dhënave kompjuterike.

97. Njëkohësisht, jo e çdo e dhënë kompjuterike mund të cenojë të drejta dhe liri themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut. Në rastin konkret, ekstraktimi i komunikimeve

³ Vendimi nr. 00-2021-1135 i Vendimit (147), datë 23.12.2021 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë

private, siç janë komunikimet me platformën Whatsup, gëzojnë mbrojtje të posaçme nga neni 36 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 8 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Hapja e korrespondencës dhe komunikimeve, pra kufizimi i një të drejte kushtetuese, mund të realizohen “*vetëm me ligj, për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë.*”, shprehet neni 17 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

98. Ndërsa neni 8 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut parashikon se: “1. Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës së tij. 2. Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut në çështjet **Trabajo Rueda v. Spain (32600/12)** dhe **Benedik v. Slovenia (62357/14)**, ka trajtuar qartësisht faktin se ndërhyrjet në komunikimet private apo leximi i tyre, pa një mbikëqyrje adekuate pra një vendim të qartë gjykate, pa procedura specifike ligjore, pa gjurmë të qarta auditimi për verifikimin e integritetit të ndërhyrjes dhe pa respektuar proporcionalitetin, konsiderohen si cënim i rëndë i nenit 8 të Konventës Evropiane të Drejtave të Njeriut.
99. Udhëzimi i Këshillit të Evropës dhe Bashkimit Evropian mbi “provat elektronike”, i datës 04.04.2022, drejtuar oficerëve të policisë, prokurorëve dhe gjyqtarëve të vendeve anëtare dhe hartuar si projekt rithekson qartësisht parimet mbi të cilat administrohen dhe përdoren provat elektronike dhe ato janë:
1. **Ligjshmëria dhe autorizimi për hyrje në të dhëna** - Kapitulli 1.7.5 (Parimi 5 - Ligjshmëria) thekson se: “*Personi dhe agjencia përgjegjëse për çështjen janë përgjegjës për të siguruar që veprimet e ndërmarra mbi të dhënat e sekuestruara të jenë në përputhje të plotë me ligjin dhe rregullat procedurale përkatëse.*” Qasja në të dhënat e ruajtura, përfshirë komunikimet private si ato në WhatsApp, duhet të mbështetet në një vendim gjyqësor të qartë që autorizon një veprim të tillë. Pëlqimi

për dorëzimin e telefonit nuk përbën automatikisht autorizim për të inspektuar përmbajtjen e tij.

2. **Parimi i proporcionalitetit dhe mbrojtja e privatësisë** - Kapitulli 7.3.5 (Parimi i proporcionalitetit) përqendrohet te nevoja për të balancuar të drejtën për privatësi me interesin e përgjithshëm. Qasja në komunikimet private pa një vendim gjyqësor konsiderohet: *“Shkelje e parimit të proporcionalitetit, pasi ndërhyrja duhet të jetë e kufizuar vetëm në atë që është e domosdoshme për qëllimin e hetimit.”*.
3. **Parimi i integritetit të të dhënave** - Kapitulli 1.7.1 (Parimi 1 - Integriteti i të Dhënave) thekson: *“Asnjë veprim nuk duhet të ndryshojë në mënyrë materiale të dhënat ose pajisjen elektronike që mund të përdoren si prova në gjykatë.”* Qasja në WhatsApp dhe ndryshimet e mundshme në të dhënat e ruajtura (p.sh., duke shkelur enkriptimin ose modifikuar të dhënat) mund të dëmtojnë integritetin e provave. Çdo hyrje duhet të dokumentohet plotësisht dhe të ndjekë një ***audit trail*** të qartë.
4. **Nevoja për autorizim të veçantë për qasje në aplikacione** - Kapitulli 3.5.3 (Hyrja në të dhëna të ruajtura dhe të gjalla) thekson se qasja në të dhëna të ruajtura në aplikacione ose cloud, përfshirë WhatsApp, duhet të autorizohet veçmas nga një autoritet gjyqësor. Në mënyrë specifike, theksohet: *“Qasja në të dhëna përmes ndërhyrjeve në pajisje ose përmes shërbimeve të palëve të treta kërkon autorizim të qartë gjyqësor dhe dokumentim të plotë.”*.
5. **Shkelje të mundshme në procedure** - Në Kapitullin 10.2, trajtohet çështja e kontrollit dhe sekuestrimit disproporcional pa autorizim gjyqësor. Ky kapitull thekson se veprime të tilla konsiderohen: Shkelje e standardeve të mbledhjes së provave, dhe çon në pavlefshmëri të provave në gjykatë. Gjithashtu, Kapitulli 10.5 përmend se qasja e paautorizuar në komunikime private shihet si shkelje e të drejtave themelore të individit.
6. **Pranueshmëria e provave në gjykatë** - Kapitulli 7.3.1 (Parimet për pranueshmërinë e provave) nënvizon se provat duhet të jenë: Autentike (të mos jenë manipuluar gjatë mbledhjes), të pranueshme (të mbledhura në përputhje me ligjin), kredibile dhe të besueshme (të kenë ndjekur procedura të qarta dhe të dokumentuara). Ekspertiza ka hyrë në WhatsApp pa një vendim gjyqësor dhe pa një

audit trail të dokumentuar, duhet të hidhen poshtë si të papranueshme dhe të paligjshme.

100. Neni 32 i Kushtetutës ndalon prokurorinë që të ndërtojë çështje penale mbi bazën e të dhënave të marra në mënyrë të paligjshme. Ky është një delegitimim i së drejtës së prokurorisë në ngritjen e një akuze dhe një pavlefshmëri absolute e aktit procedural të ndërmarrë nga prokurori. Sa më sipër arrihet në konkluzionin që aktet procedurale procesverbalëve për këqyrjen dhe analizimin e të dhënave të celularë/pajisje të tjera kompjuterike të përfutuara nga akt ekspertimet tekniko - kompjuterike, janë akte procedurale të nxjerra dhe përdorura në mungesë dhe keqzbatim të kuadrit përkatës ligjor që normon të drejtat dhe kompetencat e Prokurorisë dhe OPGJ dhe për rrjedhojë procesverbalët dhe akt ekspertimet tekniko- kompjuterike duhet të cilësohen si akte të papërdorshme pasi janë marrë dhe përdorur: (1) në mungesë të një vendimi gjyqësor në zbatim të përcaktimit të bërë në nenin 208/a të Kodit të Procedurës Penale, (2) në tejkalim të kompetencave që Prokuroria ka sipas nenit 208/a të K.Pr.P. (3) në shkelje të parimit të proporcionalitetit dhe nevojshmërisë, pasi ekstraktimi i të gjitha të dhënave, pa kufizim në objektin e hetimit, shkel parimin e proporcionalitetit, dhe (4) në mungesë të garancive procedurale, pasi pa një vendim gjykate, mungojnë garancitë e nevojshme për mbrojtjen e të drejtave themelore të individit, siç është e drejta për privatësi, si të personit mbajtës të celularit ku ndodhen këto të dhëna ashtu dhe të personave të tjerë që shfaqen duke komunikuar në këto të dhëna.

8. Leximi dhe përdorimi si provë i korrespondencës në mungesë të bazës ligjore që e lejon këtë

101. Leximi dhe përdorimi si provë i korrespondencës, të bërë përmes aplikacioneve të ndryshme në telefonat e personave të marrë të pandehur, si dhe përmes e-maile-ve të zyrës ligjore, të gjendura në telefona celularë dhe pajisje elektronike të sekuestruar, të përdorura si provë ndaj z. Veliaj është bërë në mungesë të një baze ligjore e cila e lejon këtë, duke mos pasur si rrjedhojë edhe garancitë efektive kundër abuzimit dhe mbikëqyrjes së pavarur. Kjo përbën një ndërhyrje të drejtpërdrejtë dhe të thellë në të drejtën për korrespondencë të garantuar nga e drejta kushtetuese dhe nga Konventa

Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Siç do të pasqyrojmë në vijim, jurisprudenca e GJEDNJ përfshin brenda nenit 8 të KEDNJ, duke i njohur mbrojtje konventore edhe leximit të tabulateve telefonike dhe verifikimit të vendndodhjes së personit përmes gjurmimit të antenave telefonike. Z. Veliaj (sado absurde të jetë si provë), akuzohet se është pronar i shtëpisë së nënës së bashkëshortes së tij, bazuar në verifikimet e kryera nga prokuroria përmes së cilave ky organ pretendon se bazuar në logimet në antenat e zonës së Qerretit, ka qenë disa herë në atë zonë. Jo vetëm përmbajtja, por edhe informacioni rreth komunikimeve, si datat, numrat e thirrjeve apo kohëzgjatja e thirrjeve, vendndodhja e logimeve të telefonit, mbrohen nga neni 8 i Konventës.

102. Ndërhyrjet e mësipërme janë bërë në mungesë të një baze ligjore të qartë, specifike dhe të aplikueshme, duke mos aktivizuar asnjë prej garancive mbrojtëse që duhen respektuar në raste të tilla. Në veçanti, nuk rezulton të jetë parashikuar qartësisht asnjë procedurë e miratuar për autorizimin paraprak gjyqësor, as ndonjë formë tjetër e kontrollit të pavarur që do të garantonte proporcionalitetin dhe nevojshmërinë e ndërhyrjes, duke shmangur arbitraritetin.
103. Përdorimi i këtyre korrespondencave si prova në hetim/gjykim, pa një bazë të qartë ligjore që e lejon këtë dhe pa respektimin e garancive thelbësore procedurale, përbën një shkelje të rëndë të parimit të ligjshmërisë dhe sigurisë juridike. E drejta për respektimin e jetës private dhe të korrespondencës është një ndër të drejtat themelore të njeriut, e mbrojtur si në planin ndërkombëtar, ashtu edhe në legjislacionin kushtetues të shteteve demokratike. Historikisht, kjo e drejtë është zhvilluar si një mbrojtje kundër ndërhyrjeve arbitrare të autoriteteve shtetërore në jetën private të individit, duke u njohur si një element themelor i sundimit të ligjit dhe funksionimit të demokracisë⁴. Në kontekstin e zhvillimeve të vrullshme teknologjike dhe digjitalizimit të komunikimit, koncepti i privatësisë ka njohur një zgjerim të dukshëm. Sot, ai përfshin gjithashtu mbrojtjen e të dhënave personale dhe të komunikimeve elektronike. Në epokën digjitale, organizatat ndërkombëtare kanë theksuar nevojën që koncepti i privatësisë të

⁴ Council of Europe (2025) Guide on Article 8 of the European Convention on Human Rights: Right to respect for private and family life, home and correspondence. https://ks.echr.coe.int/documents/d/echr-ks/guide_art_8_eng

përfshijë gjithashtu mbrojtjen e të dhënave dhe komunikimeve elektronike, për shkak të përhapjes masive të teknologjisë së informacionit⁵

104. Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*në vijim: KEDNJ*) garanton se “*çdo person ka të drejtë për respektimin e jetës së tij private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës*”.⁶ Po ashtu edhe Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara ka miratuar Rezolutën “*E drejta për privatësi në epokën digjitale*” në vitin 2020 e cila thekson rëndësinë e privatësisë edhe për komunikimet elektronike, duke deklaruar se “*të njëjtat të drejta që njerëzit gëzojnë jashtë internetit duhet të mbrohen edhe online*” dhe duke ftuar shtetet të “*respektojnë dhe mbrojnë të drejtën për privatësi, përfshirë në kontekstin e komunikimeve digjitale*”.⁷ Ndërkohë që sipas Direktivës së Parlamentit Evropian dhe Këshillit 2018/1972, e njohur si Kodi Evropian i Komunikimeve Elektronike, *komunikimi elektronik* përfshin çdo transmetim të dhënash, përfshirë zërin, imazhet dhe informacion tjetër në formë elektromagnetike, duke përfshirë shërbimet e postës elektronike dhe mesazhet e aplikacioneve të ndryshme.⁸

105. Në këtë drejtim, edhe Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka theksuar se çdo ndërhyrje në të drejtën për respektimin e korrespondencës private, përfshirë komunikimet elektronike, duhet të jetë e parashikuar me ligj, të ndjekë një qëllim legjitim dhe të jetë e nevojshme në një shoqëri demokratike. Gjithashtu, duhet të sigurohen garanci efektive, duke përfshirë kontrollin gjyqësor dhe mekanizmat për parandalimin e abuzimeve, në përputhje me kërkesat e nenit 8 paragrafi 2 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.⁹ E drejta për korrespondencë sipas nenit 8 të Konventës nuk është e kufizuar vetëm në letrat postare apo thirrjet telefonike, por

⁵ United Nations Human Rights Council (2014) The Right to Privacy in the Digital Age, A/HRC/27/37. <https://digitallibrary.un.org/record/777869?v=pdf>

⁶ Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut. https://www.echr.coe.int/documents/d/echr/convention_sqi

⁷ United Nations General Assembly (2020), The right to privacy in the digital age, Resolution A/RES/75/176. <https://digitallibrary.un.org/record/3896430?v=pdf>

⁸ Directive (EU) 2018/1972 of the European Parliament and of the Council of 11 December 2018 establishing the European Electronic Communications Code. Neni 2. <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A32018L1972>

⁹ European Court of Human Rights. Guide on Article 8 of the European Convention on Human Rights – Right to respect for private and family life, home and correspondence. Updated July 2025. Strasbourg: Council of Europe. https://ks.echr.coe.int/documents/d/echr-ks/guide_art_8_eng

përfshin një spektër të gjerë mjetesh komunikimi, përfshirë ato elektronike dhe të lidhura me internetin.

106. Në Udhëzuesin e vitit 2025, Gjykata thekson qartësisht në paragrafët 552–554 se komunikimet përmes email-eve, mesazheve online, të dhënave të ruajtura në serverë dhe pajisjeve digjitale si laptopë dhe telefona inteligjentë janë të gjitha brenda fushës së mbrojtjes që ofron neni 8 i Konventës.¹⁰ Gjykata ka vendosur një praktikë të qëndrueshme për të mbrojtur jo vetëm përmbajtjen e komunikimeve, por edhe informacionin përkatës si metadata, kontaktet, datat dhe vendndodhjet. Rrjedhimisht, ndërhyrja në këto forma të reja komunikimi kërkon jo vetëm një bazë ligjore dhe qëllim legjitim, por edhe garanci efektive kundër abuzimit dhe mbikëqyrje të pavarur.¹¹

107. Në këtë kuadër, edhe Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë njeh mbrojtjen e korrespondencës dhe komunikimeve private si një e drejtë themelore. Ajo parashikon mbrojtjen e korrespondencës dhe formave të tjera të komunikimit privat.¹² Përveç mbrojtjes kushtetuese, vendi ynë ka edhe një kuadër të veçantë ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale dhe komunikimeve elektronike të cilat parashikojnë standarde të mbrojtjes së privatësisë në përputhje me zhvillimet ndërkombëtare dhe legjislacionin e BE-së. Specifikisht, ligji nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, garanton se përpunimi i të dhënave dhe ndërhyrjet në komunikimet personale duhet të jenë të ligjshme, të drejta dhe proporcionale.¹³ Po ashtu, ligji nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar parashikon se operatorët e komunikimeve duhet të ruajnë konfidencialitetin e të dhënave dhe të marrin masa për mbrojtjen e tyre nga qasja e paautorizuar.¹⁴

¹⁰ European Court of Human Rights. *Guide on Article 8 of the European Convention on Human Rights – Right to respect for private and family life, home and correspondence*. Strasbourg: Council of Europe. §§ 552–554. https://ks.echr.coe.int/documents/d/echr-ks/guide_art_8_eng

¹¹ Po aty.

¹² Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 36. <https://www.qbz.gov.al/preview/635d44bd-96ee-4bc5-8d93-d928cf6f2abd>

¹³ Ligji nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar. <https://www.qbz.gov.al/eli/ligj/2008/03/10/9887/41ed4e3c-3dde-4028-9755-11887c48b7f6;q=9887>

¹⁴ Ligji nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar. <https://www.qbz.gov.al/eli/ligj/2008/05/19/9918/3218ea61-0ba9-46f7-bda1-4e8a2aee5f23;q=9918>

108. Në këtë kontekst, jurisprudenca e GJEDNJ-së është e qartë dhe konsistente: çdo kufizim i të drejtës për korrespondencë, qoftë edhe për qëllime hetimore, duhet të mbështetet mbi një parashikim ligjor të formuluar qartë, të aksesueshëm për individin dhe të parashikueshëm në zbatimin e tij. Duke interpretuar Konventën në mënyrë dinamike, GJEDNJ ka vendosur një test, i cili përdoret për të vlerësuar legjitimitetin e çdo kufizimi në këtë fushë. Ajo ka theksuar nevojën që çdo ndërhyrje në lirinë e korrespondencës të jetë e rregulluar në mënyrë të qartë nga ligji, të ndjekë një qëllim të ligjshëm dhe të jetë e nevojshme në një shoqëri demokratike.

109. *Së pari*, çdo kufizim në të drejtën e korrespondencës duhet të jetë “në përputhje me ligjin”. Ky nuk është një standard formal që kërkon thjesht ekzistencën e një dispozite ligjore, por një kriter material që e lidh legjitimitetin me cilësinë e ligjit. Ligji në fjalë duhet të jetë: i qartë dhe i aksesueshëm, që qytetarët ta kuptojnë dhe kenë mundësi ta konsultojnë; i parashikueshëm, pra duhet të jetë e mundur për një individ të arsyeshëm të parashikojë në çfarë rrethanash dhe nga kush mund të ketë ndërhyrje në të drejtën e tij për korrespondencë. Në disa nga vendimet më të rëndësishme të saj, GJEDNJ ka theksuar se ligji që lejon kufizimin e të drejtës së korrespondencës duhet të jetë i qartë, i aksesueshëm dhe i parashikueshëm.¹⁵

110. Ky parim është sanksionuar në vendimin klasik të saj në çështjen **Sunday Times kundër Mbretërisë së Bashkuar**.¹⁶ Në këtë çështje, e cila nuk lidhet drejtpërdrejt me korrespondencën, por vendosi standarde të rëndësishme për interpretimin e termit “në përputhje me ligjin”, Gjykata u mor me një ndalim të botimit të një artikulli nga gazeta *Sunday Times* mbi një çështje gjyqësore në zhvillim. Qeveria britanike pretendonte se botimi do të ndikonte në procesin gjyqësor dhe justifikoi ndalimin mbi bazën e “autoritetit të gjykatës”. Gjykata vendosi se ndërhyrja ishte në kundërshtim me Konventën, pasi ligji mbi “autoritetin e gjykatës” nuk ishte i mjaftueshëm i parashikueshëm dhe i qartë për qytetarët. Ky vendim vendosi një parim themelor: që një ligj që lejon kufizimin e të drejtave themelore duhet të jetë i aksesueshëm, i qartë dhe të ofrojë mbrojtje kundër ndërhyrjes arbitrare të autoriteteve.

¹⁵ European Court of Human Rights, *Sunday Times v. United Kingdom*, no. 6538/74, Judgment of 26 April 1979

¹⁶ European Court of Human Rights, *Sunday Times v. United Kingdom*, no. 6538/74, Judgment of 26 April 1979. <https://hudoc.echr.coe.int/eng#%7B%22itemid%22:%5B%22001-57584%22%5D%7D>

111. Në çështjen **Malone kundër Mbretërisë së Bashkuar**, në të cilën Malone, një qytetar britanik i dyshuar për vepra penale, pretendoi se ishte përgjuar në mënyrë të fshehtë nga autoritetet britanike, pa një bazë ligjore të saktë dhe pa mbikëqyrje gjyqësore. Ai nuk kishte mënyrë të dinte nëse dhe si po përgjohej, pasi ligji nuk përcaktonte as rrethanat, as autoritetin përgjegjës, as kohëzgjatjen ose mundësinë për t'u ankuar. Gjykata e gjeti Mbretërinë e Bashkuar në shkelje të Nenit 8 të Konventës. Ajo theksoi se për të qenë “në përputhje me ligjin”, një ndërhyrje duhet të bazohet në një ligj të formuluar me saktësi të mjaftueshme që qytetarët të mund të parashikojnë kur autoritetet mund të ndërhyjnë në të drejtat e tyre. Ligji në atë kohë ishte tepër i paqartë dhe nuk siguronte mbrojtje kundër abuzimeve.¹⁷
112. Po ashtu, në çështjen **Liberty dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar**, ku organizata Liberty dhe të tjerë u ankuan kundër përgjimit të komunikimeve ndërkombëtare nga autoritetet britanike sipas ligjit të quajtur “Interception of Communications Act 1985”,¹⁸ ata pretenduan se nuk kishte asnjë mënyrë për të ditur kur dhe si mund të përdreshin të dhënat e tyre, dhe se sistemi ishte i fshehtë dhe i pakontrollueshëm. Gjykata konstatoi se ndërhyrja nuk ishte “në përputhje me ligjin”, pasi ligji nuk ishte i qasshëm për publikun, nuk specifikonte kategoritë e njerëzve që mund të përdreshin si objekt përgjimi dhe nuk vendoste kufij të qartë. Rrjedhimisht, nuk kishte garanci të mjaftueshme për të parandaluar ndërhyrjet arbitrare.
113. **Së dyti**, Gjykata Evropiane pranon se disa kufizime ndaj korrespondencës mund të jenë të justifikuara nëse synojnë qëllime të ligjshme të përcaktuara nga neni 8(2) i Konventës, si mbrojtja e sigurisë kombëtare, parandalimi i krimit, apo mbrojtja e të drejtave të të tjerëve. Por autoritetet duhet të tregojnë lidhje të qartë midis ndërhyrjes dhe qëllimit legjitim të ndjekur, si dhe duhet të shoqërohet me garanci të fuqishme ligjore.¹⁹ Gjykata ka vendosur një praktikë të qëndrueshme për të mbrojtur jo vetëm përmbajtjen e komunikimeve, por edhe informacionin përkatës si metadata, kontaktet,

¹⁷ European Court of Human Rights, *Malone v. United Kingdom*, no. 8691/79, Judgment of 2 August 1984. <https://hudoc.echr.coe.int/eng#%7B%22itemid%22:%5B%22001-57533%22%5D%7D>

¹⁸ European Court of Human Rights, *Liberty and Others v. the United Kingdom*, Judgment of 1 July 2008. <https://hudoc.echr.coe.int/fre#%7B%22itemid%22:%5B%22001-87207%22%5D%7D>

¹⁹ European Court of Human Rights, *Klass and Others v. Germany*, no. 5029/71, Judgment of 6 September 1978

datat dhe vendndodhjet. Gjykata ka vlerësuar se edhe metadat mund të zbulojnë elementë të jetës private dhe për këtë arsye kanë nevojë për mbrojtje të barabartë me përmbajtjen.²⁰ Rrjedhimisht, ndërhyrja në këto forma të reja komunikimi kërkon jo vetëm një bazë ligjore dhe qëllim legjitim, por edhe garanci efektive kundër abuzimit dhe mbikëqyrje të pavarur. Autoritetet duhet të tregojnë lidhje të qartë midis ndërhyrjes dhe qëllimit legjitim të ndjekur. Në çështjen **Weber dhe Saravia kundër Gjermanisë**, në të cilën një gazetare dhe bashkëpunëtorja e saj sfiduan ligjin gjerman që lejonte përgjimin e komunikimeve strategjike ndërkombëtare, ata pretenduan se ligji ishte i gjerë, i pasaktë dhe u shkelte të drejtën për korrespondencë. Gjykata vlerësoi se ndërhyrja kishte një qëllim legjitim, mbrojtjen e sigurisë kombëtare dhe parandalimin e terrorizmit dhe se ligji përmbante elementë që garantonin një nivel të lartë mbikëqyrjeje gjyqësore dhe procedurale.²¹ Megjithatë, rasti tregoi rëndësinë e balancimit midis sigurisë dhe privatësisë.

114. **Së treti**, kriteri i proporcionalitetit. Gjykata vlerëson nëse ndërhyrja është “e nevojshme në një shoqëri demokratike”, domethënë nëse është: e domosdoshme, jo thjesht e dëshirueshme; proporcionale në raport me qëllimin e ndjekur; e shoqëruar me garanci të mjaftueshme kundër keqpërdorimit të kompetencave shtetërore. Ky është një standard dinamik që merr parasysh natyrën e teknologjisë moderne, zhvillimet e sigurisë dhe të drejtat individuale. Në çështjen **Roman Zakharov kundër Rusisë**, në të cilin Zakharov, një botues rus, sfidoi një sistem ligjor që lejonte shërbimet e sigurisë të përgjonin komunikimet telefonike të qytetarëve pa autorizim të drejtpërdrejtë nga gjykata për raste individuale. Ai nuk kishte prova se ishte përgjuar vetë, por argumentoi se vetë ekzistenca e sistemit përbënte një kërcënim të vazhdueshëm për të drejtën e tij. Gjykata e gjeti Rusinë në shkelje të Nenit 8 të Konventës, duke theksuar se sistemi i përgjimit ishte i ndërtuar në mënyrë që lejonte mbikëqyrje masive pa garanci efektive ligjore ose gjyqësore. U theksua se një shoqëri demokratike kërkon jo vetëm

²⁰ European Court of Human Rights. P.G. and J.H. v. the United Kingdom, no. 44787/98, judgment of 25 September 2001

²¹ European Court of Human Rights, *Weber and Saravia v. Germany*. <https://hudoc.echr.coe.int/eng#%7B%22itemid%22:%5B%22002-3235%22%5D%7D>

legjitimitet formal, por edhe **proporcionalitet real**, me procedura mbrojtëse dhe kontroll të jashtëm mbi autoritetet.²²

115. Ndërsa, në çështjen **Uzun kundër Gjermanisë**, Gjykata u mor me përdorimin e pajisjeve GPS për ndjekjen e individëve të dyshuar për aktivitete kriminale. Edhe pse Gjykata e cilësoi përgjimin si proporcional në atë rast të veçantë, theksoi se duke pasur parasysh rrezikun e abuzimit që është i natyrshëm në çdo sistem mbikëqyrjeje sekrete, masa të tilla duhet të bazohen në një ligj që është veçanërisht i saktë, veçanërisht pasi teknologjia që është në dispozicion për përdorim po bëhet vazhdimisht më e sofistikuar.²³

116. Lidhur me standardin e vendosur nga jurisprudenca e GJEDNJ se e drejta për korrespondencë nuk është e kufizuar vetëm në letrat postare apo thirrjet telefonike, por përfshin një spektër të gjerë mjetesh komunikimi, përfshirë ato elektronike dhe të lidhura me internetin, GJEDNJ ka dhënë një sërë vendimesh të rëndësishme, standardet e vendosura në të cilat duhet të kishin gjetur zbatim edhe në çështjen në fjalë. Më konkretisht, në çështjen **Copland kundër Mbretërisë së Bashkuar**, kërkesja punonte në një kolegji shtetëror dhe u ankua për mbikëqyrjen e fshehtë të përdorimit të telefonit, postës elektronike dhe internetit nga punëdhënësi i saj. Gjykata konstatoi se kishte pasur një ndërhyrje në të drejtën e saj për korrespondencë, edhe pse ajo përdorte mjetet e punës. U theksua se përdorimi i internetit dhe emaileve të punës, edhe kur kryhet në ambientet e punës, nuk e humb automatikisht mbrojtjen nga neni 8, për aq kohë sa punonjësi nuk është njoftuar qartë për mbikëqyrjen.²⁴ Ky vendim vendosi një standard themelor: që informimi paraprak dhe transparencja janë elementë të domosdoshëm për një ndërhyrje të ligjshme.

117. Një tjetër çështje kyçe është **Bărbulescu kundër Rumanisë**, ku kërkesi u pushua nga puna pasi punëdhënësi monitoroi mesazhet e tij në Yahoo Messenger gjatë orarit të

²² European Court of Human Rights, *Zakharov v. Russia* [GC], no. 47143/06, Judgment of 4 December 2015. <https://hudoc.echr.coe.int/eng#%7B%22display%22:%5B%220%22%5D,%22languageisocode%22:%5B%22ALB%22%5D,%22appno%22:%5B%2247143/06%22%5D,%22documentcollectionid%22:%5B%22GRANDCHAMBER%22%5D%7D>

²³ European Court of Human Rights, *Uzun v. Germany*, no. 35623/05, Judgment of 2 September 2010. <https://hudoc.echr.coe.int/eng#%7B%22itemid%22:%5B%22001-100293%22%5D%7D>

²⁴ European Court of Human Rights. *Copland v. the United Kingdom*, no. 62617/00, judgment of 3 April 2007. <https://hudoc.echr.coe.int/eng#%7B%22itemid%22:%5B%22001-79996%22%5D%7D>

punës.²⁵ Fillimisht, Gjykata nuk gjeti shkelje, por në apel në Dhomën e Madhe ajo ndryshoi qëndrim, duke vendosur që shteti kishte dështuar të ruante balancën ndërmjet të drejtës së punëdhënësit për të mbikëqyrur dhe të drejtës së punonjësit për korrespondencë. Gjykata ritheksoi se komunikimet personale në punë nuk janë automatikisht të pambrojtura dhe se mbikëqyrja duhet të jetë proporcionale dhe e justifikuar. Kjo çështje vendosi një precedent të rëndësishëm për të drejtat digjitale në vendin e punës.

118. Në çështjen **Amann kundër Zvicrës**, Gjykata shqyrtoi një rast ku autoritetet kishin regjistruar një thirrje telefonike të bërë nga një zyrë e një kompanie private, pa pëlqimin e individit. Edhe pse komunikimi ishte bërë nga ambient profesional, Gjykata sqaroi se as vendi dhe as qëllimi i komunikimit nuk janë faktorë përjashtues dhe se çdo komunikim privat mbrohet nga neni 8, për sa kohë nuk ka heqje të drejtës për privatësi.²⁶ Rasti përforcoi idenë që korrespondenca elektronike, përfshirë thirrjet nga një zyrë, është e mbrojtur pavarësisht nëse është në kontekst profesional.

119. Gjithashtu, në rastin **Tena Arregui kundër Spanjës**, Gjykata analizoi mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave personale nga email-e të dërguara përmes një rrjeti të brendshëm kompjuterik. Ajo vendosi se përdorimi i emailit, edhe nëse nuk është publik, hyn në sferën e mbrojtur të nenit 8 të Konventës, për sa kohë përmbajtja e tyre ka karakter personal ose të ndjeshëm.²⁷ Ky rast shënon një hap të mëtejshëm në përfshirjen e infrastrukturës digjitale brenda koncepteve tradicionale të të drejtave të njeriut.

120. Për më tepër, çështja **P.G. dhe J.H. kundër Mbretërisë së Bashkuar** kontribuon në kuptimin e faktit që jo vetëm përmbajtja, por edhe informacioni rreth komunikimeve, si datat, numrat e thirrjeve apo kohëzgjatja, mbrohen nga neni 8 i Konventës. Në këtë rast,

²⁵ European Court of Human Rights. *Bărbulescu v. Romania* [GC], no. 61496/08, judgment of 5 September 2017. <https://hudoc.echr.coe.int/eng#%7B%22languageisocode%22:%5B%22ALB%22%5D,%22appno%22:%5B%2261496/08%22%5D,%22documentcollectionid%22:%5B%22GRANDCHAMBER%22%5D,%22itemid%22:%5B%22001-191663%22%5D%7D>

²⁶ European Court of Human Rights. *Amann v. Switzerland* [GC], no. 27798/95, judgment of 16 February 2000. <https://hudoc.echr.coe.int/eng#%7B%22itemid%22:%5B%22001-58497%22%5D%7D>

²⁷ European Court of Human Rights. *Tena Arregui v. Spain*, no. 46716/18, judgment of 6 February 2024. <https://hudoc.echr.coe.int/eng#%7B%22itemid%22:%5B%22001-229933%22%5D%7D>

të dhënat e grumbulluara nga autoritetet policore rreth thirrjeve telefonike të individëve ishin mbledhur pa bazë ligjore të përcaktuar mirë. Gjykata vlerësoi se edhe metadata-t mund të zbulojnë elementë të jetës private dhe për këtë arsye kanë nevojë për mbrojtje të barabartë me përmbajtjen.²⁸

9. Hetimi i çështjes nga një prokuror që nuk plotësonte kriteret për t'u emëruar si i tillë dhe ushtrimi i detyrës në kushtet e konfliktit të interesit

121. Në rastin konkret, ekzistojnë dy problematika thelbësore që vënë në diskutim legjitimitetin e veprimeve të prokurorit Olsi Dado në procedimin penal ndaj z. Erion Veliaj: së pari, mungesa e kushteve ligjore për të ushtruar funksionin e prokurorit në momentin e emërimit të tij; dhe së dyti, ekzistenca e një konflikti real dhe të pamohueshëm interesi në raport me subjektin nën hetim, z. Veliaj. Këto dy elementë të kombinuar nuk përbëjnë vetëm shkelje të natyrës formale, por rrënojnë themelin e parimit të sigurisë juridike, duke kompromentuar të gjithë procesin penal dhe duke cenuar drejtpërdrejt të drejtën e individit për një proces të paanshëm dhe të drejtë.

122. Në lidhje me mungesën e kushteve për të ushtruar funksionin, është tashmë fakt i pakontestueshëm që z. Olsi Dado, në momentin e emërimit si prokuror, nuk përmbushte kriteret e nevojshme që rrjedhin nga legjislacioni përkatës mbi statusin e magjistratit. Eksperienca e tij e mëparshme si noter nuk është e vlefshme për plotësimin e kushteve për emërim në sistemin e prokurorisë, çka e bën aktin e emërimit të tij të pavlefshëm. Më konkretisht, neni 18 i ligjit nr. 8737, datë 12.02.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë“, i ndryshuar (në fuqi në momentin e emërimit të z. Dado), me titullin “Kushte të veçanta”, parashikonte se mund të emërohet prokuror edhe personi që nuk ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës, nëse përmbush kriteret e tjera të përcaktuara në nenin 17 të këtij ligji dhe njërin prej kushteve të mëposhtme: a) ka punuar gjyqtar ose prokuror; b) ka punuar jo më pak se 5 vjet oficer i policisë gjyqësore. Me propozimin e Prokurorit të Përgjithshëm, Presidenti i Republikës mund të emërojë në prokuroritë e shkallës së

²⁸ European Court of Human Rights. *P.G. and J.H. v. the United Kingdom*, no. 44787/98, judgment of 25 September 2001. <https://hudoc.echr.coe.int/eng/#%7B%22itemid%22:%5B%22001-59665%22%5D%7D>

parë, deri në 10 për qind të numrit të përgjithshëm të prokurorëve, shtetas, të cilët kanë punuar më parë prokurorë, gjyqtarë apo oficerë të policisë gjyqësore, që përmbushin kriteret e shkronjave “a”, “b”, “c”, “d”, “dh”, “e” dhe “ë” të nenit 17 dhe të shkronjës “b” të këtij neni. Z. Dado nuk plotësonte asnjë prej këtyre kriterëve të veçanta të nevojshme për tu emëruar prokuror.

123. Në thelb të shtetit të së drejtës qëndron parimi i legalitetit institucional: çdo akt i kryer nga një funksionar publik duhet të mbështetet jo vetëm në ligj, por edhe në kapacitetin ligjor të autorit që e ndërmerr atë. Në mënyrë të posaçme në fushën penale, ku kufizohen të drejta dhe liri themelore të individit, kërkesa që prokurori të jetë i emëruar ligjërisht dhe të ketë status të vlefshëm si magjistrat është kusht themelor për ligjshmërinë e çdo procedimi penal. Ky nuk është një formalitet. Është garanci substanciale për sigurinë juridike dhe shtetin e së drejtës.

124. Në rastin konkret, ekzistojnë dy problematika të lidhura ngushtë dhe të një rëndësie të jashtëzakonshme:

1. **Z. Olsi Dado nuk ka plotësuar kushtet e kërkuara me ligj për t’u emëruar prokuror** në momentin e dekretimit të tij. Ai nuk ka qenë prokuror, gjyqtar apo oficer i policisë gjyqësore për më shumë se 5 vjet, siç kërkohet nga neni 18 i ligjit nr. 8737/2001 (në fuqi në atë kohë), dhe për pasojë nuk mund të emërohej as me përjashtim nga Presidenti sipas dispozitave për 10% të kuotës. Eksperienca e tij si noter nuk është e përcaktuar në asnjë dispozitë ligjore si burim legjitimiteti për të hyrë në sistemin e prokurorisë.
2. **Ky emërim i jashtëligjshëm e bën të pavlefshëm jo vetëm vendimin përkatës, por edhe çdo akt të ndërmarrë nga ai në kapacitetin e “prokurorit”.** Kjo rrjedh nga neni 66 i ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”, i cili në pikën 1, shkronja “b”, parashikon qartë se kur vendimi i emërimit është i pavlefshëm dhe nuk sjell pasoja juridike, personi nuk fiton statusin e magjistratit, dhe ai status konsiderohet i përfunduar.

125. Nga kjo pasojnë të pakundërshtueshme juridikisht:

- Së pari, **z. Dado nuk ka qenë asnjëherë prokuror në kuptimin juridik të fjalës.** Ai nuk ka gëzuar asnjë ditë status të vlefshëm ligjor si magjistrat. Ai ka vepruar si

prokuror pa e pasur kurrë këtë cilësi, dhe çdo ushtrim kompetence nga një person pa status është një uzurpim funksioni publik, i ndaluar nga Kushtetuta dhe ligji. Veprimet e ndërmarra nga z. Olsi Dado potencialisht përbëjnë edhe përvetësim të detyrës shtetërore në kuptimin e nenit 246 të Kodit Penal, pasi janë kryer nga një person që nuk ka pasur statusin e ligjshëm të prokurorit, duke prodhuar pasoja të rënda në lirinë dhe të drejtat e shtetasve shqiptarë. Në këtë kuptim, ky nuk është vetëm një problem i vlefshmërisë procedurale, por një shkelje penale me pasoja të drejtpërdrejta në rendin juridik dhe në dinjitetin e të pandehurit, i cili është arrestuar, proceduar dhe akuzuar nga një subjekt që nuk ka ekzistuar ligjërisht si prokuror.

- Së dyti, **çdo akt procedural i ndërmarrë prej tij në çështjen penale ndaj z. Veliaj, përfshirë vendimin për regjistrimin e procedimit, kërkesat për masa sigurie, autorizimet për veprime hetimore apo ngritjen e akuzës, janë të pavlefshme në mënyrë absolute.** Këto akte janë të përfshira nga **mungesa e autoritetit ligjor të autorit**, që përbën shkak themelor për pavlefshmëri sipas nenit 128 të Kodit të Procedurës Penale.

126. Kjo situatë nuk është një thjesht shkelje e rregullave të brendshme të emërimit, është një **shkelje themelore që çon në inekzistencën juridike të procedimit penal.** Një proces penal nuk mund të lindë në mënyrë të ligjshme nga një akt i ndërmarrë nga një person që nuk ka të drejtë të veprojë si organ procedues. Ky është një rrezik serioz për themelet e shtetit të së drejtës, pasi i hap rrugë krijimit të një drejtësie paralele, ku qytetarët mund të hetohen, kufizohen dhe procedohen nga individë që nuk janë të autorizuar ligjërisht.

127. Për më tepër, çështja nuk ka vetëm dimension ligjor, por edhe institucional dhe politik: nëse ndaj një qytetari, aq më tepër një zyrtari të lartë të zgjedhur me votë popullore, ndërmerren veprime hetimore nga një person që nuk ka status ligjor si prokuror, kjo **kompromenton në mënyrë të parikuperueshme legjitimitetin e gjithë procesit**, duke shndërruar të gjithë hetimin në një **akt arbitrar institucional.**

128. Në përfundim, hetimi penal ndaj z. Veliaj është ndërtuar mbi një akt të pavlefshëm që në themel, pasi është ndërmarrë nga një individ që kurrë nuk ka pasur të drejtën ligjore për të ushtruar funksionin e prokurorit. Çdo provë, masë sigurie, apo akt

procedural i prodhuar nga ky subjekt është i kontaminuar nga kjo mungesë legjitimiteti, dhe për rrjedhojë është i papërdorshëm dhe i pavlefshëm absolutisht.

129. Aq më tepër rëndohet situata nga fakti se i njëjti subjekt ka qenë përfitues direkt i një leje ndërtimi të dhënë nga institucioni i drejtuar nga z. Veliaj, pikërisht personi që ai më pas ka vendosur ta hetojë dhe të formulojë ndaj tij akuza penale. Ky raport i qartë përfitimi reciprok e shndërron këtë çështje nga një diskutim teknik në një problem serioz të konfliktit të interesit, të cilin ligji e ndalon në mënyrë eksplicite. Jo vetëm që z. Dado është përfitues real, i kontraktuar me dokumentacion zyrtar si blerës i sipërfaqes ndërtimore, por edhe pasi pretendimet e tij për leje shtesë janë refuzuar, ka ndërmarrë veprime hetimore në funksion të ndërtimit të një akuze ndaj drejtuesit të institucionit që ka dhënë lejen. Ky fakt krijon dyshimin e arsyeshëm se veprimtaria e tij hetimore është motivuar jo nga ndonjë detyrim profesional, por nga një ndjenjë hakmarrjeje personale, e cila është e papajtueshme me etikën dhe statusin e një magjistrati.
130. Prokurori i çështjes, i cili ka ngritur akuzat ndaj z. Veliaj, nuk duhej të pranonte hetimin e shkaqeve të ngritura në kallëzimin penal të depozituar nga i ashtuquajturi “Nesti Angoni”, pasi Olsi Dado ka përfituar sipërfaqe ndërtimore miratuar me vendimin nr. U-14078/4, datë 09.09.2021 të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, dhe lejen e ndërtimit nr. U-14078/6, datë 21.09.2021. Është e vërtetë që leja e ndërtimit i është akorduar subjektit zhvillues/ndërtues, shoqërisë “Alb Edil” sh.p.k, por referuar kontratës së sipërmarrjes nr. Rep 2040, nr. Kol 803, datë 06.05.2021 pala porositëse dhe përfituese njëkohësisht, është prokurori i çështjes kundër titullarit të institucionit që ka dhënë lejen e ndërtimit, pra personit në hetim Erion Veliaj.
131. Fakti që përfitues nga procedura e dhënies së lejes së ndërtimit është prokurori Olsi Dado është i pandryshueshëm. Telefonatat e prokurorit, i cili shpreh pakënaqësinë në lidhje me procedurën e dhënies së lejes së ndërtimit, dëshmojnë qartë qëllimin keqdashës të zotit Ols Dado për të pasqyruar në dosjen hetimore fakte të pavërteta. Edhe nëse zoti Ols Dado nuk do të ushtronte ndikimin e tij në lidhje me lejen e ndërtimit, mjafton vetëm fakti se është përfitues, për t’u vërtetuar konflikti i interesit. Thjesht fakti që prokurori është subjekt përfitues nga leja e ndërtimit, do të thotë se

ndodhet në konflikt të hapur interesi, e për pasojë nuk duhet të kishte përfaqësuar akuzën që në krye të herës.

132. Pra, fakti që prokurori ka përdorur infrastrukturën shtetërore (telefonin zyrtar) për të ndjekur interesa private në fushën e ndërtimit dhe më pas ka marrë rol aktiv në hetimin penal të autoritetit që i kishte refuzuar kërkesat, e thellon më tej konfliktin e interesit, duke bërë të qartë që nuk ka pasur as distancë formale dhe as përpjekje për vetë përjashtim nga çështja, siç e kërkon shprehimisht ligji. Edhe nëse do të supozohej se z. Dado ka vepruar në mënyrë të paanshme, vetë ekzistenca e këtij interesi të mëparshëm përfitues e bën objektivisht të papranueshme përfshirjen e tij në procedimin penal ndaj z. Veliaj. Kjo përbën një shkelje të drejtpërdrejtë të parimit të paanësisë objektive, siç është njohur në jurisprudencën e konsoliduar të gjykatave ndërkombëtare.

133. Prokurori i çështjes jo vetëm që ka vepruar jashtë kufijve të kompetencës së tij funksionale dhe ligjore, por ka vepruar në kushte të qarta konflikti interesi. Kjo jo vetëm që cenon seriozisht të drejtën e z. Veliaj për një proces të drejtë dhe të paanshëm, por hedh hije të thellë mbi ligjshmërinë e gjithë procedimit penal. Në këto rrethana, çdo akt i ndërmarrë nga një subjekt i tillë është juridikisht i dyshimtë dhe materialisht i pavlefshëm. Shteti i së drejtës nuk mund të mbështetet mbi hetime të kryera nga individë që nuk gëzojnë status ligjor dhe që veprojnë në përplasje të drejtpërdrejtë me etikën dhe detyrimet e funksionit që pretendojnë të ushtrojnë.

134. Në ndërtimin e akuzës ndaj z. Veliaj, prokurori Olsi Dado i mjaftohet thjesht lidhjes kohore dhe faktit të pagesës së një fature hoteli nga një subjekt që më parë ka marrë leje ndërtimi nga Bashkia e Tiranës. Ky konfigurim, i zhveshur nga çdo element tjetër i qëllimit apo marrëveshjes, konsiderohet prej tij si korrupsion pasiv i zyrtarit publik.

135. Por nëse kjo logjikë e thjeshtuar dhe lineare zbatohet me të njëjtën masë edhe për vetë veprimtarinë e prokurorit, atëherë lind një pyetje e pashmangshme: a nuk është korrupsion aktiv, në formën in contrario, fakti që një individ i cili ka përfituar më parë nga një leje ndërtimi e dhënë nga institucioni i drejtuar nga z. Veliaj, dhe që më pas ka kërkuar shtesë leje, kërkesë që i është refuzuar nga i njëjti institucion, vendos të ndërtojë një akuzë penale ndaj po këtij drejtuesi bashkie? Pra, **nëse leja ndërtimore, e ndjekur nga një sponsorizim, është interpretuar si favor dhe si kundërshpërblim**

penalizues, atëherë **a nuk përbën gjithashtu një formë presioni penal dhe për rrjedhojë, korrupsion në formë të zhdrejtë, akti i ngritjes së një akuze penale vetëm pasi nuk je përfshirë në favorizimin që u kërkua më parë?**

136. Ky është një rast tipik i **abuzimit të funksionit shtetëror për hakmarrje personale**, i cili në vetvete përbën një formë më të rëndë të devijimit të pushtetit publik dhe përdorimit të sistemit të drejtësisë si instrument represioni. Nëse të njëjtat standarde penalizuese do të aplikoheshin ndaj veprimeve të prokurorit, atëherë **dosja penale nuk do të duhej të kishte Erion Veliajn si të pandehur, por vetë ish noteri, sot prokuror i paaautorizuar nga ligji, Olsi Dadon.**

III. Regjistrimi i një “fraksioni” me qëllim mos garantimin e të drejtave procedurale

137. Në mënyrë të qëllimshme dhe të paramenduar, prokurorët e çështjes kanë përdorur një artificë procedurale, të paparashikuar në legjislacioni procedural në fuqi, për të zgjatur në mënyrë të padrejtë dhe të paligjshme fazën e hetimeve paraprake, duke regjistruar një “fraksion” brenda të njëjtit procedim penal, por pa identifikuar asnjë person konkret ndaj të cilit atribuohet vepra penale. Kjo manovër ka shërbyer për t'i dhënë pamjen e një procedimi të ligjshëm një veprimtarie të papërputhshme me standardet kushtetuese dhe procedurale që rregullojnë nisjen dhe zhvillimin e hetimeve penale. Kodi i Procedurës Penale nuk njeh nocionin juridik të regjistrimit të një “fraksioni” si njësi autonome brenda një procedimi të regjistruar më parë. Çdo procedim penal duhet të regjistrohet si i tillë, në mënyrë të pavarur, dhe në respekt të rreptë të kushteve dhe kritereve që përcakton ligji për nisjen e hetimit ndaj një personi të caktuar.

138. Në momentin që një shtetas bëhet objekt i hetimeve penale dhe ndaj tij ndërmerren akte të hetimit, ai duhet të përfitojë menjëherë nga e gjithë gama e garancive procedurale që buron nga ky status. Duke shmangur regjistrimin formal të z. Veliaj si subjekt që i atribuohet vepra penale, prokuroria i ka mohuar atij këto garanci, duke e vendosur në një pozitë të pambrojtur përballë një procesi të errët dhe të pakontrolluar institucionalisht. Në këtë mënyrë, është krijuar një situatë faktike e përndjekjes pa akuzë, që shkel të drejtën për siguri juridike, për mbrojtje efektive dhe për një gjykim të

drejtë brenda një afati të arsyeshëm. Në mungesë të regjistrimit të emrit të personit ndaj të cilit pretendohet se ka kryer veprë penale, nuk fillojnë afatet e hetimit dhe nuk aktivizohen të drejtat dhe garancitë themelore të të hetuarit.

139. Në këtë rast, prokurorët kanë vepruar në mënyrë të qëllimshme për të evituar detyrimin ligjor për të regjistruar emrin e personit ndaj të cilit i atribuohet vepra penale, me qëllim të mos nisjes së afateve procedurale hetimore dhe të mosaktivizimit të garancive mbrojtëse të parashikuara për të hetuarin. Kjo shmangie nuk përbën thjesht një gabim teknik, por është një shkelje strukturore që minon gjithë procesin penal. Në mungesë të regjistrimit formal të procedimit dhe të identifikimit të personit që është objekt i hetimit, i ashtuquajturit procedim nuk prodhon pasoja juridike dhe, në thelb, është një hetim informal, jashtë çdo kontrolli institucional dhe gjyqësor.

140. Më tej, duhet theksuar se kjo teknikë, përveçse shkelje e parimeve kushtetuese të sigurisë juridike dhe barazisë përpara ligjit, përbën një formë presioni të heshtur dhe të zgjatur ndaj subjektit të hetimit dhe rrethit të tij familjar. Duke e mbajtur z. Veliaj në një status të paqartë, por publikisht “të njollosur” përmes deklarimeve publike se ndaj tij prokuroria ka hapur një fraksion në kuadër të procedimit nr. 27/2024, prokuroria jo vetëm që ka vepruar në kundërshtim me ligjin, por ka synuar të prodhojë efekte të drejtpërdrejta psikologjike, sociale dhe politike. Në vend që të veprojë si një organ që ndjek penalisht shkeljet e ligjit me objektivitet dhe brenda kufijve të ligjshmërisë, prokuroria ka instrumentalizuar pushtetin e saj për të krijuar një formë të “pezullimit procedural” të së drejtës së mbrojtjes dhe për të frenuar çdo përpjekje të z. Veliaj për të ekspozuar padrejtësitë dhe abuzimet e kryera ndaj tij në këtë “fraksion”.

141. Ky manovrim procedural është përdorur për të mbajtur në një status juridik të paemërtuar z. Veliaj, duke e privuar nga çdo mjet mbrojtjeje efektive dhe nga e drejta për të kontestuar veprimet e paligjshme që ndërmerren ndaj tij. Prokuroria, duke krijuar një formë të ndërmjetme që nuk ekziston në ligj, si rrjedhojë të paligjshme, “fraksion procedimi pa emër personi”, ka prodhuar një anomali të rrezikshme: ka kryer hetime ndaj një individi pa i dhënë atij statusin formal të subjektit të procedimit penal, por njëkohësisht ka shfrytëzuar aktet e krijuara gjatë këtij “fraksioni” për të ushqyer akuzën, pa i dhënë mundësi personit të mbrohet ndaj tyre në kohë.

142. Ky është një rrezik i dyfishtë: jo vetëm që individi në fjalë, në këtë rast z. Veliaj, mbahet nën një hetim de facto pa të drejtë mbrojtjeje, por edhe sistemi i drejtësisë dëmtohet në integritetin e tij, prandaj, çdo akt i kryer në këtë “fraksion” të paparashikuar sipas ligjit, është jo vetëm i papërdorshëm, por është prodhuar në mungesë absolute të legjitimitetit. Ky është një abuzim me formën, me qëllim manipulimin e përmbajtjes dhe instrumentalizimin e procedurës penale, në funksion të një “agjendave të tjera”, e jo të drejtësisë.

10. Cënimi i së drejtës për mbrojtje efektive dhe barazisë së palëve përmes caktimit të afateve procedurale procedurale të cilat nuk garantojnë të drejtën për t’u njohur me akuzën, me veprimet hetimore të kryera dhe provat në ngarkim

143. Në përfundim të hetimeve paraprake, në datën 23.07.2025 Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka vendosur marrjen me cilësinë e të pandehurit dhe njoftimin e akuzës për z. Erion Veliaj, me funksion kryetar i Bashkisë Tiranë, akuzuar për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 260, 287/2, 324/a/2 si dhe nenin 248 të Kodit Penal. Po në datën 23.07.2025, organi i akuzës ka vendosur të përfundojë hetimet sipas aktit procedural përkatës që na është njoftuar në datën 23.07.2025 për procedimin penal Nr.27 të vitit 2024, ka vendosur zgjatjen e afatit të hetimeve deri në 24.09.2025, por përveç kopjes së këtyre tre akteve procedurale, nuk ka vendosur në dispozicion të mbrojtjes asnjë akt tjetër apo provat në ngarkim të klientit tonë, duke na mohuar të drejtën që të njihemi sa më parë me aktet e këtij procedimi penal. Me gjithë insistimin tonë, asnjë akt apo fashikull hetimor nuk na është vendosur në dispozicion, duke na vendosur në pamundësi që të parashitrojmë një memo bazuar mbi aktet, sipas kërkesave të nenit 327.4 të K.Pr.Penale.

144. Vetëm në orët e vona të datës 24.07.2025 na është vendosur në dispozicion një usb me kopje të akteve të skanuara të procedimit penal Nr.27 të vitit 2024, në përmbajtje të së cilës janë mbi 150 volume fashikujsh hetimorë e një numër i konsiderueshëm faqesh me të dhëna komplekse e shumë persona të tjerë të pandehur. Mjafton sa më sipër për të evidentuar pamundësinë objektive të të pandehurit dhe mbrojtjes së tij që brenda një kohe kaq të shkurtër, siç është afati 10 ditor që parashikon neni 327 i K.Pr.Penale, të

mund të njihet efektivisht me faktet objekt akuze, provat e grumbulluara në tërësi dhe ato në ngarkim të z. Veliaj në veçanti. Në këto kushte, për ushtrimin efektiv të së drejtës çdo personi për t'u mbrojtur, kërkohet medoemos një afat i arsyeshëm me qëllim që të njihemi me aktet dhe të paraqesim kërkesa sipas paragrafit 4 të nenit 327 të K.Pr.Penale.

145. Për këtë arsye nga ana e mbrojtjes së zotit Erion Veliaj është paraqitur pranë Prokurorisë së Posaçme një memo për shtyrjen e këtij afati 10 ditor me qëllim për të pasur më shumë kohë për tu njohur me fashikujt hetimor dhe për të përgatitur memorien sipas nenit 327/4 të Kodit të Procedurës Penale. Më konkretisht, me shkresën e datës 25.07.2025, z. Veliaj kërkoi zgjatjen e afatit 10 ditor të parashikuar nga neni 327, pika 4 e Kodit të Procedurës Penale, për paraqitjen e memos përkatëse, lidhur me pretendimet e tij për akuzën e komunikuar, provat në ngarkim, pasi të njëjti edhe me veprimet hetimore të prokurorisë. Kjo me qëllim garantimin e së drejtës për një mbrojtje efektive.

146. Në datën 24.07.2025 Prokuroria vendosi zgjatjen e afatit hetimor të këtij procedimi penal deri në 24.09.2025. Ndërsa në orët e vona të datës 24.07.2025 Prokuroria i vuri në dispozicion mbrojtjes në formë elektronike mbi 150 volume fashikujsh hetimor, të organizuara në skedarë të formatit pdf, të ruajtura në një paisje USB, të cilat përmbajnë një numër të konsiderueshëm aktesh procedurale me të dhëna komplekse të lidhura jo vetëm me të mbrojturin prej nesh por edhe me persona të tjerë të pandehur në kuadër të këtij procedimi penal. Nisur nga volumi jashtëzakonisht i madh i materialeve hetimore, rreth 60,000 faqe z. Erion Veliaj dhe mbrojtja e tij ndodhen në një pamundësi objektive për t'u njohur në mënyrë efektive, brenda afatit 10-ditor të parashikuar nga neni 327, pika 4 e Kodit të Procedurës Penale, me përmbajtjen e plotë të akteve dhe provave mbi të cilat ngrihet akuza. Edhe nëse do të bëhej vetëm një lexim i thjeshtë linear, pa analizë profesionale, pa mbajtje shënimesh apo përpunim juridik të përmbajtjes, për një mesatare prej 2–3 minutash për faqe, një avokat do të duhej të punonte afërsisht 360 ditë me 8 orë në ditë për të përfunduar këtë material. Nëse materiali ndahet mes dy avokatëve, do të kërkonte minimalisht 180 ditë pune të përditshme vetëm për leximin mekanik të tij.

147. Kjo e bën praktikisht të pamundur përgatitjen e një mbrojtjeje efektive dhe të barabartë (prokuroria ka pasur 2 vite në dispozicion), ashtu siç garantohet nga neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, i cili kërkon që të pandehurit të kenë kohë dhe mundësi të mjaftueshme për t'u mbrojtur. Kjo situatë rëndohet më tej nga fakti se jemi në fund të muajit korrik dhe periudha e muajit gusht, siç dihet, është periudhë e reduktuar pune për organet e drejtësisë, përfshirë gjykatat, prokuroritë dhe avokatët. Kjo krijon një pengesë objektive shtesë për përgatitjen e mbrojtjes, pasi në praktikë ndërpritet ose ngadalësohet ndjeshëm funksionimi i sistemit të drejtësisë
148. Ky disproporcion mes afatit procedural dhe volumit të materialeve nuk është thjesht çështje praktike, është një cenim thelbësor i të drejtës për mbrojtje efektive dhe për proces të rregullt ligjor, që e zhvlerëson të gjithë garancinë procedurale që Kodi i Procedurës Penale dhe Konventa synojnë të mbrojnë. Kjo lloj "përmbytjeje dokumentare" është një formë abuzimi strukturor me të drejtën e mbrojtjes, që Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut e ka konsideruar të papranueshme në disa vendime, kur volumi i materialeve i bën të pavlefshme në praktikë garancitë procedurale që duken formalisht të respektuara.
149. Me vendimin e datës 29.07.2025, prokurorët e çështjes, në shkelje të parimit të barazisë së armëve dhe mbrojtjes efektive, vendosën refuzimin e kërkesës së z. Veliaj për zgjatjen e afatit 10 ditor për paraqitjen e memos.
150. Barazia e armëve është një element i natyrshëm i një gjykimi të drejtë. Ajo kërkon që secilës palë t'i jepet një mundësi e arsyeshme për të paraqitur çështjen e vet, në kushte që nuk e vendosin atë në një pozitë të pafavorshme në raport me palën tjetër (*Öcalan kundër Turqisë ëGCJ*, 2005, § 140; *Foucher kundër Francës*, 1997, § 34; *Bulut kundër Austrisë*, 1996; *Faig Mammadov kundër Azerbajxhanit*, 2017, § 19). Barazia e armëve kërkon që të arrihet një ekuilibër i drejtë midis palëve dhe zbatohet si në çështjet penale, ashtu edhe në ato civile.
151. Kjo e drejtë nënkupton, në parim, mundësinë për palët që të kenë dijeni dhe të shprehen mbi të gjitha provat e paraqitura ose vërejtjet e depozituara me qëllim të ndikuar vendimmarrjen e gjykatës (*Brandstetter kundër Austrisë*, 1991, § 67). Si rregull, nga këndvështrimi i këtij parimi, Gjykata nuk ka nevojë të përcaktojë nëse

moskomunikimi i dokumentit përkatës i ka shkaktuar ndonjë dëm aplikantit: ekzistenca e një shkeljeje është e mundur edhe në mungesë të një dëmi të tillë. Në fakt, është detyrë e aplikantit të vlerësojë nëse një dokument kërkon apo jo një koment nga ana e tij (*Bajić kundër Maqedonisë së Veriut*, 2021, § 59). E drejta për një gjykim kundërshtues është ngushtësisht e lidhur me barazinë e armëve dhe, në disa raste, Gjykata konstaton shkelje të nenit 6 § 1 duke i vlerësuar të dy konceptet së bashku.

152. Edhe nëse do të merrej i mirëqenë pretendimi i prokurorisë se afati 10 ditor për paraqitjen e memos nuk mund të zgjatet, bazuar në jurisprudencën e GJEDNJ, mosparashikimi i rregullave të procedurës penale në legjislacion mund të përbëjë shkelje të barazisë së armëve, pasi qëllimi i tyre është të mbrojnë të pandehurin ndaj çdo abuzimi të autoritetit dhe, për rrjedhojë, është mbrojtja ajo që ka më shumë gjasa të pësojë nga mungesat dhe pasaktësitë në këto rregulla (*Coëme dhe të Tjerë kundër Belgjikës*, 2000, § 102). K.Pr.Penale ka përcaktuar parimet bazë se legjislacioni procedural penal ka për detyrë të sigurojë një procedim të drejtë, të barabartë e të rregullt ligjor, të mbrojë liritë personale dhe të drejtat e interesat e ligjshme të shtetasve, të ndihmojë për forcimin e rendit juridik dhe zbatimin e Kushtetutës e të ligjeve të shtetit. Organi procedues duhet të mbledhë dhe të shqyrtojë si provat që fajësojnë të pandehurin, ashtu edhe ato që janë në favor të tij. Duke mos pranuar kërkesën për zgjatjen e afatit për paraqitjen e memos me qëllim që z. Veliaj të njihej me akuzën prej rreth 500 faqesh në ngarkim të tij, si dhe provat në ngarkim të tij, i kanë pamundësuar z. Veliaj të drejtën për tu mbrojtur efektivisht përpara këtij organi procedues.

153. Për më tepër, vetë mënyra e organizimit dhe komunikimit të akteve nga organi i akuzës bie ndesh me parimin e proporcionalitetit procedural, i cili kërkon që masat dhe afatet të përshtaten me kompleksitetin objektiv të çështjes. Kur përmbajtja e fashikullit hetimor përbëhet nga qindra mijëra faqe, me dhjetëra të pandehur dhe prova të ndërthurura, nuk është e mundur që ligjvënësi të ketë synuar zbatimin e një afati uniform e statik, pavarësisht rrethanave. Në mungesë të një mekanizmi ligjor për të garantuar fleksibilitet proporcional me kompleksitetin e çështjes, mbrojtja përballet me një pabarazi të natyrshme ndaj akuzës, e cila ka pasur akses dhe kohë të pakufizuar për të përgatitur dosjen. Një procedurë e tillë, e mbështetur vetëm në formën e afatit dhe jo në përmbajtjen reale të së drejtës për mbrojtje, jo vetëm që nuk siguron barazi të

armëve, por bie në kundërshtim të drejtpërdrejtë me vetë funksionin e afateve procedurale, të garantojnë efikasitetin e procesit pa cenuar thelbin e të drejtave të palëve.

154. Sa më sipër paraqet një cenim substancial të së drejtës për mbrojtje efektive dhe të parimit të barazisë së palëve, pasi afati procedural i vendosur nga organi i akuzës nuk përmbush kërkesat minimale që rrjedhin nga neni 6 i KEDNJ-së dhe nga parimet themelore të së drejtës penale procedurale. Komunikimi në të njëjtën ditë si i akuzës, ashtu edhe i vendimit për përfundimin e hetimeve, i shoqëruar me mospasjen në dispozicion të asnjë materiali hetimor përveç akteve formale, e privoi mbrojtjen nga çdo mundësi reale për të përgatitur një reagim të bazuar në prova dhe fakte. Dorëzimi, vetëm një ditë më vonë dhe në orët e vona të mbrëmjes, i një USB-je që përmbante mbi 150 volume fashikujsh hetimorë dhe qindra faqe me përmbajtje të ndërlikuar e të shpërndarë ndër shumë të pandehur, krijoi një situatë të pamundur objektivisht për t'u menaxhuar brenda afatit 10-ditor të parashikuar nga neni 327 të K.Pr.Penale.

155. Në këto rrethana, afati formal i dhënë nuk mund të konsiderohet si një “mundësi e arsyeshme” për të ushtruar të drejtën e mbrojtjes, por si një kufizim artificial që, në praktikë, e zbraz nga përmbajtja këtë të drejtë. Organi i akuzës ka pasur muaj/vite të tërë për të mbledhur, analizuar dhe organizuar materialet e çështjes, ndërsa mbrojtjes i është dhënë një periudhë minimale e pamjaftueshme për t'u përballur në kushte të barabarta, duke u krijuar kështu një disbalancë procedurale në kundërshtim të hapur me parimin e barazisë së armëve. Ky parim, siç ka theksuar në mënyrë të përsëritur Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, kërkon që secila palë të ketë jo vetëm të drejtën formale, por edhe mundësinë reale dhe efektive për të paraqitur qëndrimin e saj, në kushte që nuk e vendosin atë në një pozitë të pafavorshme përballë palës tjetër. Në mungesë të kohës së mjaftueshme për të shqyrtuar aktet dhe për të ndërtuar një mbrojtje të strukturuar mbi to, e drejta për një proces të drejtë dhe për një mbrojtje efektive nuk mbetet veçse teorike dhe iluzionare.

156. Një tjetër element thelbësor lidhet me faktin se afati i dhënë nga organi i akuzës nuk merr parasysh natyrën e pabarabartë të pozitës së palëve në proces. Organi i akuzës ka pasur në dispozicion jo vetëm kohë shumë më të gjatë, por edhe kapacitete

institucionale të plota, staf hetimor, ekspertë, pajisje teknologjike, për të analizuar dhe ndërtuar akuzën. Në të kundërt, mbrojtja ka vetëm një periudhë tepër të kufizuar dhe burime të limituara për të shqyrtuar të njëjtën sasi materiale, shpeshherë të fragmentuar dhe të paraqitur në formate që kërkojnë kohë shtesë për t'u përpunuar. Kjo krijon një asimetri procedurale që e zhvendos procesin nga koncepti i një përballjeje të drejtë, në një situatë ku njëra palë kontrollon në mënyrë disproporcionale kushtet dhe ritmin e procesit. Mbrojtja, për natyrën e saj funksionale, nuk mund të veprojë në mënyrë kritike, të verifikojë autenticitetin e provave, të kërkojë kundërprova, të thërrasë dëshmitarë, apo të ndërtojë një strategji të qëndrueshme, kur është e detyruar të reagojë brenda një kohe që bën të pamundur një analizë të plotë.

157. Një proces i tillë humb karakterin e tij të barabartë dhe shndërrohet në një formalitet procedural, ku përballja është vetëm formale, ndërsa rezultati i parashkruar është produkt i një avantazhi të pakontestueshëm të organit të akuzës. Në këto kushte, e drejta për mbrojtje ekziston vetëm në letër dhe nuk mund të ushtrohet në praktikë, duke e kthyer procesin penal nga një mekanizëm për verifikimin e së vërtetës në një instrument për konfirmimin e një akuze të parapërgatitur.

11. Cënimi i së drejtës për proces të rregullt për shkak të mbështetjes së akuzës në akt ekspertime të kryera nga punonjës të vetë organit procedues dhe jo ekspertë të pavarur

158. Prokuroria e Posaçme e ka bazuar akuzën në akt ekspertime të kryera nga persona të cilët nuk janë ekspertë të pavarur, por punonjës të këtij organi. Mbështetja e akuzës mbi akt ekspertime të kryera nga punonjës të vetë organit procedues, e jo nga ekspertë të pavarur, përbën një cenim të drejtpërdrejtë të parimit të procesit të rregullt dhe të drejtës për një gjykim të paanshëm. Roli i ekspertit në një procedim penal është të ofrojë një vlerësim teknik ose shkencor të pavarur, që nuk ndikohet nga interesat e njëjës palë. Kur ky funksion kryhet nga punonjës të organit që ka rolin akuzues, garancia e paanshmërisë komprometohet në themel, pasi këta persona janë pjesë e hierarkisë institucionale që përfaqëson interesin e ndërtimit dhe forcimit të akuzës. Në këto kushte, akt ekspertimi nuk është më një mjet neutral për ndriçimin e së vërtetës,

por rrezikon të shndërrohet në një instrument që mbështet dhe legjitimon paraprakisht qëndrimin e akuzës.

159. Roli i ekspertit në një procedim penal është një nga elementët kyç që ndihmon gjykatën dhe palët në kuptimin dhe vlerësimin e çështjeve teknike apo shkencore, të cilat dalin jashtë njohurive të zakonshme juridike. Eksperti nuk është një palë në proces; ai është një ndihmës i drejtësisë. Funkcioni i tij nuk është të mbështesë njëra anë, por të ofrojë një analizë objektive, të paanshme dhe shkencërisht të bazuar mbi faktet, në mënyrë që gjykata të mund të formojë bindjen e saj mbi prova që kërkojnë interpretime teknike. Ky rol kërkon pavarësi të plotë, integritet profesional dhe distancim nga interesat e drejtpërdrejta të cilësdo palë në proces.
160. Në praktikë, pavarësia e ekspertit nënkupton jo vetëm mungesën e varësisë juridike apo financiare nga ndonjë palë, por edhe mungesën e çdo lidhjeje hierarkike apo organizative që mund të ndikojë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë konkluzionet e tij. Nëse një ekspert është i punësuar në organin e akuzës, ai ndodhet në një pozitë ku nuk mund të sigurojë këtë pavarësi. Punësimi i tij do të thotë se ai është pjesë e të njëjtës strukturë që ka ndërtuar hipotezën akuzuese, që ka interes institucional për suksesin e akuzës dhe që vlerësohet, promovon dhe paguan nga e njëjta autoritet që përfaqëson palën akuzuese në proces.
161. Kjo varësi krijon një konflikt interesi të brendshëm dhe të pashmangshëm. Edhe nëse eksperti vepron me ndërgjegje profesionale, pozita e tij institucionale ngre dyshime të arsyeshme mbi paanshmërinë e tij. Në procesin penal, nuk mjafton që drejtësia të jetë e paanshme; ajo duhet të duket e tillë. Pra, perceptimi i paanshmërisë është po aq i rëndësishëm sa realiteti i saj. Një ekspert që merr rrogën nga organi i akuzës nuk mund të shihet nga një i pandehur ose nga publiku si një burim neutral i provës. Përkundrazi, ekziston një perceptim i natyrshëm se ai ka njëanshmëri të strukturuar, njëanshmëri që nuk është thjesht çështje individi, por rrjedhojë e vendosjes së tij në një zinxhir komandimi ku interesi kryesor është provimi i fajësisë.
162. Gjithashtu, kur aktet e ekspertimit kryhen nga punonjës të vetë organit të akuzës, ekziston një rrezik i qartë që roli i tyre teknik të ndërthuret me rolin e një dëshmitari të brendshëm, i cili, edhe pa dashje, transmeton në analizën e tij bindjet, hipotezat dhe

qasjen hetimore të kolegëve të tij prokurorë apo hetues. Në këtë mënyrë, ekspertimi nuk është më një produkt i pastër shkencor, por një interpretim i filtruar përmes perspektivës institucionale të organit akuzues. Ky fenomen e zbeh funksionin e ekspertit si mjet i paanshëm ndihmës i gjykatës dhe e shndërron atë në një “zgjatim” të deklarimeve apo qëndrimeve të vetë prokurorisë. Ndryshe nga një ekspert i pavarur, i cili punon mbi të dhënat e çështjes pa u ndikuar nga linja strategjike e njërës palë, eksperti i brendshëm është i ekspozuar ndaj të njëjtës narrativë hetimore që përpiket të mbështesë akuza. Kjo jo vetëm që e komprometon neutralitetin e aktit ekspertues, por krijon një formë të fshehtë të dyfishimit të provave në favor të akuzës, duke i dhënë peshë shtesë një qëndrimi institucional, nën maskën e një vlerësimi teknik.

163. Në procesin penal, ekspertimi shpesh ka peshë vendimtare, sidomos në çështjet si kjo në fjalë, ku provat teknike apo shkencore janë thelbësore për të vërtetuar ose rrëzuar akuzën. Një ekspert i brendshëm i organit të akuzës, edhe nëse nuk ndikohet drejtpërdrejt, mund të ndikohet nga presioni i nënkuptuar për të prodhuar rezultate që mbështesin versionin e ngjarjeve të paraqitur nga kolegët e tij hetues apo prokurorë. Kjo është një formë “asimetrie strukturore” ku njëra palë, akuza, jo vetëm kontrollon burimin e provës, por edhe interpretimin teknik të saj, duke e paraqitur këtë interpretim si “të pavarur” dhe të besueshëm.

164. Nga këndvështrimi i së drejtës për mbrojtje efektive dhe parimit të barazisë së armëve, ky realitet është i papranueshëm. Barazia e armëve nënkupton që palët duhet të kenë mundësi të barabarta reale, jo formale, për të ndikuar në procesin e vendimmarrjes gjyqësore. Nëse ekspertimi prodhohet nga një profesionist që është pjesë e organit akuzues, mbrojtja gjendet përballë një prove të ashtuquajtur “objektive”, e cila në fakt është e ngarkuar me konflikt interesi dhe e mbështetur nga autoriteti institucional i organit që synon dënimin e të pandehurit. Kundërshtimi i një prove të tillë bëhet jashtëzakonisht i vështirë, sepse mbrojtja nuk po debaton me një palë të tretë neutrale, por me vetë strukturën e akuzës.

165. Në aspektin procedural, kjo situatë minon parimin e ndarjes së funksioneve në procesin penal. Funksionet e hetimit, akuzimit dhe vlerësimit teknik janë të dallueshme dhe ekzistojnë për të shmangur përqendrimin e pushtetit në një dorë të vetme. Kur

organi akuzues merr përsipër jo vetëm hetimin dhe akuzimin, por edhe ekspertimin, ai i grumbullon këto funksione në një mënyrë që eliminon kontrollin reciprok dhe neutralitetin e procesit. Kjo jo vetëm që cenon të drejtat e të pandehurit, por e bën të pamundur që gjykata të mbështetet në ekspertizë që ka vërtet karakter objektiv.

166. Së fundi, në nivel të perceptimit publik dhe të besimit tek drejtësia, përfshirja e ekspertëve të brendshëm të organit akuzues në prodhimin e provave teknike është një goditje e rëndë. Publiku ka të drejtë të besojë se drejtësia është e ndarë nga pushteti akuzues dhe se çdo provë e paraqitur është testuar nga burime të pavarura. Kur ky besim minohet, çdo vendim gjyqësor që bazohet në prova të tilla shihet si i ndikuar dhe jo si produkt i një procesi të rregullt.

167. Roli i ekspertit në një procedim penal është të jetë një garantues i së vërtetës teknike në shërbim të drejtësisë, jo një instrument në shërbim të një pale. Në momentin që eksperti është i punësuar nga organi i akuzës, ky rol transformohet në thelb, duke kaluar nga një funksion neutral dhe ndihmues për gjykatën, në një funksion të integruar në strategjinë e njërës palë, me pasoja të drejtpërdrejta në drejtësinë e procesit dhe legjitimitetin e vendimit gjyqësor.

168. Ky konfigurim cenon barazinë e armëve midis palëve, pasi mbrojtja përballët jo me një provë të prodhuar në mënyrë të pavarur dhe të balancuar, por me një material që buron nga e njëjta strukturë që synon dënimin e të pandehurit. Në këtë mënyrë, e drejta e mbrojtjes për të kundërshtuar objektivisht përmbajtjen e ekspertimit dobësohet ndjeshëm, duke qenë se pavarësia dhe paanshmëria e autorit të tij janë të kompromentuara në vetë themelin. Kjo situatë krijon një disavantazh real dhe të prekshëm për të pandehurin, i cili duhet të përgatisë kundërshtime jo vetëm ndaj përmbajtjes teknike të ekspertimit, por edhe ndaj konfliktit të interesit që shoqëron autorin e tij.

169. Përdorimi i ekspertimeve të tilla bie ndesh edhe me parimin e ndarjes së funksioneve në procesin penal, ku hetimi, akuzimi dhe vlerësimi teknik duhet të mbahen të ndara për të garantuar objektivitetin. Kur organi akuzues merr përsipër jo vetëm rolin e hetuesit dhe të palës proceduese, por edhe të “ekspertit”, procesi humbet garancitë e tij bazë dhe krijohet një rrezik i qartë që prova të manipulohet në mënyrë të nënkuptuar

për të përforcuar akuzën. Një procedim i ndërtuar mbi ekspertime të tilla nuk plotëson standardet minimale të paanshmërisë dhe besueshmërisë së provave, duke vënë në pikëpyetje jo vetëm vlefshmërinë e aktit ekspertues, por edhe të gjithë procesit penal në tërësi.

170. Në thelb, një situatë e tillë jo vetëm cenon të drejtën e të pandehurit për një gjykim të drejtë e të paanshëm, por minon besimin publik tek drejtësia, pasi krijon perceptimin se organi procedues “gjeneron” prova nga brenda strukturës së vet për të justifikuar akuzën, në vend që t’i mbledhë ato në mënyrë të pavarur dhe të verifikueshme. Ky perceptim, edhe nëse nuk ka ndërhyrje direkte mbi përmbajtjen e ekspertimit, është i mjaftueshëm për të minuar integritetin e procesit dhe për ta vendosur të pandehurin në një pozitë dukshëm të pafavorshme.

171. Bazuar në sa më sipër janë të pavlefshme e të papërdorshme si prova të gjithë akt ekspertimet vijuese: Akt ekspertimi tekniko-kompjuterik, nr. 66, datë 18.03.2025 - Marius Gjoka, Albi Hoxha, Kastriot Gjoka; Akt ekspertimi teknik - telefoni celular dhe karte SIM, nr. 55, datë 28.02.2025- Marius Gjoka, Albi Hoxha, Kastriot Gjoka; Akt ekspertimi tekniko-kompjuterik nr.58, datë 1.08.2025 lidhur me telefonin celular të shtetasit Altin Kumara, kryer nga Marius Gjoka, Albi Hoxha, Kastriot Gjoka; Akt ekspertimi teknik - kompjuterik nr.10, datë 15.01.2025, kryer nga Marius Gjoka, Albi Hoxha, Kastriot Gjoka; Akt ekspertimi teknik - kompjuterik, nr. 669, datë 19.03.2025, kryer nga Marius Gjoka, Albi Hoxha, Kastriot Gjoka; Akt ekspertimi teknik - kompjuterik, nr. 80, datë 25.03.2025, kryer nga Marius Gjoka, Albi Hoxha, Kastriot Gjoka; Akt ekspertimi teknik - kompjuterik, nr. 164, datë 14.06.2025, kryer nga Marius Gjoka, Albi Hoxha, Kastriot Gjoka; Akt ekspertimi teknik - kompjuterik, nr. 165, datë 14.06.2025, kryer nga Marius Gjoka, Albi Hoxha, Kastriot Gjoka; Akt ekspertimi teknik - kompjuterik, nr. 166, datë 14.06.2025, kryer nga Marius Gjoka, Albi Hoxha, Kastriot Gjoka; Akt ekspertimi teknik - kompjuterik, nr. 167, datë 14.06.2025, kryer nga Marius Gjoka, Albi Hoxha, Kastriot Gjoka; Akt ekspertimi teknik - kompjuterik, nr. 199, datë 10.07.2025, kryer nga Marius Gjoka, Albi Hoxha; Akt ekspertimi teknik - kompjuterik, nr. 21, datë 27.01.2025, kryer nga Marius Gjoka, Albi Hoxha, Kastriot Gjoka; Akt ekspertimi teknik - kompjuterik, nr. 18, datë 18.01.2025, kryer nga Marius

Gjoka, Albi Hoxha, Kastriot Gjoka; Akt ekspertimi teknik - kompjuterik, nr. 49, datë 24.02.2025, kryer nga Marius Gjoka, Albi Hoxha, Kastriot Gjoka

172. Si rrjedhojë të pavlefshme janë edhe të gjitha procesverbalet përkatëse për këqyrjen e të dhënave të dala nga ekspertimet e mësipërme.

E ndëruar Gjykatë,

173. Të gjitha shkeljet procedurale të evidentuara në këtë kërkesë nuk janë çështje teknike të izoluar, as gabime të rastësishme të organit të akuzës. Ato, të ndërthurura së bashku, përbëjnë një skemë sistematike devijimesh nga standardet e procesit të rregullt, të cilat nuk mund të justifikohen as me ngarkesën e punës, as me kompleksitetin e çështjes dhe aq më pak me ndonjë interes të pidentifikuar publik. Në të vërtetë, kjo seri shkeljesh, nga fshehja e subjektit të hetimit, te manipulimi i afateve, përdorimi i ekspertëve të brendshëm, shkelja e privatësisë, mungesa e kapacitetit ligjor të prokurorit hetues dhe përdorimi i një kallëzimi të falsifikuar, shfaqin një prirje të qëllimshme për të ndërtuar një procedim penal që nuk synon drejtësinë, por synon një qytetar, një politikan dhe një të zgjedhur të qeverisjes vendore.
174. Synimi ka qenë jo ndjekja e së vërtetës penale, por krijimi i një instrumenti presioni mbi një funksionar të zgjedhur në mënyrë legjitime, përmes izolimit të tij dhe përdorimit të sistemit të drejtësisë për qëllime që dalin jashtë qëllimeve kushtetuese. Objektivi ka qenë pezullimi i një funksioni politik që buron nga vota e qytetarëve, jo përmes përballjes elektorale, por përmes një hetimi të deformuar në themelet e veta, ku autoriteti i ligjit është përdorur për të riformatuar vullnetin e sovranit popullor. Motivi i gjithë kësaj sage shkeljesh të rënda procedurale dhe kushtetuese, nuk është zbardhja e një veprë penale konkrete, por krijimi i një narrative penale për të zëvendësuar garën politike me eliminim procedural. Dhe kjo, në çdo sistem demokratik, është forma më e rrezikshme e instrumentalizimit të drejtësisë dhe mbivendosjes së saj ndaj sovranitetit qytetar.

175. Për të gjitha këto arsye, kërkohet nga Gjykata e Posaçme të vlerësojë me seriozitet maksimal jo vetëm pa/ligjshmërinë e akteve, por edhe ndikimin që këto shkelje kanë prodhuar në drejtësinë materiale, në të drejtat themelore të të pandehurit por edhe në të drejtën e qytetarëve të për tu qeverisur nga kryetari i zgjedhur prej tyre. Nëse drejtësia lejon që një proces i tillë të vijojë mbi bazën e këtyre themeleve të kalbura, ajo do të legjitimojë një precedent ku drejtësia vetë shndërrohet në mjet të padrejtësisë dhe rrënim të ekuilibrave të pushtetit në dëm të demokracisë përfaqësuese.

Për sa më sipër,

KËRKOJMË

Konstatimin e shkeljeve të mësipërme procedurale të Prokurorisë së Posaçme gjatë fazës së hetimeve paraprake të procedimit penal nr. 27 të vitit 2024 dhe pavlefshmërinë e veprimeve hetimore.

ERION VELIAJ